



ISSN 2413-1334



Policimi dhe **SIGURIA**

Nr. 3
GUSHT
2016

Revistë periodike shkencore
Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2016



POLICIMI DHE SIGURIA
AKADEMIA E SIGURISË

Policimi
dhe **SIGURIA**

BOTIM PERIODIK
Botuar nga Akademia e Sigurisë, Tiranë

NR 3
GUSHT
2016

Copyright © - Akademia e Sigurisë, Tiranë.

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Akademisë së Sigurisë. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet, shpërndahet apo shitet në asnjë mënyrë, i plotë apo pjesë të tij në formë elektronike apo në letër, pa autorizimin e shkruar të Akademisë së Sigurisë. Përdorimi i materialeve të kësaj reviste, pa autorizim, përbën shkelje penale të të drejtave të autorit.

Akademia e Sigurisë zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Policinë e Shtetit dhe Arsimin e lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike. Pikëpamjet e shprehura në revistën "Policimi dhe Siguria", janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Akademisë së Sigurisë. Autorët e publikimeve në revistën "Policimi dhe Siguria" gëzojnë liri të plotë akademike, me kushtin e vetëm që kur shkruajnë, ata të zbatojnë të gjithë legjislaionin përkatës si të komunikimit edhe atë profesional, i cili nuk cenon të drejtat e ndryshme.



Botues

AKADEMIA E SIGURISË
Rruga e Elbasanit, Sauk, Tiranë

NR 3
GUSHT
2016

BORDI EDITORIAL

Kryetari i Bordit

Dr. Xhavit SHALA

Anëtarët e Bordit

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Prof. Dr. Ismet ELEZI

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI

Prof. Asc. Pandeli TAÇI

Prof. Asc. Ferdinand ELEZI

Prof. Asc. Fatmir TARTALE

Redaktor shkencor

Albert HITOALIAJ

Përkthyes

Vangjel LILI
Lavdim KAZAZI

Punimet grafike

Andi OSMANI

Realizimi teknik

Qendra Kërkimore Shkencore,
Akademia e Sigurisë

Revista shkencore "**Policimi dhe Siguria**", botohet nga "Qendra Kërkimore Shkencore" e Akademisë së Sigurisë, me qëllim përmbushjen e standardeve më të larta në veprimtarinë kërkimore-shkencore në aktivitetin e Akademisë së Sigurisë.

P È R M B A J T J A

| | | |
|----|--|------------|
| 1. | Prof. Asc. Dr. Rauf DIMRAJ dhe Msc. Ervin PEPI Përgatitja fizike dhe performanca në detyrë e oficerëve të Policisë së Shtetit..... | 8 |
| 2. | Dr. Bilbil MEMAJ dhe Msc. Adriatik DUQI Siguria dhe antiterrorizmi..... | 20 |
| 3. | Msc Nikoll RICA Menaxhimi i burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit..... | 30 |
| 4. | Prof. Asc. Dr. Pandeli TAÇI dhe Msc. Jashar VREKA Sfidat e migracionit dhe veprat penale që zhvillohen me këtë fenomen..... | 42 |
| 5. | Msc Arjan MUÇA Sulmet kompjuterike dhe siguria kombëtare..... | 54 |
| 6. | Prof. Asc. Dr. Edmond BRANESHI Kultura e organizatës dhe lidhshipi..... | 70 |
| 7. | Msc Adriatik AGO Policia Gjyqësore të bëhet pjesë e reformës në drejtësi..... | 80 |
| 8. | Msc Lutfi MINXHOZI Asetet kriminale dhe strategjia kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe korrupsionit..... | 88 |
| | Abstraktet në anglisht / Abstracts..... | 108 |



POLICIMI DHE SIGURIA
AKADEMIA E SIGURISË

Përgatitja fizike dhe performanca në detyrë e oficerëve të Policisë së Shtetit



■ **Prof. Asc. Dr. Rauf DIMRAJ**
Zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit



■ **Msc. Ervin PEPI**
Ministria e Arsimit dhe Sportit

Abstrakt

Përherë, është e nevojshme që të kërkohet prej profesionistëve të zbatimit të ligjit, oficerëve të policisë, që të jenë në formë fizike, në mënyrë që ata, gjatë orarit të punës, të realizojnë me efikasitet dhe sukses detyrat e tyre. Faktikisht, policët gjatë zbatimit të detyrës, angazhohen edhe në sfida të ndryshme fizike, për shembull, u duhet të kapin të dyshuarit në arrati; të ngjiten mbi gardhe dhe çati; të nënshtrojnë individët që bëjnë rezistencë ndaj arrestit, të mbajnë, detyrimisht, pajisje relativisht të rënda, si pistoletë, shkop gome, pranga etj. Këto pajisje, janë në përbërje të standardit të pajimeve të nevojshme profesionale të policisë, prandaj oficerët ligjzbatues duhet të zotërojnë një nivel të përshtatshëm të forcës dhe qëndrueshmërisë, i cili arrihet nëpërmjet zhvillimit të ushtrimeve për fuqizimin muskular dhe fuqizimin e sistemit kardiorespirator. Aftësitë e qëndrueshmërisë, forcës, shpejtësisë, zhdërvjelltësisë së lëvizjeve, për oficerët e policisë, janë faktorë tepër të rëndësishëm të përgatitjes fiziko-atletike dhe shpeshherë janë vendimtarë, për dominimin e situatave konfrontuese kundrejt subjekteve kriminalë, si dhe në asistencën ndaj qytetarëve në nevojë. Është e qartë se rendimenti fiziko-lëvizor i oficerëve të policisë, ka të bëjë me menaxhimin dhe dominimin e situatave të papritura e tepër të rrezikshme, prandaj nevojitet që ata të përgatiten me programe të përshtatshme e të individualizuara fiziko-lëvizorë, për të plotësuar standardet respektive specifike, në përputhje me moshën dhe gjininë e secilit subjekt.

Fjalëkyçe:

policë, forcë, qëndrueshmëri, zhdërvjelltësi, sfida fizike, standard, punë, dëmtime.

Dimraj, R.
dhe Pepi, E.
« Përgatitja
fizike dhe
performanca në
detyrë e
oficerëve të
Policisë së
Shtetit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

1. Hyrje

Në disa profesione publike, nevojitet që punonjësit, gjatë zbatimit të detyrës së tyre, të jenë fizikisht e atletikisht të përgatitur, si dhe shumë aktivë, sikundër janë rastet e oficerëve të policisë, mësuesve të edukimit fizik, zjarrfikësve, etj. Oficerët ligjzbatues, për shkak të specifikës së detyrës, janë më të ekspozuar përballë niveleve të larta të rrezikut dhe stresit, krahasuar me personat e profesioneve të tjera. Nevoja për të marrë vendime të menjëhershme, për të shpëtuar jetë njerëzore; përballja e vazhdueshme me persona të irrituar, jobashkëpunues e të rrezikshëm dhe oraret e zgjatura të punës, përbëjnë një barrë fizike dhe mendore për oficerët e policisë. Kjo natyrë e stresit, përbën një kërcënim real, për shëndetin biofizilogjik të komunitetit ligjzbatues. Reagimet emocionale dhe veprimet sociale, si divorcet, vetëvrasjet dhe alkoolizimi i subjekteve, te pjesëtarët e komunitetit ligjzbatues, janë të lidhura fuqimisht me stresin gjatë punës së tyre dhe janë dukuri prezente në të gjithë globin¹.

Studimet e gjera kanë provuar se zhvillimi i përshtatshëm, i individualizuar e i vazhdueshëm i aktivitetit fiziko-lëvizor, përmirëson shëndetin e njeriut, ndihmon në kontrollin e peshës trupore, ul nivelin e lipideve në gjak, pakëson dhjamësinë (e quajtur sot, edhe me termin e huazuar “obesitet”), parandalon sëmundjet e zemrës, infarkt, hipertensionin, artritet, gurët në tëmth, kancerit, diabetit, etj. Gjithashtu aktiviteti fizik ka rëndësi të madhe, edhe sepse ndikon në zgjerimin e diapazonit të durimit të stresit si dhe në shkarkimin më shpejtësish të tij. Por, pas viteve 1990, në vendin tonë mungoi organizimi dhe programimi i stërvitjes me vetëdije, për teorinë, praktikën dhe kontrollin e përgatitjes fiziko-lëvizore të oficerëve të zbatimit të ligjit. Praktika e aktiviteteve fiziko-sportive, doli nga mënyra e jetesës së rinisë; asnjë nxënës shkolle nuk u vlerësua e

Dimraj, R. dhe Pepi, E.
« Përgatitja fizike dhe performanca në detyrë e oficerëve të Policisë së Shtetit »

Policimi dhe Siguria
nr.3, 2016

¹ Pinizzotto, Anthony J., Edward F. Davis, dhe Charles E. Miller III. *In the Line of Fire*. Washington, D.C.: U.S. Department of Justice, Federal Bureau of Investigation, 1997, (f. 14).

nuk u kartelizua, për gjendjen shëndetësore e ndërkohë vetëm 4 % e popullatës shqiptare zhvillonte aktivitet lëvizor. Mungesa e lëvizjes përgjatë më shumë se 20 vite, shkaktoi rritjen e përqindjes dhjamore e deformime në pamjen e jashtme trupore të qytetarëve. Aktualisht edhe një pjesë e konsiderueshme e oficerëve tanë ligjzbatues, janë ende dhjamorë e të pambrojtur, përballë faktorëve të rrezikut të patologjive të ndryshme dhe dëmtimeve në detyrë e si rrjedhojë kanë vënë në rrezik gjendjen e tyre shëndetësore, fizike, mendore, emocionale dhe respektin e komunitetit qytetar.

1.2 Forma fizike dhe performanca në detyrë

Cilësia e veprimeve fiziko-lëvizore, e oficerëve të fushës së zbatimit të ligjit, ka një impakt direkt në cilësinë e performancës së tyre të punës. Forma cilësore fizike vetjake, i mbron oficerët nga të qenit viktimë. Në më shumë se 75% të rasteve të arrestimeve që kryejnë trupat policore, ka rezultuar se koha mesatare për nënshtrimin e individëve të dyshuar, të cilët shfaqin një rezistencë me nivel mesatar ose të fortë, varion nga 30 sekonda deri në 2 minuta. Kur oficerët e zbatimit të ligjit, angazhohen në detyra fizike me kohëzgjatje më shumë se dy minuta, atëherë ata arrijnë të përdorin 75-90% të aftësive të tyre maksimale. Nga intervistat e shumta të zhvilluara nga Byroja Federale e Investigimit (FBI), e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përgjatë 10 viteve të kaluara, është konstatuar se shkelësit e ligjit, përpara se të vendosnin për mënyrën e reagimit të tyre, vlerësonin madhësinë trupore të oficerëve të policisë, që ndodheshin përballë tyre. Shumë prej tyre kishin pasiguri e vështirësi të përgjigjesishin se çfarë tipi konstatonin apo çfarë pike referimi kërkonin të gjenin, për të vlerësuar nëse kishin supremaci në përballjen me një oficer policie. Ndërkohë, shumë shkelës të ligjit, u artikuluan se faktori që vendoste për veprimin reagues të tyre, kishte të bënte me intuitën, ndjeshmërinë dhe bindjen që ata ishin në gjendje se “mund të kapeshin” me subjektin ligjzbatues. Nëse oficerët e policisë dukeshin në formë fizike dhe silleshin në mënyrë profesionale, atëherë shkelësit e ligjit hezitnin të vepronin përballë një rreziku të tillë potencial, e njëherësh synonin të përfitonin nga situata rrethanore. Prandaj oficerët ligjzbatues, duhet të jenë të vetëdijshëm, për imazhin që ata/ato përçojnë e të ndërjegjësohen, se paraqitja dhe sjellja e tyre nën uniformë, është një faktor parësor, që ka të bëjë me mënyrën se si të tjerët i perceptojnë ata/ato.²

Niveli i performancës së oficerit të policisë, jo rrallë është i varur nga specifika e situatave, sikundër janë ato, në të cilat nevojitet për të shpëtuar jetë njerëzore, atë të qytetarëve, si edhe jetën e vetë policit. Oficerët e zbatimit të ligjit, i kryejnë detyrat e tyre, edhe duke qenë të veshur me pajisje e pajime specifike sigurie, që peshojnë nga 9 kg për rastet e patrullimit dhe deri në 36 kg, për rastet që kërkojnë realizimin e taktikave të veçanta me armë speciale. Këto veprime, kërkojnë sforcime të mëdha fizike e për një kohëzgjatje të konsiderueshme, prandaj oficerët ligjzbatues duhet të zotërojnë e demonstrojnë një forcë të madhe eksplozive dhe një qëndrueshmëri të lartë fiziko-lëvizore. Studimi i performancës së oficerëve të zbatimit të ligjit, gjatë zhvillimit të detyrave fiziko-profesionale, paraqitet si një aspekt shumë i rëndësishëm në garantimin e rendit publik, prandaj ky aspekt nevojitet të ketë një vëmendje të posaçme e të vazhdueshme nga institucionet respektive.

*Dimraj, R.
dhe Pepi, E.*
« Përgatitja
fizike dhe
performanca në
detyrë e
oficerëve të
Policisë së
Shtetit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

² Pinizzotto, Anthony J. dhe Edward F. Davis, "Offender's Perceptual Shorthand: What Messages Are Law Enforcement Officers Sending to Offenders?" *FBI Law Enforcement Bulletin* 68, no. 6. (June 1999), (f. 1).

2. Metodologjia

Një oficer policie është një punonjës i betuar: ai/ajo vepron në cilësinë e përkrahësit të ligjit dhe jo rrallëherë, akti i mbrojtjes së rendit, është dinamik dhe kërkon aftësi fizike. Qëllimi i këtij prezantimi, është që të ndërjegjësohet çdo subjekt ligjzbatues, se nevojitet që të jetë klinikisht i shëndetshëm dhe i aftë që të plotësojë standardet e cilësive fiziko-atletike, referuar moshës dhe gjinisë së tij. Duhet të theksojmë se prania e pasivitetit fizik, dhjamësisë të një subjekti, shkakton një rrezik të madh për sëmundje të tilla si: kardiovaskulare, diabeti, kanceri, mbitensioni, osteoporozë, atrofitë muskulore, etj., si dhe shkakton efekte shumë negative, në aspektet e shëndetit fizik, atletik, kognitiv, social, ekonomik e produktiv të shoqërisë sonë. Rreziku që shkaktohet nga dhjamosja, është i ngjashëm me rrezikun që shkaktohet nga shumica e tre faktorëve të tjerë të rrezikut parësor: hipertensioni + hiperkolesterolemia + duhani³.

Individët me energji të pakta fizike, me fleksibilitet të pakët, rendiment të vogël kardiak dhe me një nivel të lartë të dhjamit trupor, janë më të ekspozuar kundrejt rrezikut të plakjes në kushte të këqija shëndetësore, krahasuar me të tjerët. Prandaj, për të krijuar një shëndet të shkëlqyer të një subjekti, është e nevojshme të aplikohet stërvitja organike dhe ushtrimet e fuqizimit muskular, domethënë të rritet qëndrueshmëria e sistemit organik, masa e fuqia muskulare trupore, fleksibiliteti dhe zhdërvjelltësia e lëvizjeve, të cilat janë aftësi biofiziolgjike që e mbrojnë trupin nga dëmtimet e faktorëve të brendshëm e të jashtëm dhe garantojnë funksionimin cilësor të veprimeve, sikundër është koordinimi neuromuskular⁴.

Prandaj, fillimisht, nevojitet të vlerësohen dhe evidentohen, nëpërmjet një testimi shumë të thjeshtë, matjet e parametrave antropometrike, BMI-së, konsumit maksimal të oksigjenit, cilësitë fiziko-atletike dhe rezultatet e këtij testimi të krahasohen me standardet respektive. Kjo mënyrë vlerësimi për gjendjen fizike, funksionale, fiziologjike të çdo subjekti ligjzbatues, mundëson përcaktimin e gjendjes reale dhe hartimin e programeve të individualizuara stërvitore, për përmirësime të mundshme në këto aspekte:

a. gjendjen shëndetësore – nëpërmjet përcaktimit të nivelit funksional kardiak, respirator,

vaskular, të përqindjes dhjamore të trupit, forcës së muskulaturës së trupit, fleksibilitetit

muskular trupor e të gjymtyrëve;

b. gjendjen e nivelit të formës fiziko-lëvizore, – nëpërmjet matjes së cilësive fiziko-atletike.

2.1 Matjet e cilësive antropometrike të BMI-së dhe standardi i gjendjes optimale, moshë 18-65 vjeç

Studimet e gjera dhe të mirëkontrolluara epidemiologjike, sugjerojnë ekzistencën e një raporti të drejtë midis peshës së tepërt trupore, dhjamosjes dhe lindjes së sëmundjeve

³ FMSI, SIC Sport, ANCE, ANMCO, GICR, SIC. "La prescrizione dell'esercizio fisico in ambito cardiologico. Documento Cardiologico di Consenso della Task Force Multisocietaria". *Medicina dello sport*, vol. 59, N, 2006.

⁴ Bazzano C. dhe M. Bellucci. *Efficiencia fisica e benessere come vivere meglio a tutte le eta*. Roma: EMSI, 2001.

Dimraj, R. dhe Pepi, E.
« Përgatitja fizike dhe performanca në detyrë e oficerëve të Policisë së Shtetit »

Policimi dhe Siguria
nr.3, 2016

kardiake, infarkt, artritis, hipertensionit, gurëve në tëmth, diabetit, etj. Vlerësimi i indeksit të masës trupore, BMI⁵, si rrjedhojë e matjes së peshës dhe lartësisë trupore, për të përcaktuar intervalin e “normalitetit” të peshës trupore, paraqitet si treguesi më i mirë i dhjamt trupor e i rrezikut nga patologjitë⁶.

BMI-ja llogaritet si më poshtë:

BMI = Peshë trupore (kg.): Lartësia trupore në katror (m²).
Vlera optimale e BMI-së = 18 - 24.

2.2 Matja e konsumit maksimal të oksigjenit dhe standardet sipas grupmoshës

“Konsumi maksimal i oksigjenit” VO₂ max., është tregues shumë i rëndësishëm që shpreh rendimentin e zemrës, të mushkërive dhe të enëve të gjakut të një individi. Ai paraqitet si një element i domosdoshëm i vlershmit të aftësive fizike të çdo subjekti, pasi është i lidhur me aftësinë e zemrës për të pompuar gjakun, për tek muskujt që punojnë dhe që kanë nevojë të furnizohen me oksigjen. Konsumi maksimal i oksigjenit (njësia matëse ml/kg. min), ose “Fuqia aerobike maksimale” (100% VO₂ max), është fuqia që i përket stadi në të cilin subjekti përdor maksimumin e oksigjenit dhe matet me anën e testeve laboratorike ose të fushës, p.sh. nëpërmjet garës 2400 metra ose 3000 metra. Në bazë të këtij parametri, llogaritet mbi baza shkencore për çdo subjekt, intensiteti stërvitor i personalizuar dhe në këtë mënyrë mënjanohej rreziqet nga mbingarkesat empirike.

Ja vlerat e tij normale sipas moshës dhe seksit për subjekte jo sportivë:

| | | | | | | |
|-----------------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Mosha (vjeç) | 10-19 | 20-29 | 30-39 | 40-49 | 50-59 | 60-69 |
| Femra (ml/kg. min.) | 38-46 | 33-42 | 30-38 | 26-35 | 24-33 | 22-30 |
| Meshkuj (ml/kg. min.) | 47-56 | 43-52 | 39-48 | 36-44 | 34-41 | 31-38 |

2.3 Fleksibiliteti

Fleksibiliteti ose lëvizshmëria artikulare, është komponent i rëndësishëm i efijensës fizike dhe e rezultatit lëvizor. Të jesh fleksibël do të thotë të realizosh pa asnjë pengesë, të gjithë harkun lëvizor, që një artikulacion është i aftë të kryejë. Një nivel i pakët i fleksibilitetit të muskujve të kofshës dhe të zonës lombare, shkakton tek personat të ashtuquajturën sëmundje e lombalgjisë kronike, e që shoqërohet me dhimbje në shtyllën kurrizore. Shpesh kjo gjendje e lombalgjisë, shkaktohet nga niveli i dobët i muskulaturës abdominale. Fleksibiliteti, ashtu sikundër dhe aspektet e tjerë të efijensës fizike, duhet të vlerësohet përpara se të hartohet një program stërvitor i personalizuar. Vlerësimi i fleksibilitetit mund të kryhet me goniometër ose fleksometër.⁷

⁵ Body Mass Index – BMI

⁶ McArdie, William D., et al. *Fisiologia applicata allo sport - Aspetti energetici, nutrizionali e performance*. Milano: CEA, 2009.

⁷ Ashabanner, Jeffrey. *Implementing a Mandatory Physical Fitness Program for all Sworn Personnel*. Texas: Research Paper Law Enforcement Institute of Texas, 2002



Të dhënat normative për testin e fleksibilitetit

(Tabelat e marra nga Johnson B.L & Nelson J.K. Practical Measurements for Evaluation in PE 4th Ed. 1986)

| Mosha < 36 vjeç | | |
|---------------------------|--------------|-------------|
| Vlerësimi | Meshkuj | Femra |
| Shkëlqyeshëm | >17.9 | >17.9 |
| Mirë | 17.00 – 17.9 | 16.7 – 17.9 |
| Mesatar | 15.8 – 16.9 | 16.2 – 16.6 |
| Mjaftueshëm | 15.0 – 15.7 | 15.8 – 16.1 |
| Dobët | < 15.0 | < 15.4 |

| Mosha 36 deri 49 vjeç | | |
|------------------------------|-------------|-------------|
| Vlerësimi | Meshkuj | Femra |
| Shkëlqyeshëm | >16.1 | >17.4 |
| Mirë | 14.6 – 16.1 | 16.2 – 17.4 |
| Mesatar | 13.9 – 14.5 | 15.2 – 16.1 |
| Mjaftueshëm | 13.4 – 13.8 | 14.5 – 15.1 |
| Dobët | <13.4 | <14.5 |

2.4 Forcës muskulore trupore dhe testimi i saj

Cilësitë e larta lëvizore, pra një nivel i lartë i aftësive neuromuskulore, janë faktorë të domosdoshëm dhe të rëndësishëm që duhet të zotërojnë, demonstrojnë dhe të stërvitin oficerët e policisë, të cilat varen nga forca dhe fuqia muskulore si dhe nga të shprehurit specifik të saj. Metodatat e “body building” hipertrofizojnë muskuj në mënyrë të theksuar dhe ata nuk mund të sigurojnë shpejtësinë e duhur të kontraksionit dhe dekontraksionit vetiak, e si rrjedhojë nuk mund të garantojnë zhvillimin e aftësisë të së shprehurit të forcës eksplozive të oficerëve të policisë, por ndikojnë në ngadalësimin e ndjeshëm të progresit të rendimentit të tyre lëvizor. Për këtë arsye forca dhe zhvillimi specifik i saj, është një nga faktorët më të rëndësishëm të metodologjisë së stërvitjes së oficerëve të policisë.



Të dhënat normative për testin e abdominalëve

Dimraj, R. dhe Pepi, E.
 « Përgatitja fizike dhe performanca në detyrë e oficerëve të Policisë së Shtetit »

Policimi dhe Siguria
 nr.3, 2016

(Tabelat e marra nga McArdle W.D. et al; *Essential of Exercise Physiology*; 2000)

| Për subjektet meshkuj | | | | |
|------------------------------|--------------|------|-------------|-------|
| Klasifikimi | Shkëlqyeshëm | Mirë | Mjaftueshëm | Dobët |
| <35 | 60 | 45 | 30 | 15 |
| 35-44 | 50 | 40 | 25 | 10 |
| >45 | 40 | 25 | 15 | 5 |

| Për subjektet femra | | | | |
|----------------------------|--------------|------|-------------|-------|
| Klasifikimi | Shkëlqyeshëm | Mirë | Mjaftueshëm | Dobët |
| <35 | 50 | 40 | 25 | 10 |
| 35-44 | 40 | 25 | 15 | 6 |
| >45 | 30 | 15 | 10 | 4 |

Të dhënat normative për testin e përkuljeve mbi krahë



(Tabelat e marra nga From Pollock, M.L., et al.: *Health and Fitness Through Physical Activity*. New York: John Wiley & Sons, 1984)

| Numri i përkuljeve të përfunduara | | | | | | |
|--|------------------|--------------|-------|-------|-------|-----|
| | Vlerësimi | Mosha | | | | |
| | | 20-29 | 30-39 | 40-49 | 50-59 | 60+ |
| Shkëlqyeshëm | >54 | >44 | >39 | >34 | >29 | |
| Mirë | 45-54 | 35-44 | 30-39 | 25-34 | 20-29 | |
| Mesatar | 35-44 | 25-34 | 20-29 | 15-24 | 10-19 | |
| Mjaftueshëm | 20-34 | 15-24 | 12-19 | 8-14 | 5-9 | |
| Dobët | <20 | <15 | <12 | <8 | <5 | |

Dimraj, R.
dhe Pepi, E.
« Përgatitja
fizike dhe
performanca në
detyrë e
oficerëve të
Policisë së
Shtetit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

Këto karakteristikat metabolike, strukturore dhe funksionale të individit, ndryshojnë edhe në varësi të angazhimit fiziko-lëvizor të tij, prandaj nëpërmjet një programi të përshtatshëm, në përputhje me moshën, gjininë, aftësitë fiziko-atletike dhe motivimin e secilit person, për të zhvilluar qëndrueshmërinë aerobike, forcën muskulore trupore, sidomos atë të muskujve abdominalë në drejtim të qëndrueshmërisë dhe fleksibilitetin muskolor trupor dhe uljen e përqindjes dhjamore të trupit, mund të përmirësohen të gjitha parametrat e mësipërme, cilësia e shëndetit personal dhe performanca në punë e oficerëve të policisë..

3. Diskutime

Në ditët e sotme, politikëbërësit dhe drejtuesit e zbatimit të ligjit, përfshirë vendin tonë, nuk mund ta pranojnë pohimin se aksidentet dhe dëmtimet janë një realitet i profesionit të funksionarit të policisë. Besimi i vetëm i pranueshëm e që udhëheq punën e tyre, është zero oficerë të vrarë apo të dëmtuar. Kjo filozofi pune, shtrihet edhe në aspektet e dëmtimit të oficerëve. Meqenëse studime të shumta, kanë treguar se cilësia e lartë e formës fizike, ka një ndikim direkt, pozitiv, në përmirësimin e shëndetit, performancën në punë, uljen e dëmtimeve trupore dhe rritjen e mirëqenies personale e të shoqërisë, atëherë Akademia e Sigurisë së Shqipërisë, institucionalizoi zhvillimin e testeve fiziko-atletike, në mënyrë që të maten dhe vlerësohen, krahasuar me standardet përkatëse, aftësive fiziko-lëvizore të rekrutëve të rinj, si kandidatë për tu regjistruar në forcat efektive të mbrojtjes së ligjit.

Ashtu si në vendet Perëndimore, edhe në vendin tonë, shoqëria kërkon që oficerët e policisë, të zotërojnë e të demonstrojnë, në rast nevojë, një nivel të përshtatshëm fiziko-lëvizor në detyrë, prandaj duhet bërë e qartë e të funksionojë praktikisht, se kur dikush futet në fushën e zbatimit të ligjit, ai apo ajo humbet "të drejtën" për të qenë fizikisht jo në formë⁸.

Sa më sipër, lind e nevojshme, që pas diplomimit të policëve, të institucionalizohet dhe të organizohen ritmikisht nga organet kompetente, vlerësimi dy herë në vit i cilësive fiziko-atletike për të gjitha forcat policore, me qëllim që secili subjekt të realizojë standardet e cilësive që paraqitëm më sipër. Kjo formë pune, për testimin periodik të cilitdo subjekti të fushës së zbatimit të ligjit, do ndikojë menjëherë në përfshirjen dhe angazhimin e tyre, për të zhvilluar programe të individualizuara e të përshtatshme të përgatitjes fizik edhe aktivitetit fizik, e në këtë mënyrë ata do zotërojnë shëndet të plotë, formë të mirë fizike, kurajën e duhur dhe performancën e lartë në punë. Shumë departamente të policisë në vendet Perëndimore, kanë implementuar programe përgatitjeje fizike në përputhje me standardet dhe rekomandimet e Institutit Cooper për Kërkime Aerobike, Dallas. Në Departamentin e Policisë Hurts, Teksas, SHBA, oficerët e policisë i nënshtrohen vullnetarisht testeve mbi formën fizike. Çdo oficer, i cili kalon vlerësimin e shkathësisë fizike (standardet e Institutit Aerobik Cooper) shpërblehet me 8 orë kompensuese. Oficerët vlerësohen dy herë në vit, që do të thotë se policët që ndjekin një stil aktiv jetese, mund të shpërblehen me 16 orë kompensuese. Fitimi i orëve kompensuese është një mënyrë nxitëse e stimuluese, për të qëndruar në formë të mirë shëndetësore dhe fizike. Duhet thënë se departamente të tjera, zhvillojnë vlerësime të detyrueshme dhe subjektet që nuk plotësojnë standardet e cilësive fiziko-atletike, nuk mund të punësohen apo do të pushohen nga puna⁹.

4. Konkluzione

Policimi, realisht është një profesion i rrezikshëm, që mund të kthehet deri në vdekjeprurës, për të papërgatiturin. Përfshirja në një konfrontim fizik, gjatë karrierës së

Dimraj, R. dhe Pepi, E.
« Përgatitja fizike dhe performanca në detyrë e oficerëve të Policisë së Shtetit »

Policimi dhe Siguria
nr.3, 2016

⁸ Leal, Hector. "Benefits of Physical Fitness for Police Officers". *Texas Police Journal*, April. Texas: Harlingen Police Department, 2006.

⁹ Scott Sheets, CMDR. Fitness and the Police Officer, *The Journal of Law Enforcement*, ISSN: 2161-0231.

policimit, është një prezencë jo e rrallë dhe pothuajse absolutisht e pashmangshme, prandaj pyetja që lind natyrshëm, është: "A do të kesh sukses?". Forma fiziko-lëvizore e oficerit ligjzbatues, është faktori përcaktues i këtij suksesi. Si përfundim, oficerët e zbatimit të ligjit kanë një detyrë me të vërtetë impenjuese dhe të rrezikshme. Ruajtja e niveleve të përshtatshme fizike, në përputhje me standardet e paraqitura në këtë artikull, është shumë e rëndësishme për performimin cilësor në punën e tyre. Prandaj, sektori kërkimor i Akademisë së Sigurisë, në bashkëpunim me institucione të tjera, duhet të hartojë një program të studiuar, për trajnimin, testimin dhe vlershmin periodik të gjendjes fizike, funksionale, fiziologjike, për gjithë subjektet policore ligjzbatuese të vendit tonë. Kjo mënyrë organizimi, do përmirësojë përbërësit truporë, fiziko-lëvizorë dhe imazhin shembullor të oficerëve ligjzbatues, përballë komunitetit qytetar.

**Dimraj, R.
dhe Pepi, E.**

« Përgatitja
fizike dhe
performanca në
detyrë e
oficerëve të
Policisë së
Shtetit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

Bibliografi

1. Pinizzotto, Anthony J., Edward F. Davis, dhe Charles E. Miller III. *In the Line of Fire*. Washington, D.C.: U.S. Department of Justice, Federal Bureau of Investigation, 1997.
2. Pinizzotto, Anthony J. dhe Edward F. Davis, "Offender's Perceptual Shorthand: What Messages Are Law Enforcement Officers Sending to Offenders?" *FBI Law Enforcement Bulletin* 68, no. 6. (June 1999).
3. FMSI, SIC Sport, ANCE, ANMCO, GICR, SIC. "La prescrizione dell'esercizio fisico in ambito cardiologico. Documento Cardiologico di Consenso della Task Force Multisocietaria". *Medicina dello sport*, vol. 59, N, 2006.
4. Bazzano C. dhe M. Bellucci. *Efficienza fisica e benessere come vivere meglio a tutte le eta*. Roma: EMSI, 2001.
5. McArdie, William D., et al. *Fisiologia applicata allo sport - Aspetti energetici, nutrizionali e performance*. Milano: CEA, 2009.
6. Ashabranner, Jeffrey. *Implementing a Mandatory Physical Fitness Program for all Sworn Personnel*. Texas: Research Paper Law Enforcement Institute of Texas, 2002.
7. Leal, Hector. "Benefits of Physical Fitness for Police Officers". *Texas Police Journal*, April. Texas: Harlingen Police Department, 2006.
8. Scott Sheets, CMDR. *Fitness and the Police Officer*, *The Journal of Law Enforcement*.

**Dimraj, R.
dhe Pepi, E.**
« Përgatitja
fizike dhe
performanca
në detyrë e
oficerëve të
Policisë së
Shtetit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

Siguria dhe antiterrorizmi



■ **Dr. Bilbil MEMAJ**
Akademia e Sigurisë



■ **Msc. Adriatik DUQI**
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Siguria është sot në qendër të debatit politik në nivel global. Ajo është një koncept që vë në lëvizje të gjithë mekanizmat për ruajtjen e vlerave të sistemit demokratik nga rreziqet, dëmet dhe fatkeqësitë. Si të gjitha vlerat e sistemit, edhe siguria është në proces të përmirësimit të vazhdueshëm, është pjesë integrale e zhvillimeve politike dhe ekonomike dhe kushtëzohet nga faktorë të ndryshëm të mjedisit social dhe natyror. Cilësia e saj përcaktohet në mënyrë të veçantë nga niveli i realizimit të lirive thelbësore të njeriut. Pasiguria i ka rrënjët tek frika dhe rreziku. Frika si gjendje psikosociale dhe emocionale e njeriut, ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi lirinë individuale. Frika e kufizon dhe izolon njeriun nga realiteti i lirive themelore. Ajo është aq e vjetër sa edhe vetë jeta njerëzore dhe jeton së bashku me të. Në kohën e sotme, karakteri objektiv dhe shkalla e frikës, përcaktohen kryesisht nga gjendja e mjedisit socioekonomik, i cili vjen tek njeriu nëpërmjet rrejtit të dendur të informacionit, prej kronikave të zeza dhe krimin, prej varfërisë dhe sëmundjeve, prej papunësisë dhe urisë, prej ndotjes dhe fatkeqësive natyrore, prej gabimeve njerëzore dhe veprimeve arbitrare, prej represionit politik, konfliktit social dhe padrejtësive, të cilat bashkëjetojnë "mirë" me mjedisin e pandëshkueshmërisë, korrupsionit dhe vulgaritetit të ditës. Por, fenomeni i cili sjell pasigurinë më të madhe mes shoqërive të sotme është padyshim terrorizmi.

Terrorizmi futet në shtëpitë tona përmes ekraneve televizive. Ai na sulmon e ofendon në gazeta dhe revista dhe ndonjëherë prek jetët tona apo të njerëzve tanë në mënyra të drejtpërdrejta¹. Njerëzve nuk u intereson shumë dhe nuk shqetësohen për përkufizimin e terrorizmit në kohë të tilla se sa për rrezikun real që ai sjell. Ne, thjesht sa e ndiejmë terrorin, kur shohim dhunën dhe kur në ekrane shohim pasojat në jetë njerëzish dhe në dëme materiale. Të dish ta përkufizosh, të kuptosh shkaqet dhe të marrësh masat parandaluese më qëllim kundërpërgjigje ndaj tij janë sfidat kryesore të shteteve në luftën kundër terrorizmit. Këto elementë do të trajtohen hap pas hapi në këtë material, duke u përpjekur të kuptojmë se cilat janë hapat e duhura për të ndërtuar një mjedis sa më të sigurt.

Fjalëkyçe:

terrorizmi, konteksti i terrorizmit, masat e sigurisë, parandalimi i terrorizmit, kundërpërgjigjet ndaj terrorizmit.

“Terrorizmi është si një bumerang. Sot në shpinën tonë, nesër të një vendi tjetër”

- *Uluc Ozulker*²

“Vra një të frikësosh njëmijë”

- *Sun Tzu*³

Hyrje

Termi “terrorizëm”, ka hapur një debat të nxehtë midis politikanëve, studiuesve dhe ekspertëve. Është shumë e vështirë që të bihet dakord mbi përkufizimin e terrorizmit – studiuesit sociologë, politikëbërësit, specialistët juristë dhe ata të sigurisë, janë autoritetet që shpeshherë argumentojnë kuptimin e këtij termi. HHA Cooper⁴ (1978, 2001), thotë: “Ka një problem në përkufizimin e problemit”. Ne mund të biem dakord se terrorizmi është një problem, por ne nuk mund të biem dakord mbi atë çka terrorizmi është. Ka shumë arsye për këtë konfuzion. Terrorizmi është i vështirë për t’u përcaktuar, pasi ai ka një konotacion përçmues, përbuzës, domethënë negativ (përbuzës do të thotë se ai është i ngarkuar emocionalisht.) Një person është politikisht dhe shoqërisht i degraduar kur etiketohet si terrorist dhe e njëjta gjë ndodh edhe kur një organizatë është e quajtur “grup terrorist”. Një nga arsyet kryesore se përse terrorizmi është i vështirë për t’u përcaktuar, qëndron te kuptimi i ndryshimeve që janë bërë, brenda konteksteve shoqërore dhe historike. Por, ky nuk duhet të jetë sugjerim se “një person i quajtur

¹ White, Jonathan. *Terrorism and Homeland Security*. Boston: Cengage Learning, 2013, (f. 94).

² Uluc Ozulker, ekspert turk për çështje të sigurisë.

³ Sun Tzu, gjeneral dhe filozof i njohur kinez (vitet 500 p.e.s), autor i librit “Arti i Luftës”, i përkthyer në shumë gjuhë të botës.

⁴ Cooper, H. H. A. “Terrorism: The problem of Definition Revisited”. *Chitty’s Law Journal*, 26(3), 105–108.

Dr. Cooper është president i Nuevevidas International, Inc, një kompani në Texas që shërben si konsulente e specializuar në çështjet e sigurisë dhe mbijetesës. Ai drejtoi task-forcën kombëtare të Komitetit Këshillues mbi çrregullimet dhe terrorizmin, 1974-1977, dhe ishte drejtori i Arsimit Penal dhe Qendrës Kërkimore (CLEAR) si dhe zëvendës-drejtor i Qendrës së Psikiatrisë Ligjore të Universitetit të Nju Jorkut. Dr. Cooper është autor i shumë veprave që kanë të bëjnë me terrorizmin dhe manifestime të tjera të dhunës së jashtëzakonshme.

Memaj, B.
dhe
Duqi, A.
« Siguria dhe
antiterrorizmi »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

terrorist nga një pjesë e popullsisë, është luftëtar i lirisë (hero) i një pjesë tjetër të popullit⁵. Mjafton kjo, që kuptimi, por edhe qëndrimi ndaj terrorizmit, të luhatet. Ndryshimi në këtë kuptim, ndodh sepse terrorizmi nuk është një entitet i ngurtë. Ashtu si krimi, i cili është një përcaktim shoqëror edhe kuptimi i tij ndryshon me ndryshimin social.

Panorama sociale e frikës e zhvesh njeriun nga dinjiteti, i heq atij mundësinë të konsiderojë liritë e tij brenda *kontratës sociale* me shtetin dhe duke kaluar në heshtje shoqërore, bëhet gjithnjë e më e frikshme gjendja e sigurisë në një vend i cili aspiro integrimin me meritë në hapësirën euroatlantike. Në botën e sotme moderne urbane, asnjë individ nuk preferon të lëvizë, të punojë apo të jetojë në një vend të pasigurt. Ambienti i pasigurt ngjall gjithnjë ndjenjën e frikës dhe kufizon liritë individuale. Pasiguria, shpeshherë bëhet shkak për ndërprerjen e një veprimi, për mbylljen e një aktiviteti apo të një ndërmarrje të caktuar, për mbylljen e njerëzve në shtëpi për ndryshimin e vendbanimit, etj. Siguria, si një element thelbësor është trajtuar që në shekullin e XVI, kur filozofët e teorisë mbi shtetin, Thomas Hobs dhe Xhon Lok, e vendosën atë në fokusin e marrëdhënieve midis shtetit dhe individit. Në rast se nuk ekziston shteti, atëherë çdonjëri ka të drejtë të bëjë gjithçka dhe në mënyrë që të ndërpritet lufta e çdonjërit kundër tjetrit, është e nevojshme një kontratë sociale, për domosdoshmërinë e fjalës dhe të mendimit të lirë brenda shtetit sovran, midis individëve nga njëra anë dhe shtetit monopol, në anën tjetër.

Kjo teori u zhvillua më vonë nga filozofi i madh holandez, Baruch de Spinoza, i cili në mënyrë universale përkufizoi funksionet e shtetit midis lirisë dhe sigurisë së njerëzve: *“Qëllimi final i shtetit nuk është të qeverisë, të mbajë njerëzit nën frikë, ose të mposhtë rrezikun e huaj, por është shumë herë më i madh - t’i çlirojë ata nga frika, në mënyrë që secili të jetojë i sigurt dhe e drejta natyrore e tij, të jetë, të mbrohet dhe të veprojë pa dëm për veten dhe të tjerët. Qëllimi i shtetit është në fakt, Liria⁶”.*

Po kush e kërcënon sot në botë, më shumë, sigurinë e shteteve dhe lirinë e qytetarëve? Padyshim që të gjithë studiuesit dhe qytetarët në këtë rast janë të një mendjeje. Rreziku më i madh sot në botë janë terroristët dhe terrorizmi. Terrorizmi nuk ka ngjyrë, nuk ka atdhe, nuk ka fe, nuk njih kufij. Por megjithëkëtë, në mënyrë të veçantë, vitet e fundit, rreziku i terrorizmit islamik është rritur së tepërmi në botë. Në këtë shkrim do përpiqemi që të paraqesim një panoramë të konteksteve të përbashkëta të terrorizmit, shkaqet e terrorizmit, masat e sigurisë si dhe kundërpërgjigjet ndaj terrorizmit nga institucionet kombëtare dhe ato ndërkombëtare.

1. Kontekste të përbashkëta të terrorizmit

Në vazhdim po shqyrtojmë disa përkufizime të përbashkëta të terrorizmit. Këto përkufizime janë me vlerë për t’i shqyrtuar, por është më e rëndësishme të kuptojmë se përcaktimet e terrorizmit si nocione teorike nuk kanë ndonjë vlerë shumë të dobishme. Kryesor është fakti, i njohur ndërkombëtarisht tashmë, që terrorizmi është rreziku më i madh që po kërcënon botën e civilizuar. Ne duhet të kuptojmë kontekstin e përkufizimit, para se të aplikojmë termin. Përkufizimi i terrorizmit gjithmonë ndryshon me rrethanat shoqërore dhe historike, por jo vetëm kaq, në të kanë shumë rëndësi edhe interesat midis shteteve e pse jo edhe marrëdhëniet midis tyre në histori, të cilat kanë

⁵ White, Jonathan. *Terrorism*. . . (f. 217).

⁶ De Spinoza, Benedictus. *The Selected Works of Baruch de Spinoza, vol 1*. Library of Alexandria. Baruch de Spinoza, (1632-1677) ishte një filozof i njohur holandez.

prodhuar detyrime të ndërsjella. Si rezultat, përkufizimi mbi terrorizmi paraqitet në disa variante, nga studiues të ndryshëm, të cilët nisen nga argumenti që “ne nuk e dimë se si ta përkufizojmë saktë terrorizmin, por dimë se çfarë është ai, pasi ne e shohim atë”. Duket se citimi i H. H. A. Cooper për terrorizmin, është me të vërtetë i saktë. Para shqyrtimit të përkufizimit të terrorizmit, është e dobishme që të shqyrtohet kuptimi i terrorizmit brenda kornizave të veçanta. Është më e dobishme që të kuptojmë kontekstin e terrorizmit se sa të mësojmë përmendësh një shumëllojshmëri përkufizimesh. Në vijim, janë disa çështje kontekstuale që duhen marrë në konsideratë. Disa përkufizime mbi terrorizmin, nga Bashkimi Europian dhe nga Departamenti i Mbrojtjes së SHBA,⁷ janë si më poshtë:

a. Përkufizimi i Bashkimit Europian për terrorizmin: *Sulm i qëllimshëm i kryer nga një individ ose grup kundër një ose më shumë vendesh, institucioneve të tyre ose popullsisë me qëllim frikësimin e tyre dhe ndryshimin e strukturave politike dhe ekonomike.*

b. Përkufizimi i Departamentit të Mbrojtjes të SHBA-së për terrorizmin: *Dhunë e paramenduar dhe e jashtëligjshme ose kërcënim për dhunë me qëllim shkaktimin e frikës; për të detyruar ose frikësuar qeveritë për zbatimin e objektivave të tyre.*

c. Përkufizimi i Departamentit të Shtetit të SHBA-së për terrorizmin: *Dhunë e paramenduar dhe e motivuar politikisht kundër objektivave joluftuese nga grupe ndërkombëtare apo agjentë klandestinë, me qëllim influencimin në popull.*

Në nëntor 2004, një raport i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, e përshkruante kështu terrorizmin: “Çdo akt që ka për qëllim të shkaktojë vdekje ose lëndime të rënda trupore, ndaj civilëve apo joluftëtarëve, me qëllim frikësimin e popullatës apo t’i imponuar një qeverie apo një organizate ndërkombëtare bërjen ose mosbërjen e ndonjë akti”.

2. Historia

Kuptimi i terrorizmit ka ndryshuar me kalimin e kohës. Është pothuajse e pamundur të flitet për terrorizmin, pa diskutuar për kontekstin historik të fushatës terroriste. Termi “terrorizëm” vjen nga fjala franceze *terrorisme*, dhe në fillim i referohej në mënyrë specifike terrorizmit shtetëror, siç u praktikua nga qeveria franceze gjatë Mbretërimit të Terrorit, 1793-1794. Fjala franceze *terroriste*, nga ana e saj, rrjedh nga folja latine *terreo*, që do të thotë “frikësoj”. *Terror cimbricus* ishte paniku dhe gjendja e jashtëzakonshme e Romës, si shkak i afrimit të luftëtarëve të fisit Cimbri, në vitin 105 para Krishtit. Jakobinët e përdorën këtë precedent, kur vendosën një regjim terrori gjatë Revolucionit Francez. Pas humbjes së pushtetit nga jakobinët, fjala “terrorist” u bë një term abuzimi. Edhe pse “terrorizmi” fillimisht i referohej akteve të kryera nga një qeveri, aktualisht ajo zakonisht i referohet vrasjes së njerëzve të pafajshëm për qëllime politike në mënyrë të tillë që të krijojë një spektakël mediatik. Ky kuptim të çon shumë kohë përpara tek Sergej Nechayev, i cili e përshkonte veten si një “terrorist”. Nechayev themeloi grupin terrorist “Hakmarrja e Popullit” rusisht (narodnaja rasprava) në vitin 1869. Terrorizmi modern e ka origjinën nga Revolucioni Francez (1789-1795). Ai është përdorur si një term për të përshkruar veprimet e qeverisë franceze. Nga 1848, kuptimi i termit ndryshoi. Ai është përdorur për të përshkruar revolucionarët e

Memaj, B.
dhe
Duqi, A.
« Siguria dhe
antiterrorizmi »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

⁷ White, Jonathan. *Terrorism*. . . . (f. 438).

dhunshëm që revoltohen kundër qeverive. Deri në fund të viteve 1800 dhe fillim të viteve 1900, terrorizmi është përdorur për të përshkruar aktivitetet e dhunshme të disa grupeve përfshirë këtu organizatat e punës, anarkistët, grupet nacionaliste të revoltave kundër fuqive të huaja dhe organizatat ultranacionaliste politike.

Pas Luftës së Dytë Botërore (1939-1945), kuptimi ka ndryshuar përsëri, ndërsa njerëzit e revoltuar nga dominimi evropian i botës, u konsideruan nga grupe nacionaliste si grupe terroriste. Nga viti 1964 deri në fillim të viteve 1980, termi terrorizëm është aplikuar edhe për grupet e dhunshme të krahut të majtë, si dhe për nacionalistët. Në mes të viteve 1980, kuptimi ndryshoi përsëri. Në Shtetet e Bashkuara, disa prej veprimtarive të dhunshme të lëvizjes me sfond urrejtjeje, ishin përcaktuar si terrorizëm. Ndërkombëtarisht, terrorizmi shihej si një luftë në nivel kombëtar. Terroristët janë sponsorizuar nga regjime të papërgjegjshme. Ashtu siç shekulli ndryshoi, përcaktimet e terrorizmit gjithashtu ndryshuan. Sot terrorizmi i referohet edhe grupeve të mëdha që janë të pavarur nga një shtet, fanatikëve të dhunshëm fetarë dhe grupeve të dhunshme që terrorizojnë për një arsye të veçantë. Kemi pasur raste, që këtë epitet e kanë nënvizuar jo vetëm për grupe, por edhe për shtete të veçanta. Është e rëndësishme të kuptohet, se çdo përkufizim është i ndikuar nga konteksti historik i terrorizmit.

3. Feja

Në vitet e fundit, feja ka luajtur një rol më të rëndësishëm në procesin e terrorizmit. Kjo do jetë e shqyrtuar plotësisht në vijim, por është e rëndësishme që të kuptohet se besimet ekstreme fetare sigurojnë një kontekst për përkufizimin e terrorizmit. Dhuna fetare përqendrohet rreth tri burimeve. Së pari, disa grupe fetare ndjehen si përgjegjës për pastrimin e botës për një epokë të re. Kjo mund të përkufizohet si eskatologji e dhunshme. Së dyti, disa grupe ndjehen si të zgjedhur dhe mund të shkatërrojnë njerëz të tjerë në rrugën e drejtësisë. Ky lloj qëndrimi mund të çojë në intolerancë të dhunshme dhe luftë fetare. Së treti, njerëz të ndryshëm mund të konsumohen me këtë qëllim të caktuar dhe ata krijojnë një fe zëvendësuese duke ndërmarrë veprime të dhunshme, për të çuar para besimin e tyre. Terroristët eskatologjikë shërbejnë si një shembull i këtij lloji të terrorizmit pseudofetar.

4. Ndryshimi i kontekstit

A mund të mendojmë për faktorë të tjerë kontekstualë që ndikojnë në përkufizimin e terrorizmit? Lista është ndoshta e pafund. Pavarësisht kësaj, mjafton që të jemi të vetëdijshëm se përkufizimi i terrorizmit ndryshon nga kontekstet politike dhe sociale. Ndoshta, nuk është shumë e këndshme, që kur studion mbi terrorizmin të mos kesh mundësinë të bësh një përkufizim përmbledhës, por kjo pamundësi varet nga kushtet, rrethanat e ngjarjeve që kanë ndodhur dhe efekti i tyre në publik. Analisti i terrorizmit, Alex Schmid⁸ (1983) thotë se, pa marrë parasysh se si ne e përkufizojmë terrorizmin, përkufizimi gjithmonë do të luhatet për shkak të kontekstit të ndryshimeve të dhunshme të aktivitetit. Ne nuk mund ta përkufizojmë saktë terrorizmin. Duke pasur në mendje këtë dobësi, është koha që të shikojmë disa nga përkufizimet më të njohura mbi terrorizmin.

⁸ Schmid, Alex P. *Political Terrorism*. New Brumstick: Transaction Books, 1983, (f. 5).

5. Disa përkufizime të përbashkëta

Përkufizimi i përdorur më gjerësisht në drejtësisë penale, ushtarake dhe qarqet e sigurisë është një vështrim shumë i thjeshtë nga Brian Jenkins⁹, një studiues i njohur gjerësisht si specialist i sigurisë kundërterroriste dhe nga Walter Laqueur¹⁰, një tjetër autoritet drejtues, nga Universiteti i Georgetown. Ata e përkufizuan terrorizmin veç e veç, por habitshëm, arritën në përfundime të ngjashme. Jenkins ofron një përkufizim që ai e ka përdorur shpesh, duke u konsultuar me forcat e sigurisë.

Jenkins (1984) e quan terrorizmin si: “*Përdorim ose kërcënim i përdorimit të forcës, i dizajnuar dhe i projektuar për të sjellë një ndryshim politik.*” Në një përkufizim të lidhur ngushtë me atë të Jenkins, Laqueur (1987, f. 72) thotë se: “*Terrorizmi përbën përdorimin e paligjshëm të forcës për të arritur një objektiv politik, duke synuar njerëz të pafajshëm.*” Ai shton se përpjekjet për të lëvizur përtej përkufizimit të thjeshtë janë të pafytyrshme, sepse termi është aq i diskutueshëm. Vëllime të tëra mund të shkruhen në përkufizimin e terrorizmit, shkruan Laqueur në një shënim, por ata nuk do të shtojnë një gërmë të alfabetit grek për të kuptuarit tonë të temës.

Në një punë më vonë, Laqueur (1999, f. 8-10) promovon një përkufizim të thjeshtë, vetëm duke argumentuar se kuptimet dhe përkufizimet të luhaten me historinë. Të dy Jenkins dhe Laqueur, lirisht pranojnë problemet me qasjen e tyre të thjeshtë. As përkufizimi nuk e kufizon temën dhe nuk ka asnjë mënyrë kuptimplote për të aplikuar një përkufizim të thjeshtë për aktet specifike të terrorizmit. Përkufizimet e thjeshta gjithashtu i lënë akademikët, politikëbërësit, dhe shkencëtarët sociale të frustruar. Me pak fjalë, thjeshtësia nuk e zgjidh problemin e paraqitur nga Profesor Cooper. Megjithatë, Laqueur ve ne dukje se është e nevojshme për të jetuar me problemet dhe dobësitë e përkufizimit të thjeshtë, sepse terrorizmi gjithmonë do të thotë gjëra të ndryshme në njerëz të ndryshëm. Me këtë në mendje, le ti shqyrtojmë qëndrimet e Laqueur dhe Jenkins. Nga një perspektivë e sigurisë, konkluzioni i Laqueur-së ka kuptim: *terrorizmi është një formë e dhunës politike apo kriminale duke përdorur taktika ushtarake për të ndryshuar sjelljen përmes frikës.* Kjo qasje e thjeshtë nuk i zgjidh problemet politike të përkufizimit, por ajo lejon personelin e sigurisë për të lëvizur përtej debateve të pafundme. Çdokush i ngarkuar në luftën kundër terrorizmit është duke u përpjekur për të parandaluar sulmet kriminale ushtarake kundër njerëzve të pafajshëm në një zonë joluftuese. Nisur nga përkufizimi se terrori, në kuptimin e tij më të gjerë, *është dhunë me qëllime politike e ushtruar kundër objektivave joushtarake.* E thënë ndryshe, shënjestra e terrorit janë civilët e pafajshëm në tërësi, krimi i vetëm i të cilëve është që në sytë e terroristëve, ata përfaqësojnë “krahun tjetër” ose ndodhen në krahun tjetër. Për këtë arsye, terror do të thotë që njerëzit e pafajshëm t’i nënshtrohen dhunës dhe kjo përbën një akt të zhveshur nga çdo justifikim moral. Kjo, njëlloj si në rastet e vrasjeve të kryera nga Stalini apo Hitleri, përbën një krim kundër njerëzimit. Përkufizimet ligjore janë shpesh dritëshkurtra.

Memaj, B.
dhe
Duqi, A.
« Siguria dhe
antiterrorizmi »

⁹ Jenkins, Brian M. “The Jihadists Operational Code”, David Aaron (red.), *Three Years After: Next Steps in the War on Terror*. Santa Monica, CA: Rand Corporation, 2005.

Brian Jenkins, specialist sigurie dhe autor amerikan i disa librave mbi terrorizmin, si: “Kodi operacional i xhihadistëve” (2004), “Lufta ndaj Al Qaeda-s: një vlerësim i situatës dhe sugjerimet për një strategji” (2002).

¹⁰ Laqueur, Walter. *The New Terrorism: Fanaticism and the Arms of Mass Destruction* (rib.). Oxford University Press, 2000.

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

Martha Crenshaw¹¹ (1983) thotë se terrorizmi nuk mund të përcaktohet, edhe nëse akti, objektivi dhe mundësia e suksesit janë analizuar. Sipas kësaj qasjeje, luftëtarët e lirisë përdorin metoda legjitime ushtarake për të sulmuar caqet legjitime politike. Veprimet e tyre janë të legjitimeuara më pas, kur ata kanë mundësi për fitimin e konfliktit. Terroristët dështojnë në testin e legjitimitetit, në një nga këto tre kategori: metodat ushtarake, objektivat ushtarake dhe shanset për fitore. Crenshaw gjithashtu sugjeron, se dhuna revolucionare nuk duhet të ngatërrohet me terrorizmin. Për Crenshaw, *terrorizëm do të thotë dhunë shoqërore dhe politikisht e papranueshme, duke synuar një objektiv të pafajshëm, për arritjen e një efekti psikologjik*. Dallime të tilla analitike e kanë ndihmuar Crenshaw-n, që të jetë një autoritet kryesor në përkufizimin e terrorizmit, por edhe në këtë përkufizim mbeten përsëri dy probleme. Kushdo që ka pushtetin politik për të përcaktuar “legjitimitetin”, ka fuqinë për të përkufizuar terrorizmin. Përveç kësaj, përkufizimi analitik, nuk ka lëvizur larg nga përcaktimi i thjeshtë. Në një përpjekje për të zgjidhur dilemën e përkufizimit të terrorizmit, Alex Schmid (1983, fq. 70-111) përpiqet të sintetizojë variacione të ndryshme. Ai arrin në përfundimin se nuk ka përkufizim të vërtetë apo të saktë, sepse terrorizmi është një koncept abstrakt, pa prani reale. Së fundmi, disa njerëz e injorojnë krejt problemin. Ata flasin për terrorizmin, duke pranuar atë që njohin sipas mënyrës që ata kuptojnë.

6. Të kuptojmë shkaqet e terrorizmit

Nga shumë aspekte, shkaqet e terrorizmit janë të njëjta me shkaqet e shumicës së formave të tjera të dhunës politike (si rebelimet, kryengritjet, grushtet e shtetit dhe luftërat civile)¹². Në një shoqëri, individët mund të ndjehen të pakënaqur ose të frustruar me paaftësinë e tyre për të sjellë ndryshime që i konsiderojnë të nevojshme, çka i shtyn ata drejt dhunës. Disidentët kanë perceptimin se shoqëria dhe sistemi politik i diskriminojnë ose janë të padrejtë karshi tyre. Ajo çka është më e rëndësishme, është se perceptimet e disidentëve mund të udhëheqin një numër të madh njerëzish drejt përpjekjes për ndryshim të dhunshëm. Megjithatë, ekzistojnë disa faktorë specifikë që mund të kontribuojnë në shpërthimin e terrorizmit. Demokracitë, me kufizimet që i vendosin forcave të sigurisë, krijojnë shanse veprimtarie për terroristët. Po ashtu, pjesëmarrja e kufizuar politike dhe represioni i forcave qeveritare mund të ushqejë pakënaqësinë e nevojshme popullore për t’iu drejtuar dhunës, por shtetet me forca të mëdha sigurie dhe kontroll të rreptë mbi shoqëritë e tyre, mund të parandalojnë zakonisht operimin e terroristëve. Disidentët realë dhe ata potencialë, mund të burgosen, të dyshuarit mund të torturohen, familjet mund të mbahen peng dhe bindjet mund të garantohen në gjykata (gjithmonë nëse kryhen gjyqe). Kur ish-Bashkimi Sovjetik ishte një shtet i fuqishëm dhe i centralizuar, terrorizmi ishte praktikisht i panjohur. Por tani, shtetet pasuese nga rënia e tij, janë më të dobëta dhe disa prej tyre, si për shembull vetë Rusia, janë përballur me probleme të theksuara terrorizmi. Po kështu, është pikërisht paaftësia e qeverisë së Kolumbisë, për të funksionuar me efikasitet në shumë rajone të vendit, ajo që u ka siguruar terroristëve dhe guerilëve, shanse të mëdha aktiviteti, ndërsa karteleve të drogës mundësi për të mbijetuar dhe prosperuar. Në të njëjtën mënyrë, struktura prej shteti të dobët e Libanit, gjatë viteve të fundit të shekullit të

Memaj, B.
dhe
Duqi, A.
« Siguria dhe
antiterrorizmi »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

¹¹ Crenshaw, Martha (red.) *Terrorism, Legitimacy, and Power: The Consequences of Political Violence*. Connecticut: Wesleyan University Press, (f. 1-37).

¹² White, Jonathan. *Terrorism...* (f.147).

njëzetë, u lejoj grupeve terroriste të organizoheshin dhe të operonin në vend. Libani jo vetëm që u bë arenë e përdorimit të terrorizmit në përlëshjet për shtrimin e kontrollit mbi vendin, por u shndërrua edhe në bazë të grupeve terroriste që vepronin tjetërkund.

Në shpërthimin e terrorizmit, kanë kontribuar edhe proceset e globalizimit. Me rritjen e shpejtësisë së komunikimit dhe të transportit në shoqëritë lokale ndërfuten forca të jashtme, zakonisht Perëndimore¹³. Ekonomitë tronditen dhe ndonëse numri i fituesve e kalon atë të së humburve, gjithsesi nuk mund të mohohet ekzistenca e këtyre të fundit. Për më tepër kulturat lokale, përfshirë komponentët lokalë, kërcënohen nga globalizmi, veçanërisht kur ai shoqërohet nga laicizmi. Në shumë raste, terrorizmi mund të shihet si reagim ndaj globalizmit. Grupet majtiste anembanë globit, kanë kundërshtuar përhapjen e kapitalizmit dhe të këqijave që ai sjell me vete. Globalizmi laik çon gjithashtu në fragmentarizëm fetar dhe etnik. Shumë grupe fetare (qofshin ato të krishtera, hebraike, myslimane apo hindu) i kundërvihen laicizmit që sjell moderniteti. Nga ana tjetër, grupet e djathta etnocentrike i janë kundërvënë zbehjes së traditave të tyre kulturore nga idetë e huaja, që vijnë bashkë me emigrantët, punëtorët e huaj dhe refugjatët. Do të ishte ndoshta ironik fakti, që myslimanët në Lindjen e Mesme ndjehen të kërcënuar nga ndërhyrja e paftuar e vlerave evropiane ose Perëndimore dhe paralelisht, grupe të ndryshme në Europë, ndjehen të kërcënuar nga individë prej kulturave të Lindjes së Mesme dhe ideve islamike.

Gjithashtu, terrorizmi që i ka rrënjët në dallimet etnike, mund të pasqyrojë ndërhyrjen e forcave të jashtme, ndërsa grupe si irlandezët apo baskët, ndjehen të frikësuar për humbjen e gjuhës dhe kulturës së tyre brenda një identiteti më të gjerë etnik. Ekziston dhe një lidhje tjetër e mundshme, midis demokracisë dhe nacionalizmit, që ka ardhur së bashku me globalizmin, ose ka qenë përgjigje ndaj tij. Mbivendosja që ekziston midis demokracisë dhe nacionalizmit, paraqet më shumë shanse për terrorizmin. Nacionalizmi siguron një shkëndijë, e cila mund të përshkallëzojë dhe hiperbolizojë dallimet etnike, ndërsa demokracia lejon shprehjen e lirë të pikëpamjeve të kundërta nacionaliste. Dallga e demokratizimit që u vu re në fund të shekullit të njëzetë, mund të ketë rritur shanset e shpërthimeve të reja të fenomenit të terrorizmit, ndonëse rritja dhe forcimi i demokracisë në vende të qëndrueshme, mund të mënjanojë eventualisht shumë prej kushteve që kontribuojnë në terrorizëm.

7. Masat e sigurisë

Nuk ekziston një arsye ose burim i vetëm i terrorizmit. Kjo ndodh, pjesërisht për shkak se terrorizmi është një teknikë që mund të përdoret nga grupe të ndryshme në mbështetje të kauzave të ndryshme. Ndërsa terrorizmi dhe terroristët janë analizuar nga një sërë perspektivash teorike, një prej teorive më të dobishme ka qenë ajo e propozuar nga Peter Sederburg (2003)¹⁴, i cili sugjeronte se terrorizmi mund të shihet nga tre pikëpamje. Sipas qasjes së parë, terrorizmi mund të trajtohet në kontekstin e një armiku, i cili duhet mposhtur në luftë. Analogjia e luftës, pretendon se përdorimi i metodave ushtarake mund të jetë i suksesshëm dhe se fitorja është e mundur të garantohet nëpërmjet tyre. Një perspektive e dytë për tu përballur me terroristët, është ajo e

*Memaj, B.
dhe
Duqi, A.*
« Siguria dhe
antiterrorizmi »

¹³ Ibid, (f. 91).

¹⁴ Sederburg, Peter C. "Global Terrorism: Problems of Challenge and Response". Charles W. Kegley, Jr. (ed.), *The New Global Terrorism: Characteristics, Causes, Controls*. Upper Saddle River, NJ: Prentice Hall, 267–84, 2003.

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

përdorimit të teknikave normale policore. Analogjia e terroristit me kriminelin e zakonshëm, ka dy rrjedhoja tepër të rëndësishme: së pari, ajo sugjeron se terrorizmi, sikurse nuk mund të zhduket, mund vetëm që të frenohet; së dyti, kjo qasje është në thelb reaguese, pasi sipas saj kriminelët zakonisht kapen pasi ata i kanë kryer krimet.

Perspektiva e tretë e konsideron terrorizmin si një sëmundje, duke vënë theksin mbi simptomat dhe shkaqet e thella të tij. Ajo presupozon ekzistencën e nevojës për strategji afatgjata, ndonëse përgjatë kësaj rruge mund të arrihet sukses në trajtimin e simptomave. Sigurisht që të tria perspektivat e sipërpërmendura, nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën, por ato mund të përfaqësojnë mënyrat kryesore nëpërmjet të cilave shihet terrorizmi. Ato janë të rëndësishme për analizimin e fenomenit dhe për zyrtarët qeveritarë, të cilët bëjnë zgjedhjet e tyre për mënyrën e përbaljes me aktivitetin terrorist. Implementimi i njëres prej këtyre strategjive, do të sugjerojë edhe mekanizmat për t'u përballur me terrorizmin. Tipologjia e trefishtë, e paraqitur me lart nga Sederberg, është e përshtatshme si pikë reference, sepse disa masa sigurie ose antiterrorizmi janë më tepër në koherencë me pikëpamjen e terrorizmit si luftë; të tjera, përkrijnë me qasjen ndaj terrorizmit si krim, kurse të tjera akoma, janë më afër këndvështrimit të kësaj dukurie si sëmundje. Masat antiterrorizëm mund të vlerësohen edhe brenda kontekstit të parandalimit, kundërpërgjigjes ndaj sulmeve, bashkëpunimit ushtarak dhe efekteve të masave të sigurisë mbi liritë dhe të drejtat civile.

8. Parandalimi i terrorizmit

Parandalimi lidhet zakonisht me konceptin e terrorizmit si luftë ose krim¹⁵. Të gjitha qeveritë do të praktikojnë parandalimin që shihet si represion nga perspektiva e terroristit, duke u përpjekur të arrestojnë ose eliminojnë ata që përfshihen aktivisht në dhunë. Kështu, forcat e sigurisë i sulmojnë terroristët përpara se këta të godasin (koncepti i luftës preventive), ose i arrestojnë ata pas sulmit (koncepti i terrorizmit si krim). Përzgjedhja e linjës për të luftuar terrorizmin, ndihmon qartazi në përcaktimin e politikës së sigurisë. Kështu për shembull, të konceptuarit e tij si luftë, lejon një përgjigje më të fuqishme parandaluese. Megjithatë realiteti tregon se në këto raste funksionet e ushtrisë dhe të policisë nuk kanë një ndarje të saktë midis tyre. Forcat e policisë që përballesh me kriminelët të rrezikshëm (qofshin ata terroristë ose jo) mund “të qëllojnë të parët dhe të pyesin më vonë”. Si në modelet e luftës ashtu edhe në ato të krimit, mund të ekzistojë dëshira për t'i kapur terroristet të gjallë për të nxjerrë prej tyre informacione të mëtejshme. Disa herë kjo bëhet duke iu ofruar terroristëve dëmtime më të vogla në shkëmbim të informacionit. Informatorët, qofshin ata anëtarë që kanë ndërruar anë apo agentë brenda grupeve terroriste, mund të jenë vlera kyçe për forcat e sigurisë në mbledhjen e informacionit. Grumbullimi i informacionit bëhet i vështirë për grupe të vogla terroriste, pasi ato kanë zakonisht kohezion të lartë që nuk mundëson infiltrim efikas. Megjithëse penetrimi dhe mbledhja e informacionit është më e lehtë në organizata më të mëdha, ka më pak gjasa që të arrihet të ndalohen të gjitha operacionet e tyre, përveçse me kalimin e kohës. Në mënyrë të ngjashme, rrjete të gjera si, Al Qaeda, ISIS dhe grupet ekstremiste të djathta në Europë nuk ka gjasa të shpërbehen vetëm për shkak të ndonjë puçi informativ. Gjithsesi ato mund të dobësohen nga veprimet e bazuara në mbledhjen e suksesshme të informacionit.

Memaj, B.
dhe
Duqi, A.
« Siguria dhe
antiterrorizmi »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

¹⁵ Collin, Alan. *Studime bashkëkohore të sigurisë*, (përk. Enri Hida). Tiranë: UET press, 2009.

Masa më të mëdha të sigurisë fizike janë një tjetër opsion parandalues që ka vlerë nëse dikush e sheh terrorizmin si luftë, si krim apo si sëmundje. Jo çdo objektivi i mundshëm mund të mbrohet, por duhet të sigurohen gjithsesi pika kyçe, përfshirë këtu burime materiale për armë të shkatërrimit në masë. Në raste të tjera, siguria mund të përfordhet për shumë objektiva potenciale, edhe pse është e pamundur të ndalohen të gjitha sulmet. Disa aktivitete terroriste mund të zbrapsen, ndërsa në raste të tjera disa anëtarë të grupeve disidente mund të kapen ose vriten si rrjedhojë e përmirësimit të nivelit të sigurisë. Por, këto masa parandaluese nuk do t'i ndalojnë terroristet që janë vendosur të kërkojnë objektiva të tjerë, më të prekshëm. Rritja e sigurisë nënkupton medoemos kosto më të larta, ndërsa paratë e shpenzuara për sigurinë fizike dhe forcimin e objektivave të sigurisë kombëtare e ndërkombëtare, nuk janë aktualisht të disponueshme nga shumë vende në botë.

9. Kundërpërgjigjet ndaj terrorizmit

Kundërpërgjigjet ndaj sulmeve terroriste ndryshojnë në mënyrë të hapur apo të heshtur në varësi të qasjes ndaj terrorizmit si luftë, krim ose sëmundje. Nëse bazohemi në analogjinë e terrorizmit me luftën, atëherë shpagimi dhe dënimi bëhen normat bazë. Reagimet potenciale, janë goditjet parandaluese kundër strukturave stërvitore, shtabeve qendrore, apo vrasjet e individëve kyç të organizatave terroriste. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët e tyre, janë përpjekur t'i ndjekin këto strategji kundër Al Kaedës. Arrestimet, ndalimet, gjyqet (të paanshme ose jo) dhe burgosjet, reflektojnë qasjen ndaj terrorizmit, si krim. Qëllimi final i forcave policore është të parandalojnë veprimin duke treguar se kriminelët do të kapen dhe ndëshkohen. I njëjti qëllim është i pranishëm edhe në rastin e terroristëve: kapja dhe ndëshkimi i tyre është i pashmangshëm. Ndërsa analogjia e terrorizmit me luftën, presupozon hera-herës edhe parandalimin, që për një sistem gjyqësor kjo është më thelbësore. Sulmet preventive dhe vrasjet, nuk janë normalisht pjesë e arsenalit të luftës kundër kriminit, përveçse në rastet kur një qeveri krijon skuadrat e vdekjes si një formë e dhunës shtetërore, ose u lejon grupeve në aleancë me qeverinë të sulmojnë në këtë formë. Në këto rrethana, qeveritë zhvendosen nga qasja e luftës kundër kriminalitetit drejt analogjisë së luftës. Shkalla e parandalimit në dispozicion të një konteksti të zakonshëm kriminal, varion nga arrestimi i të dyshuarve deri ndoshta në përndjekjen ligjore. Situatat e pengmarrjes, janë një fushë ku terrorizmi si krim është përgjigja më e shpeshtë. Zakonisht, forcat policore janë të pajisura dhe të trajnuara më mirë për tu përballuar me situata të këtij lloji. Për një praktikë tipike policore, nuk janë të huaja as përpjekjet e shpëtimit (çlirimit të pengjeve). Përgjigja nëpërmjet luftës, nënkupton se ajo i sheh pengjet më shumë si viktima të mundshme aksidentale të konfliktit, në vend që të vlerësojë si objektiv parësor sigurinë e tyre.

Nëse terrorizmi shihet si sëmundje, atëherë ndryshon gama e kundërpërgjigjeve të mundshme. Përderisa sëmundjet kanë shkaqe dhe simptoma, qasja ndaj tyre kërkon që të aplikohen disa nga përgjigjet që lidhen me pikëpamjet e luftës dhe të kriminit. Si simptomë, dhuna terroriste do të duhet të përballohet nëpërmjet arrestimeve ose parandalimit. Këndvështrimi i sëmundjes çon gjithashtu drejt përpjekjeve për t'u marrë me shkaqe themelore. Paketat e reformave mund të bëhen pjesë e kundërpërgjigjes së qeverisë në një përpjekje për të pakësuar përkrahjen e grupeve terroriste nga popullsia. Nëse ekzistojnë diskriminime etnike ose fetare, mund të miratohen ligje kundër tyre. Nëse varfëria perceptohet si ushqyese e mbështetjes për terroristët, atëherë mund të

*Memaj, B.
dhe
Duqi, A.*
« Siguria dhe
antiterrorizmi »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

krijohen programe qeveritare për të pakësuar varfërinë në një rajon ose grup të caktuar¹⁶. Nëse terroristët operojnë në një situatë koloniale, atëherë reforma finale e mundshme është ajo e dhënies së pavarësisë nga fuqia koloniale. Por ndërkohe, është argumentuar se reformat nuk do arrijnë gjë tjetër veçse të inkurajojnë terroristët për të vazhduar dhunën e tyre, duke qenë se po shpërblehen.

Sikurse ka argumentuar një lider i një grupi terrorist, është fituar shumë herë më tepër nga pak muaj dhunë, nga sa ishte arritur prej vitesh të tëra politikash paqësore. Në këto kushte, reformat mund të shndërrohen në lëshime që ushqejnë dhunë të mëtejshme, në vend që të jenë mekanizmat që do i japin fund asaj. Është e qartë, për shkaqe të tjera, se reformat nuk do e eliminojnë përherë praninë e terrorizmit. Kërkesat e disidenteve terroristë për të themeluar një shtet mbi baza fetare, një qeveri majtiste, apo për shtypjen e një minoriteti, ose për largimin e të gjithë të huajve, nuk mund të pranohen nga shumica. Ekstremistët e majtë në vitet '70-'80, në Europë, dëshironin të shembnin sistemin ndërkombëtar kapitalist, kurse shumica e qytetarëve europianë dëshironin të vazhdonte të merrte përfitime nga kapitalizmi. Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk mund ta ndalojnë përhapjen e globalizmit apo ndërhyrjen e vlerave nga jashtë dhe të kulturave të reja në Lindjen e Mesme. Globalizimi dhe përqaftimi i vlerave më të mira Perëndimore, janë kthyer në ditët e sotme në një faktor vendimtar për një botë më të sigurt dhe në paqe ndërmjet të gjitha religjioneve fetare.

10. Përfundime

Në ditët e sotme terrorizmi është çështja që debatohet më shumë se gjithçka tjetër. Sulmi i datës 07.01.2015 ndaj revistës satirike franceze *Charlie Hebdo* nuk ishte i vetmi incident i goditjes së medias evropiane nga ekstremistë islamikë. Ky ishte sulmi i dytë ndaj kësaj reviste satirike. Karikaturat e Profetit Muhamed në një revistë daneze shkaktuan protesta në një numër vendesh dhe në disa raste edhe incidente me dhunë në vitin 2005. Një kineast holandez u vra në vitin 2004 pasi realizoi një dokumentar për mënyrën si trajtohen gratë myslimane. Terrorizmi nuk është një fenomen i ri, është fenomen që është përdorur shpesh në historinë e njerëzimit, por kërcënimi që sjell terrorizmi tani është më serioz se asnjëherë tjetër. Sulmet apo aktet e tilla vitet e fundit, me fatkeqësi të mëdha në humbje njerëzish dhe dëme kolosale materiale, kërcënimet e vazhdueshme për akte të tilla, janë një panik, por jo vetëm kaq, por edhe një rrezik real që vazhdon të ekzistojë.

Në mënyrë të veçantë, pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001, sulmit ndaj kullave binjake në New York, u pa se asnjë shtet në botë nuk është më i sigurt, ndoshta edhe ata që pretendojnë se janë më të fortë¹⁶. Në këto kushte, kërcënimet terroriste dhe sulmet terroriste kërkojnë një vëmendje më të madhe për t'i studiuar. Qëllimi është që të njohim sa më mirë faktorët që i ndikojnë, kushtet se si ato zhvillohen, ideologjinë ku mbështeten, teknikat në përdorim, përgatitjen e gjithanshme që bëhet për të arritur qëllimin, etj. Të gjitha këto, por edhe të tjera janë domosdoshmëri për t'u njohur, me qëllim që të sfidohet ky fenomen i cili është prioritar për shekullin e 21-të.

Një numër i madh organizatash terroriste të llojeve të ndryshme, kanë një prezencë aktive në botë, natyrisht edhe në vendet e BE-së. Ndaj lufta kundër terrorizmit në përgjithësi dhe ndaj terrorizmit islamik në veçanti, konsiderohet e një rëndësie parësore

¹ Collin, Alan, *Studime...* (f. 104-117).

nga strukturat më të larta politike të vendeve të BE-së. Angazhimet e strukturave politike dhe ato të inteligjencës, tregojnë se terrorizmi ndërkombëtar është rritur në një nivel të atillë sa mund të cenojë paqen në të gjithë botën. Kjo gjë tregon potencialin e madh që zotërojnë organizatat terroriste. Ky organizim dhe ky potencial, por edhe rrjetet konspirative terroriste, të kombinuara me mundësinë për të vepruar në çdo vend të botës kërkojnë një kundërpërgjigje. Kjo kundërvënie kërkon një bashkëpunim të një niveli shumë të lartë dhe tepër serioz nga ana e autoriteteve apo organizatave të sigurisë.

Vendet e Europës janë të prekura nga mundësia e akteve terroriste, nga kërcënime të brendshme dhe të jashtme, të cilat duhen marrë seriozisht dhe asnjëherë nuk duhen nënvlerësuar, pasi historia na ka treguar se neglizhenca e këtyre sulmeve, apo mosmarrja në konsideratë e këtyre kërcënimeve nga institucionet e zbatimit të ligjit, përbën një rrezik serioz për sigurinë personale të çdo qytetari.

Për të luftuar terrorizmin, detyrim e ka çdo shtet dhe organizëm ndërkombëtar që është krijuar për të dhënë siguri. Në këtë sfidë ndaj terrorizmit, kërkohet bashkim forcash dhe marrëveshje midis shteteve për të qenë më efikas. Duke bërë këtë, ne ju mundësojmë shtetasve të jenë të lirë nga kërcënimet terroriste. Mposhtja e terrorizmit është sfidë dhe që ajo të fitohet, kërkohet një informacion i gjerë dhe cilësor, një panoramë e plotë dhe e qartë e gjithë aktivitetit të organizatave terroriste, e cila do të përbëjë bazën e fortë për vendimmarrje.

Referenca

1. White, Jonathan. Terrorism and Homeland Security. Boston: Cengage Learning, 2013.
2. Cooper, H. H. A. "Terrorism: The problem of Definition Revisited". Chitty's Law Journal, 26(3), 105-108.
3. De Spinoza, Benedictus. The Selected Works of Baruch de Spinoza, vol 1. Library of Alexandria.
4. Schmid, Alex P. Political Terrorism. New Brumstick: Transaction Books, 1983.
5. Jenkins, Brian M. "The Jihadists Operational Code", David Aaron (red.), Three Years After: Next Steps in the War on Terror. Santa Monica, CA: Rand Corporation, 2005.
6. Laqueur, Walter. The New Terrorism: Fanaticism and the Arms of Mass Destruction (rib.). Oxford University Press, 2000.
7. Crenshaw, Martha (red.) Terrorism, Legitimacy, and Power: The Consequences of Political Violence. Connecticut: Wesleyan University Press.
8. Sederburg, Peter C. "Global Terrorism: Problems of Challenge and Response". Charles W. Kegley, Jr. (ed.), The New Global Terrorism: Characteristics, Causes, Controls. Upper Saddle River, NJ: Prentice Hall, 267-84, 2003.
9. Collin, Alan. Studime bashkëkohore të sigurisë, (përk. Enri Hida). Tiranë: UET press, 2009.

Memaj, B.
dhe
Duqi, A.
« Siguria dhe
antiterrorizmi »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

Menaxhimi i burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit



■ **Msc Nikoll RICA**
Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Abstrakt

Nëpërmjet këtij shkrimi, synoj që të përcillet tek lexuesi, informacion i zgjeruar mbi rregullimin e marrëdhënieve të personelit në Policinë e Shtetit, sipas legjislacionit të ri të policisë dhe atij të nëpunësit civil. Këto marrëdhënie pune ndërtohen mbi bazën e rregullave dhe procedurave të paanshme që duhet të respektohen gjatë tërë fazave, duke filluar nga pranimi në polici, formimi, kualifikimi, zhvillimi i karrierës policore, trajtimi ekonomik-financiar si dhe marrëdhënie të tjera juridike, midis punonjësve dhe institucioneve të administratës së policisë në nivel qendror e lokal. Krijimi i një koncepti të qartë mbi menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore, përbën detyrën themelore të çdo drejtuesi policie dhe shërben si parakusht për të ndërtuar një strukturë eficiente që garanton mjedis pozitiv, ku qytetarët të ndjehen të lirë dhe të sigurt në aktivitetin e tyre ekonomik, shoqëror e social. Në hartimin e strategjive dhe programeve të zhvillimit, organizata e Policisë duhet të përcaktojë si prioritare objektivat e zhvillimit të burimeve njerëzore. Arritja e një shërbimi policor të qëndrueshëm e profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike, realizohet vetëm nëpërmjet menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore. Klasifikimi që u bën ligji i ri i Policisë së Shtetit burimeve njerëzore, duke i ndarë në: “punonjës policie”, “nëpunës civil” dhe “punonjës administrativ” përbën një diversitet profesional të këtij personeli, që i bashkon përgjegjësia institucionale në funksion të garantimit të rendit dhe sigurisë publike. Parimet bazë që respektohen në ushtrimin e kësaj përgjegjësie janë: ligjshmëria, mosdiskriminimi, respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, proporcionaliteti, pavarësia operationale, paanshmëria politike, integriteti, merita dhe profesionalizmi, transparencja, ruajtja e informacionit të klasifikuar, kontrolli dhe llogaridhënia. Menaxhimi dhe administrimi i burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit duhet të udhëhiqet gjithnjë nga këto parime, si garanci për qëndrueshmëri dhe efektivitet në detyrën e punonjësit të policisë.

Fjalëkyçe:

menaxhim, normë juridike, marrëdhënie personeli, karrierë, hierarki, nëpunës civil, punonjës policie, organizim strukturor, vlerësim individual, performancë, diversitet profesional.

Rica, N.
« Menaxhimi i burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit »

Policimi dhe Siguria nr.3, 2016

1. Kuptimi dhe rëndësia e marrëdhënieve të personelit në Policinë e Shtetit

Të gjitha veprimet që kryen policia nën autoritetin zyrtar të ligjit i atribuohen shtetit. Aktiviteti që ushtron, përfaqëson çështje të përgjegjesisë shtetërore në raport me qytetarët. Për rrjedhojë, shtetet, paralelisht me ngritjen e strukturave të policisë, përcaktojnë kritere, procedura si dhe zgjedhin burimet e përshtatshme njerëzore duke vendosur marrëdhënie me karakter të ndërsjellë midis tyre. Këto marrëdhënie përmbajnë rregulla dhe procedura të paanshme duke filluar nga momenti i pranimit në polici dhe më pas, gjatë tërë fazave të zhvillimit të karrierës, derisa punonjësi i policisë del në pension të plotë pleqërie. Disa nga burimet kryesore ndërkombëtare që parashikojnë norma standarde për rregullimin e marrëdhënieve të personelit në Policinë e Shtetit janë:

- *Kodi i Sjelljes për Punonjësit e Zbatimit të Ligjit*, i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në vitin 1979;
- *Deklarata e Këshillit të Europës për Policinë*, një instrument i krahasueshëm me *Kodin e Sjelljes për Punonjësit e Zbatimit të Ligjit*, shtuar rezolutës 690 (1979) dhe miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, viti 1979;
- *Kodi Europian i Etikës së Policisë*;
- *Konventa e Europolit*, etj.

Fuqia detyruese e këtyre instrumenteve ndaj organeve policore, varet nga ratifikimi që shtetet u bëjnë këtyre akteve. Aktualisht organet e shtetit shqiptar kanë ratifikuar dhe nënshkruar të gjitha dokumentet e sipërpërmendura. Përcaktimet e këtyre akteve lidhur me rregullimin e marrëdhënieve të personelit në Policinë e Shtetit fokusohen në:

- rekrutimin dhe përzgjedhjen,
- kualifikimin dhe përgatitjen,

Rica, N.
« Menaxhimi i burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit »

Policimi dhe Siguria
nr. 3, 2016

- drejtimin e veprimtarisë gjatë karrierës,
- matjen dhe vlerësimin e rezultateve gjatë veprimtarisë së policisë,
- trajtimin ekonomik dhe financiar.

Në funksion të rregullimit të këtyre marrëdhënieve, hartohet legjislacioni për organizimin e policisë, menaxhimin e personelit, arsimin profesional, ecurinë në karrierë, gjendjen e burimeve materiale, përdorimin e mjeteve financiare si dhe administrimin e tyre. Ndërsa strategjitë dhe programet e ndryshme, përcaktojnë prioritetet dhe objektivat e zhvillimit të burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit.

2. Retrospektivë mbi rregullimin e marrëdhënieve të personelit në Policinë e Shtetit

Përgjithësisht, nga njëra periudhë në tjetrën, marrëdhëniet e personelit të Policisë së Shtetit kanë funksionuar në drejtimin pozitiv edhe në Shqipëri. Që në fillimet e para të organizimit të Policisë, e në vazhdim, hasim në sisteme të hapura të rregullimit të marrëdhënieve të burimeve njerëzore, të cilat mbështeten në modele dhe përvojën e vendeve të zhvilluara të Europës. Nga studimi i historisë së Policisë Shqiptare dhe i dokumentacionit arkivor, rezultojnë se ndër shqetësimet kryesore të Qeverisë së Vlorës, ishte organizimi dhe zgjedhja e burimeve njerëzore për organet e rendit dhe qetësisë publike. “Në zgjedhjen e kuadrit oficer të policisë, – porosiste Qeveria e asaj kohe – prefekturat të vendosin njerëz të aftë e me shkollë”¹. Në funksion të kësaj veprimtarie u krijuan strukturat e para të administrimit të personelit, të cilat merreshin kryesisht me emërimin e oficerëve për Xhandarmërinë dhe Policinë. Në nenin 2 të “Rregullores së Shtabit” përcaktohej struktura e këtij organizimi, brenda të cilës bënte pjesë edhe komisioni i trajtimit të policisë dhe xhandarmërisë. Marrëdhëniet dhe veprimtaria e administrimit të personelit policor ka gjetur rregullimin e vet, me të mirat dhe të metat e kohës, gjatë tërë periudhave të mëvonshme të organizimit dhe funksionimit të Policisë. Por, ndryshe nga eksperiencia e mëparshme (e para ose pas viteve 90-të), ku marrëdhëniet e personelit rregulloheshin kryesisht me vendime të karakterit politik ose me akte normative, që s’kishin fuqinë e ligjit, – si urdhra e udhëzime të ministrit përkatës, – veprimtaria aktuale e personelit të policisë rregullohet me ligj të veçantë. I pari ligj organik “Për Policinë e Shtetit” u miratua në vitin 1999².

Më pas, ky ligj, ndonëse në kapërcim të teknikës legjislative të hartimit të akteve juridike, u shfuqizua në vitin 2007³, duke nxjerrë një ligj të ri. Kjo gjë argumentohet me faktin se nuk u bënë përmbyesje të dispozitave të ligjit të mëparshëm, por thjesht u bënë disa përmirësime e ndryshime të pjesshme, duke ruajtur në thelb dispozitat e ligjit të vitit 1999. Në vitin 2014⁴, Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin e ri “Për Policinë e Shtetit”. Iniciativa për hartimin e një ligji të ri u ndërmor për disa arsye, ku më kryesoret janë:

- përcaktimi i saktë i parimeve, objektit të punës, përgjegjësive dhe detyrave që kryen Policia e Shtetit, duke shmangur keqinterpretimet në ushtrimin e kompetencave të saj;
- rregullimi i raporteve të drejta ndërmjet ministrit të Punëve të Brendshme dhe Policisë së Shtetit, duke ndarë qartësisht rolin e drejtimit politik nga ai profesional e

Rica, N.
« Menaxhimi i burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit »

Policimi dhe Siguria
nr.3, 2016

¹ A.Q.SH. Fondi 245/8 dosja 2, viti 1913

² Ligji nr. 8553 datë 25.11.1999 “ Për Policinë e Shtetit”.

³ Ligji nr. 9749 datë 04.06.2007 “ Për Policinë e Shtetit”.

⁴ Ligji nr. 108/2014 “ Për Policinë e Shtetit”.

teknik;

- harmonizimi i plotë i strukturës policore duke shmangur shumë nivele drejtimi që bëheshin shkas për veprimtari burokratike;
- rregullimi i sistemit të karrierës në Polici, nëpërmjet gradave profesionale sipas vlerave dhe treguesve të punës, si dhe vendosja në proporcion të drejtë të raportit të gradave epror-vartës;
- përcaktimi i qartë i statusit, nivelit dhe përgjegjësi të arsimit policor, si kusht për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të Policisë së Shtetit – këtu përfshihet detyrimi i shkollës së policisë për të bërë kualifikime e specializime edhe për institucione të tjera të zbatimit të ligjit, për persona fizikë e juridikë në fushën e rendit dhe sigurisë publike;
- garantimi i një niveli më të lartë të trajtimit financiar të punonjësve të policisë, në raport me natyrën e veçantë të punës së tyre, sigurimin e jetës, si dhe një sërë përfitimesh të tjera ekonomike;
- trajtimi i veçantë i bashkëpunimit me komunitetin, qeverisjen vendore, shërbimin e sigurisë private, me homologët, etj.;
- përcaktimi i detyrimit të Policisë, për të informuar dhe bashkëpunuar me shoqërinë civile;
- përcaktimi i detyrimit të institucioneve shtetërore apo private për të prodhuar “database” e për t’i dhënë informacione Policisë së Shtetit, në funksion të luftës kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, etj.

Vlerësimet dhe rekomandimet për ndryshimin e ligjit në atë periudhë u dhanë nga Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës, misionet policore PAMECA dhe ICITAP, si dhe ekspertë të KE-së.

3. Përqasja e legjislacionit të ri të policisë, me aktet ndërkombëtare lidhur me marrëdhëniet e personelit

Burimet njerëzore janë forca kryesore që vënë në lëvizje e veprim zbatimin e ligjit. Nivelet e rekrutimit, përzgjedhjes, kualifikimit dhe specializimit të këtyre forcave janë faktor përcaktues për çdo organizatë policore. Cilësitë bazë të personelit fillojnë të marrin formë që në fazën e rekrutimit e të përzgjedhjes dhe me pas konsolidohen gjatë shkollimit apo kurseve që zhvillohen për formimin, kualifikimin dhe specializimin e punonjësve të policisë. Përzgjedhja e punonjësve të ardhshëm të policisë mbështetet në testimin e cilësive dhe aftësive të kandidatëve përkundrejt kriterëve dhe vlerave që ata duhet të kenë. Këto vlera krijohen e konsolidohen kur parashikohen procedura standarde e të paanshme për të gjithë. Sigurisht që rregullimi i marrëdhënieve të personelit të Policisë së Shtetit ka ngjashmëri ndërmjet vendeve të ndryshme, për sa i përket kriterëve dhe procedurave të rekrutimit, kohëzgjatjes së shkollimit, afateve të ecurisë në karrierë, vlerësimit të performancës, etj. Ndërkohë, ka dallime në modelet e përzgjedhura të policimit, ushtrimin e atribueteve të policisë gjyqësore, trajtimin ekonomiko-financiar, etj. Këto dallime varen nga legjislacioni dhe statusi që gëzojnë policitë e çdo vendi.

Disa standarde të përbashkëta të vendosura nga Këshilli i Europës, lidhur me rekrutimin dhe kualifikimin e personelit policor janë:

- a) *Për kualifikimin, rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të policisë:*

Rica, N.
« Menaxhimi i burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit »

Policimi dhe Siguria
nr.3, 2016

- stafi policor të rekrutohet vetëm mbi bazën e eksperiencës dhe kualifikimeve personale;
- të evitohen emërimet politike;
- aftësi të mira personale të konsiderohen aftësitë e komunikimit, mendja e hapur, gjykimi i shëndoshë dhe pjekuria;
- organizimi i policisë të reflektojë shoqërinë së cilës i shërben;
- Rekrutimi të mbështetet nga të gjitha grupet e shoqërisë;

b) Për trajnimin e personelit të policisë:

- trajnimi i personelit të policisë të bazohet mbi vlerat themelore të një demokracie, që do të thotë shtet i së drejtës dhe mbrojtje e të drejtave të njeriut;
- trajnimi të ketë si qëllim aftësimin e kandidatëve përkundrejt vlerave që duhet të ketë çdo punonjës policie;
- trajnimi të reflektojë vetorganizimin e policisë, d.m.th të jetë sa më i hapur për publikun.

Këto standarde janë reflektuar në mënyrë korrekte në legjislacionin e ri të Policisë së Shtetit. Por, korniza ligjore e rregullimit të marrëdhënieve të personelit, nuk kufizohet vetëm në ligjin organik të policisë. Për shkak të natyrës dhe veçorive që kanë shërbimet policore, procesi i rekrutimit, shkollimit, kualifikimit, trajtimit ekonomik-financiar, etj., këto marrëdhënie rregullohen nëpërmjet disa instrumenteve ligjorë. Aktet kryesore të brendshme, që sot rregullojnë veprimtarinë e personelit në Policinë e Shtetit dhe që përfaqesin plotësisht me aktet ndërkombëtare janë:

- Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.
- Ligji nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 136/2015.
- Ligji nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 8677 datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar me ligjin nr. 10301 datë 15.07.2010.
- Ligji nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”.
- Ligj nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”.
- Ligj nr. 138/2015, “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
- Ligj nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Ligji nr. 9154 datë 6.11.2003, “Për Arkivat”.
- Ligji nr. 8839, datë 22.11.2001, “Për grumbullimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar policor”.
- Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë,” i ndryshuar.
- Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të së zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 8607, datë 27.4.2000, “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, i ndryshuar.

- Ligji nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”.

Në këto akte vërehet një lidhje logjike midis burimeve ndërkombëtare dhe atyre të brendshëm që sigurojnë procedura korrekte, transparencë dhe shmangie të ndërhyrjeve gjatë rekrutimit, ecurisë në karrierë, vlerësimit të rezultateve në punë, procedimit disiplinor, trajtimit ekonomiko-financiar, etj. Disa veçori që konfirmojnë pajtueshmërinë e marrëdhënies të reja të personelit të policisë me aktet ndërkombëtare janë:

a. *Së pari*, ndahet në mënyrë të qartë statusi i punonjësit të Policisë së Shtetit, duke i dalluar shërbimet aktive-operuese nga ato mbështetëse e administrative. Marrëdhëniet e personelit policor (shërbimet aktive-operuese) rregullohen sipas ligjit “Për Policinë e Shtetit”, ndërsa marrëdhëniet e personelit mbështetës e administrativ rregullohen sipas ligjit të “Nëpunësit Civil” dhe “Kodit të Punës”. Ky element përbën një ndryshim themelor në krahasim me ligjin e mëparshëm, i cili e përcaktonte statusin si një përzierje të aspektit administrativ e policor të tij. Policia e Shtetit është institucion i administratës shtetërore⁵ dhe punonjësit e saj janë nëpunës civil për aq sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm⁶.

b. *Së dyti*, garantohej në mënyrë institucionale pandryshueshmëria e statusit të punonjësit të Policisë së Shtetit, që do të thotë “mbrojtje”, “paanshmëri” dhe “siguri e veçantë” për të gjithë punonjësit e policisë. Ky status nuk ndryshon edhe në gjendje lufte, gjendje të jashtëzakonshme, apo atë të fatkeqësive natyrore⁷. Kjo bën të mundur që të ndërpriten mundësitë e përdorimit të policisë për interesa të veçanta politike, ose e kalimit në vartësi të strukturave të tjera.

c. *Së treti*, përcaktohet në mënyrë të qartë skema e administrimit dhe e trajtimit të personelit të Policisë së Shtetit. Ky ligj, rregullon marrëdhëniet juridike ndërmjet punonjësit të policisë me institucionet e administratës të nivelit qendror e vendor, lidhur me pranimet, vazhdimin e studimeve, zhvillimin e karrierës policore, kohëzgjatjen e kësaj gjendje, etj.

d. *Së katërti*, merret realisht në mbrojtje punonjësi i Policisë së Shtetit, duke i ndarë në mënyrë konçize të drejtat dhe detyrimet e palëve që nga momenti i pranimeve dhe me pas, gjatë tërë kohës që vazhdon kohëzgjatja e marrëdhënies juridike.

e. *Së pesti*, unifikohet praktika e administrimit të dokumentacionit të personelit, duke krijuar kushte të përshtatshme për njohjen e gjendjes dhe menaxhimin e kujdesshëm të burimeve njerëzore.

4. Disa veçori të organizimit strukturor të Policisë si përgjegjësi menaxhuese e burimeve njerëzore

Organizimi strukturor i Policisë së Shtetit e gjen rregullim e vet juridik në ligjin organik dhe rregulloren e policisë. Ndërkohë, Polica e Shtetit është përcaktuar edhe si institucion i administratës shtetërore. Për rrjedhojë organizimi strukturor i saj mbështetet edhe në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”⁸, – për sa i përket përcaktimit të hierarkisë së organizimit në nivel: “drejtori e përgjithshme”, “drejtori”, “sektor”. Organizimi strukturor i Policisë së Shtetit, sipas legjislacionit të ri, ka

¹ Neni 4, pika 1 e ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

² Neni 3, pika 1 e ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”.

³ Neni 4, pika 3 e ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

⁴ Ligji nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”.

Rica, N.
« Menaxhimi i burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit »

Policimi dhe Siguria
nr. 3, 2016

disa veçori që e dallojnë nga organizimet e mëparshme të saj, dhe konkretisht:

- Ndryshe nga ligji i mëparshëm, ku ministri i Punëve të Brendshme kishte në kompetencë të miratonte të gjithë strukturën dhe organikën e Policisë së Shtetit, sipas ligjit të ri, ministri ka në kompetencë të miratojë vetëm strukturën dhe organikën e policisë në nivel qendror, me propozimin e Drejtorit të Policisë së Shtetit. Ndërsa, të gjitha strukturat dhe organikat e tjera të policisë në nivel vendor si dhe strukturat e veçanta, i miraton Drejtori i Policisë së Shtetit. Kjo përbën një zvogëlim të kompetencave të ministrit në autoritetin që ai ushtron ndaj policisë. E thënë ndryshe, vetëm 4% e strukturës organike të policisë miratohet nga ministri i Punëve të Brendshme, ndërsa 96% e strukturës organike, miratohet nga Drejtori i Policisë së Shtetit, duke e bërë strukturën më fleksibël dhe duke krijuar mundësinë për ta korigjuar atë sa herë e ndjejnë të nevojshme organet vendore të policisë.

- U thjeshtua organika e aparatit të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, duke hequr departamentet me drejtim teknokratiko-administrativ dhe u krijuan drejtoritë e përgjithshme me drejtim operativo-operacional. Kështu p.sh., u riorganizua struktura e hetimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke e ngritur në nivel drejtorie të përgjithshme me struktura efçente në fushën e hetimit të krimit ekonomik-financiar, trafikut të paligjshëm, narkotikëve, korrupsionit, aseteve kriminale, krimeve të rënda, atyre kompjuterike, etj. Ndërkohë, struktura e Interpolit dhe e Europolit, që ishte në përbërje të Drejtorisë së Bashkëpunimit dhe Koordinimit Ndërkombëtar, ndryshoi varësinë, duke kaluar në përbërje të Drejtorisë së Analizës së Informacionit Kriminal, pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda. Ndërsa në Drejtorinë e Përgjithshme për Sigurinë Publike, në zbatimin të detyrimit të ri ligjor, u shtua sektori i policimit në komunitet. Gjithashtu, struktura e Policisë Kufitare dhe Migracionit, u riorganizua në funksion të rritjes së hetimit të krimit ndërkufitar në terren, forcimit të bashkëpunimit me strukturat e tjera hetimore të Policisë së Shtetit, si dhe thellimit të analizës së rrezikut duke përdorur si bazë të dhënat standarde të CIRAM (Menaxhimit të Analizës së Përbashkët të Integruar të Rrezikut) – FRONTX.

- Ndarja e re administrativo-territoriale⁹, përcaktoi detyrimin që Policia e Shtetit të përfaqësohet me shërbim policor në çdo njësi të qeverisjes vendore, në nivel drejtorie, komisariati apo stacioni policor. Kjo, për faktin se shërbimi policor është një ndër shërbimet publike më të rëndësishme që duhet të funksionojë pranë çdo qeverisje vendore dhe që lidhet direkt me parimin kushtetues të garantimit të sigurisë publike të komunitetit, jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarit. Aktualisht, janë miratuar 61 “njësi policore”, në nivel komisariati apo stacioni policie, që u përkasin 61 njësive të qeverisjes vendore (bashkive). Faktorët kryesorë që u muarën në konsideratë në përcaktimin e organikës së strukturave vendore janë:

- organizimi i ri i pushtetit vendor, numri i popullsisë, gjendja ekonomike, infrastruktura rrugore, turizmi, objektet social kulturore të rëndësishme, raporti polic/qytetar, raporti popullsi/patrullë/SPZ/inspektor krimesh;
- organizimi i institucioneve të drejtësisë, gjykatë, prokurori, institucione të ekzekutimit të vendimeve penale, institucione të shërbimeve publike si ato të arsimit, shëndetësisë etj.;

Rica, N.
« Menaxhimi i burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit »

Policimi dhe Siguria
nr.3, 2016

¹ Ligji nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

- gjendja e sigurisë publike dhe detyrimi i mbështetjes policore ndaj të tretëve, ndjekja e zbatimit të vendimeve, parandalimi i krimeve mjedisore, aktivitetet kulturore sportive, përqindja e vëllimit të kriminalitetit, tendencat kryesore të tij, koeficienti që ai zë për banor, veçoritë e kriminalitetit për çdo zonë të banuar etj.;
- veprimtaria procedurale e përballuar si, materialet e referuara në prokurori, çështje të refuzuara për fillimin e hetimeve, çështje të pushuara, çështje të rifilluara, çështje të deleguara/ përfunduara dhe dërguar në prokurori apo gjykatë;
- veprimtaria operative me indikatorë: procedimet policore për personat dhe procedimet policore për ngjarjet.
- nevoja për ofrimin e një shërbimi sa më cilësor ndaj qytetarëve, duke rritur prezencën e punonjësve të policisë sa më afër tyre, etj.

5. Roli i lidërsipit në menaxhimin e burimeve njerëzore

Forca kryesore që vë në lëvizje e veprim zbatimin e ligjshmërisë janë burimet njerëzore. Rendi, siguria apo strukturat organizative që ngrihen në funksion të realizimit të këtij qëllimi, nuk do të funksiononin pa përkujdesjen e veçantë që duhet treguar ndaj menaxhimit të burimeve njerëzore. Personat që obligohen drejtpërsëdrejti për menaxhimin e burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit, janë drejtuesit e strukturave qendrore e vendore të policisë.

Natyrisht që, çdo punonjësi të policisë i kërkohet llogari për të përmbushur me korrektësi detyrat e përcaktuara sipas përshkrimit të vendit të punës dhe përgjegjësi që ushtron. Por, para së gjithash, drejtuesi (lideri), duhet të marrë në konsideratë faktin se punonjësi i policisë (vartësi i tij), në radhë të parë është pjesëtarë i shoqërisë dhe komunitetit që e rrethon, është prind i ngarkuar me përgjegjësi familjare, është mbartës i shqetësimit për strehim apo punësim të bashkëshortes/bashkëshortit të tij, shkollimit të fëmijëve, etj. Pra, ai nuk është si një makinë që mund ta “furnizosh” vetëm me shërbim apo llogaridhënie. Aq më keq, kur ndonjë drejtues shpërfill etikën e komunikimit, duke fyer ose duke u treguar i padurueshëm në komunikim me vartësit. Sigurisht që kërkesa e llogarisë dhe kontrolli i zbatimit të detyrave duhet të ushtrohen në mënyrë konstante ndaj cilitdo, por duke alternuar ushtrimin e “pushtetit” ndaj vartësit me krijimin e marrëdhënies njerëzore e miqësore ndaj tij.

Etika e komunikimit dhe mirësjelljes ndaj punonjësve duhet të përbëjë tiparin dallues për çdo drejtues policie. Në themel të këtyre marrëdhënies duhet të qëndrojnë normat që rregullojnë raportet e sjelljes, qëndrimin korrekt e në pajtueshmëri të plotë me standardet më të larta profesionale, trajtimin e drejtë e të paanshëm duke respektuar dinjitetin njerëzor të së drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Përkujdesja ndaj burimeve njerëzore nuk është detyrim që i përket vetëm një personi, qoftë ky edhe lider i policisë, por përgjegjësi për të gjithë zinxhirin komandues duke filluar nga grada nënkomisar deri tek gradat e nivelit të lartë e madhor.

Meqenëse u përmend zinxhiri komandues, është e nevojshme të trajtohet edhe ecuria në karrierë e punonjësit të policisë, si një ndër elementët thelbësorë të punës për menaxhimin e burimeve njerëzore. Karriera në Policinë e Shtetit është e lidhur ngushtë me sistemin e gradave, sepse ato përcaktojnë hierarkinë dhe nivelin e menaxhimit për çdo punonjës policie. Aktualisht në Policinë e Shtetit sipas rendit hierarkik rritës kemi

Rica, N.
« Menaxhimi i burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit »

Policimi dhe Siguria
nr. 3, 2016

këto funksione për gradë:

- 7200 funksione, për gradën inspektor;
- 1505 funksione, për gradën nënkomisar;
- 537 funksione, për gradën komisar;
- 452 funksione, për gradën kryekomisar;
- 139 funksione, për gradën drejtues;
- 54 funksione, për gradën drejtues i parë;
- 6 funksione, për gradën drejtues i lartë;
- 1 funksion, për gradën drejtues madhor.

Krahasuar me rendin hierarkik të mëparshëm, ligji nr. 108/2014 “Policinë e Shtetit”¹⁰ parashikon 3 grada policore më pak, për sa i përket funksioneve që kryejnë detyra të nivelit ekzekutiv e zbatues. Duke e krahasuar këtë rend hierarkik me atë të policive të vendeve të tjera të Ballkanit, rezulton se tek ne, ky rend hierarkik është më i vogël në numër, – p.sh., ligji i Policisë së Kosovës parashikon që, për punonjësit e policisë që kryejnë detyra të nivelit ekzekutiv e zbatues të ketë katër grada policore e konkretisht: polic i ri, polic, polic i lartë dhe rreshter. Secila prej këtyre gradave ka afatet e caktuara kohore të marrjes ose fitimit të saj. Pavarësisht emërimit që kanë, rendi hierarkik i tyre, për punonjësit e policisë që kryejnë detyra të nivelit ekzekutiv e zbatues, është më i plotë dhe më fleksibël se sa ai që parashikohet në ligjin tonë të policisë. Të njëjtin rend hierarkik, me tre ose katër grada, parashikojnë edhe legjislacionet e policisë në Turqi, Maqedoni e Mal të Zi, për punonjësit e nivelit zbatues. Ndërsa legjislacioni jonë, parashikon vetëm një rend hierarkik (gradën inspektor) për këtë kategori punonjësish. Kjo do të thotë që, për 7200 funksione, nga 9894 funksione policore që ka e gjithë Policia e Shtetit, të aplikohet vetëm një rend hierarkik (grada inspektor), gjë që është e pamjaftueshme dhe jonxitëse për punonjësit e policisë së kësaj kategorie. Prandaj, është e nevojshme që të ndryshohet dispozita e nenit 51 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit, duke parashikuar një rend hierarkik rritës sëpaku prej 3 gradave për punonjësit e policisë që kryejnë detyra të nivelit ekzekutiv e zbatues.

Gjithashtu lidërsipi në Policinë e Shtetit, ka detyrim të veçantë për të ndjekur trajnimin profesional të vazhdueshëm, i cili duhet të realizohet gjatë gjithë vitit kalendarik. Ky detyrim ishte shmangur për vite me radhë ndaj punonjësve të policisë, duke ndikuar negativisht në uljen e nivelit profesional të tyre. Ligji i ri i Policisë së Shtetit¹¹ parashikon detyrimin e çdo punonjësi për të përmirësuar aftësitë profesionale dhe fizike, nëpërmjet formimit profesional dhe trajnimeve. Në organizimin e ri strukturor të Policisë janë parashikuar struktura të veçanta, të cilat kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për ndjekjen e trajnimit profesional të vazhdueshëm. Roli i drejtuesit/liderit të strukturës policore në këtë proces është prioritar, si autoriteti përgjegjës për evidentimin dhe planifikimin e nevojave në funksion të trajnimeve profesionale. Programet që kanë filluar të realizohen, synojnë trajnimin e të gjithë punonjësve të policisë në detyrë, me njohuritë e nevojshme që lidhen me zhvillimet, ndryshimet brenda organizatës së policisë, njohjen e legjislacionit, ruajtjen e njohurive dhe shkathtësive specifike në lidhje me funksionin që ata kryejnë, etj. Programi i trajnimit të detyruar në shërbim, përfshin këto module trajnimi:

Rica, N.
« Menaxhimi i burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit »

Policimi dhe Siguria
nr.3, 2016

¹⁰ Sipas nenit 51, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, gradat sipas rendit hierarkik rritës emërtohen: inspektor, nënkomisar, komisar, kryekomisar, drejtues, drejtues i parë, drejtues i lartë, drejtues madhor.

¹¹ Neni 85, pika 3 e ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

- a. moduli “Për njohjen edhe përditësimin e akteve ligjore dhe ruajtjen e nivelit të dijeve”;
- b. moduli “Për përdorimin e armëve të zjarrit”;
- c. moduli “Për ndihmën e parë”;
- d. moduli “Për aftësitë policore operacionale”;
- e. moduli “Për përgatitjen fizike”.

Koha e zbatimit të programit të trajnimit të detyruar në shërbim, përcaktohet në fillim të çdo viti kalendarik, me kohëzgjatje jo më pak se 6 orë mësimore në muaj. Drejtuesi/lideri i strukturës policore, kur e shikon të nevojshme planifikon zhvillimin e orëve shtesë të këtij programi. Gjithashtu ata duhet të planifikojnë dhe realizojnë trajnime për tema të veçanta, në rastet kur identifikohen mangësi gjatë kryerjes së detyrave, kohëzgjatja e të cilave nuk mund të jetë më pak se 24 orë në vit.

6. Vlerësimi i rezultateve individuale të punës si element i rëndësishëm i menaxhimit të burimeve njerëzore

Një element i veçantë, që rregullon veprimtarinë e marrëdhënieve të personelit në Policinë e Shtetit, është edhe sistemi i ri i vlerësimit, i cili merr për bazë vetëm aftësitë dhe personalitetin e punonjësit të policisë. Mënyra se si janë përcaktuar elementët e vlerësimit, përbën një eksperiencë të re në veprimtarinë e administrimit të personelit për menaxhimin e kujdesshëm të resurseve të tij. Kjo bazë të dhënash, pasqyron hap pas hapi zhvillimin e karrierës së punonjësit të policisë si dhe ndihmon, në planifikimin afatmesëm e afatgjatë të nevojave për pranime të reja, trajnim, ngritje në përgjegjësi, etj. Detyrime për këto vlerësime kanë të gjithë punonjësit, sipas shkallës së hierarkisë, por drejtuesi/lideri i strukturës policore si dhe punonjësit e personelit kanë përgjegjësi direkt për realizimin e këtij procesi. Objektiviteti në realizimin e procesit vlerësues konsiston:

- *Së pari*, në sigurimin e një mbrojtje më të mirë të së drejtave të punonjësit, për vazhdimin e karrierës së tij policore. Duke u njohur me vlerësimin e punës dhe të drejtën që ka për observacion, atij i krijohet mundësia për t’u ankuar me proces të rregullt në rrugë administrative e gjyqësore, për padrejtësitë që mund t’i bëhen.

- *Së dyti*, në realizimin e ballafaqimit të hapur me treguesit e punës, sjelljet dhe qëndrimet ndaj detyrës e komunitetit në tërësi.

- *Së treti*, në vënien në funksion të sistemit të përzgjedhjes sipas aftësive dhe kontributit të çdo punonjësi për rritjen në përgjegjësi të tij.

Aplikimi i sistemit të ri të lëvizjeve të personelit me status policor apo nëpunës civil, ka evidentuar disa probleme, të cilat shtrojnë nevojën e ngutshme të përmirësimit të tyre, siç janë:

- Rritja e përgjegjësisë së eprorëve të drejtpërdrejtë dhe titullarëve të strukturave, në vlerësimin e rezultateve individuale të punës, në mënyrë që ajo të bëhet barrierë ndaj subjektivizmit, shkeljeve, promovimeve të pamërituara apo përshkallëzimit të masave ekstreme. Këta persona duhet të këmbëngulin dhe të arsyetojnë tek eprorët e tyre rregullsinë e çdo propozimi për lëvizje, rritje në detyrë apo përshtatshmërinë e masave që propozojnë.

- Respektimi i rregullave të përgjithshme¹² të transferimit të punonjësit të policisë,

¹² Neni 179 i “Rregullores së Policisë së Shtetit”, miratuar me vendimin nr. 750 datë 16.09.2015.

duke zbatuar afatin minimal prej dy vjetësh të qëndrimit në detyrë si dhe rastet e përcaktuara për transferim. Mosrespektimi i këtyre rasteve, (siç ka ndodhur disa herë), shpërfill aktet që normojnë këtë veprimtari, si dhe krijon pasoja financiare për organet dhe repartet e policisë.

- Realizimi i një vlerësimi objektiv, bazuar në punën dhe sjelljen e çdo punonjësi të policisë, nëpunësi civil apo punonjësi administrativ. Qëndrimet e pakujdesshme ndaj këtij elementi, përveç shqetësimeve që i krijojnë punonjësit, dëmtojnë rëndë shërbimet që janë në proces si dhe krijojnë dëm ekonomik me pasoja në buxhetin e organit policor. Në disa raste, si rrjedhojë e këtyre shkeljeve, gjykatat kanë detyruar organet e policisë të dëmshpërblejnë punonjësit e tyre për lirime apo përjashtime të padrejta nga detyra.

- Planifikimi dhe zhvillimi në mënyrë periodike i analizave e studimeve të veçanta me objekt menaxhimin dhe administrimin e personelit të policisë.

7. Përfundime

Veprimtaria e menaxhimit të burimeve njerëzore është e lidhur ngushtë me veprimtarinë funksionale të Policisë së Shtetit. Arritjet ose dështimet e policisë janë të lidhura me procesin e përzgjedhjes gjatë rekrutimit, shkollimit, ecurisë në karrierë, trajnimeve të detyrueshme si dhe trajtimit ekonomik-financiar të personelit të policisë.

Respektimi rigoroz i akteve normative dhe procedurave standarde në zbatim të tyre, janë detyruese për çdo punonjës që shërben në strukturat e burimeve njerëzore. Mosrespektimi i tyre, përveç pasojës individuale personale në ecurinë disiplinore, sjell dështim në realizimin e misionit që ka Policia e Shtetit në tërësi.

Ruajtja e nivelit të dijeve si dhe rritja e vazhdueshme e aftësive profesionale të punonjësve të policisë, konsiderohet si një nga faktorët bazë të arritjes së treguesve pozitivë në parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin e veprimtarisë kriminale.

Shkelja e Kodit të Etikës të punonjësit të policisë apo cenimi i figurës së tij, përbëjnë rreziqe serioze në dëm të organizatës së policisë apo marrëdhënieve me komunitetin.

Menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore nënkupton bashkërendim, koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me strukturat e tjera të Policisë së Shtetit. Gjetja e mirëkuptimit në zgjidhjen e problemeve zhvillon tolerancën dhe bashkëpunimin në tërësi.

Referencat

1. Menaxhimi e Burimeve Njerëzore, Paul Banfield-Rebeka Kay. Tiranë, Nëntor 2013.
2. Ligji nr. 108, datë 31.07.2014 "Për Policinë e Shtetit".
3. Ligji nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil.
4. Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë.
5. Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
6. Ligji Nr. 80/2015 , datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
7. Ligji nr. 8677 datë 02.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", i ndryshuar me ligjin nr. 10301 datë 15.07.2010.
8. Ligji nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore".
9. Ligji nr. 9154 datë 6.11.2003, "Për Arkivat".
10. Ligji nr. 8839, datë 22.11.2001, "Për grumbullimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar policor".
11. Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë , " i (ndryshuar).
12. Ligji nr. 10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të armatosura, të punonjësve të policisë së shtetit, të gardës së republikës, të shërbimit informativ të shtetit, të policisë së burgjeve, të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit e të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 10367, datë 23.12.2010.

Rica, N.
« Menaxhimi i burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit »

Policimi dhe Siguria
nr.3, 2016

Sfidat e migracionit dhe veprat penale që zhvillohen me këtë fenomen



■ Prof. Asc. Dr. **Pandeli TAÇI**
Akademia e Sigurisë



■ Msc. **Jashar VREKA**
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Një valë e re dhe e paparashikueshme emigracioni drejt Perëndimit u shënua gjatë viteve 2012-2015. Ky emigracion, fillësën e tij e kishte nga lufta e tejzgjatur dhe me shumë pasoja në Siri, por shkonte edhe më parë, që nga konfliktet në Afganistan e Irak - ose e thënë shkurt, në Lindjen e Mesme. Ky fluksi i paparashikueshëm emigrantësh ilegalë, rrugën e vet e zgjodhi kryesisht nga Ballkani drejt Europës Perëndimore. Këtij fluksi emigracioni iu bashkua edhe emigracioni ilegal nga vendet ballkanike, i cili ishte ulur ndjeshëm deri në këtë kohë, duke u rritur edhe ai në përmasa të paparashikuara. Disa nga shkaqet e rritjes së emigracionit nga vendet ballkanike, gjatë viteve 2013-2015, "ruga ballkanike" e zgjedhur nga emigrantët e Lindjes së Mesme, fenomenet kriminale që u shfaqën së bashku me emigracionin si dhe disa rekomandime për përmirësime në fushën sociale dhe penale, do të jenë objekt kryesor i këtij shkrimi.

Materi, bazuar në argumente, sugjeron se përpjekja e frenimit të aktivitetit të paligjshëm të lidhur emigracionin, do të ishte më e suksesshme nëse rishikohen nenet të Kodit Penal, me të cilat luftohet emigracioni i paligjshëm, sepse nuk janë të mjaftueshme për të luftuar kontrabandimin e qenieve njerëzore; ndërsa nenet e Kodit Penal, për trafikimin e qenieve njerëzore, nuk mund të përdoren për të luftuar kontrabandimin e qenieve njerëzore.

Fjalëkyçe:

emigrim ilegal, azilant, Ballkani Perëndimor, rrua ballkanike, kontrabandimi i qenieve njerëzore, trafikimi i qenieve njerëzore, legjislacioni për emigrimin.

Taçi, P.
dhe Vreka, J.
« Sfidat e
migracionit dhe
veprat penale
që zhvillohen
me këtë
fenomen »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

1. Hyrje

Emigracioni ilegal është një fenomen i hershëm. Emigracioni nga vendet e pazhvilluara drejt Europës dhe Amerikës, ka qenë dhe vazhdon të mbetet një fenomen permanent, me uljet dhe ngritjet e veta. Në shumë mënyra, vendet e zhvilluara europiane dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë përpjekur për ta vënë nën kontroll emigracionin, por duke ndihmuar edhe flukset migratore, veçanërisht ata individë, të cilët largohen nga vendet e tyre për shkaqe të shkeljes flagrante të drejtave të njeriut, mungesës së pluralizmit politik, konflikteve ndërshtetërore, etnike, fetare, etj. Pavarësisht këtyre situatave, bota e zhvilluar ka suportuar vazhdimisht emigracionin, duke e bërë pjesë të jetës dhe shoqërisë së zhvilluar. Rënia e murit të Berlinit, i cili shënoi përfundimin e Luftës së Ftohtë midis Lindjes dhe Perëndimit, regjistroi edhe fluksin më të madh migrator nga vendet e Lindjes drejt Perëndimit, proces në të cilin u përfshinë edhe vendet ballkanike, brenda të cilëve edhe Shqipëria. Emigracioni i viteve '90 ishte përzierje e emigracionit politik me atë ekonomik, për faktin që vendet e Lindjes kishin probleme, si në respektimin e lirive e në atë të së drejtave të njeriut, ashtu edhe në kontrastin e madh në zhvillimin e tyre ekonomik, i cili ishte dukshëm shumë më i ulët sesa ai i Perëndimit. Europa dhe SHBA e mirëpritën dhe e absorbuan këtë emigracion, duke bërë të mundur që emigrantët nga vendet e Lindjes dhe Ballkani, të bëheshin pjesë e shoqërisë së shteteve Perëndimore. Vendosja e demokracisë në Europën Lindore dhe Ballkan, solli gradualisht përmirësimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të kushteve ekonomike në këto vende, duke ulur emigracionin legal dhe ilegal drejt Europës dhe SHBA-së. Një valë tjetër emigrimi u pa gjatë 3-4 viteve të fundit. Shkak kryesor ishte lufta e tejzgjatur dhe me shumë pasoja në Siri, por shkaqet sihin edhe më të hershme pasi lidheshin deri me konfliktet në Afganistan e Irak. Ky fluks emigrantësh të paligjshëm, e zgjodhi rrugën e vet, duke kaluar nga Ballkani drejt Europës Perëndimore. Këtij fluksi

*Taçi, P.
dhe Vreka, J.*
« Sfidat e
migracionit dhe
veprat penale
që zhvillohen
me këtë
fenomen »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

iu bashkua edhe emigracioni ilegal i disa vendeve ballkanike, duke u rritur edhe ai në përmasa të paparashikuara. Disa nga shkaqet e rritjes së emigracionit nga vendet ballkanike, gjatë viteve 2013-2015, “rruga ballkanike”¹ e zgjedhur nga emigrantët e Lindjes së Mesme, fenomenet kriminale që u shfaqën së bashku me emigracionin si dhe disa rekomandime për përmirësime në fushën sociale dhe penale, do të jenë objekt i materialit të mëposhtëm.

2. Diferencat e vendeve ballkanike me vendet e zhvilluara, në aspektin ekonomik-social dhe atë të perceptimit

Ka të paktën 25 vjet, që me rënien e murit të Berlinit, kur ranë edhe regjimet totalitare në Ballkan, që popullsitë e vendeve tona, Shqipërisë, Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi, Kroacisë dhe me pas edhe të Kosovës mundën të lëviznin drejt vendeve të tjera. Bashkë me mundësitë e lëvizjes së lirë, e cila gjithsesi, ishte e kufizuar brenda një sistemi vizash, u zhvillua edhe emigracioni i paligjshëm, ky, i drejtuar veçanërisht drejt Europës Perëndimore, SHBA-së, Australisë, etj. Emigracioni i popullsisë ballkanike drejt Perëndimit është një proces i cili stimulohet nga disa faktorë të cilët do i shohim konkretisht në vijim.

Faktori kryesor është faktori ekonomik. Është i dukshëm ndryshimi ekonomik midis shteteve të Ballkanit, atyre të Europës dhe vendeve të tjera të zhvilluara. Me gjithë instalimin e sistemit demokratik dhe të ekonomisë së tregut, pas viteve '90, në Ballkan ekonomia e këtyre vendeve është shumë larg të qenit si ekonomitë e vendeve të zhvilluara. Faktori politik është ndikues deri në njëfarë mase në zhvillimin e emigracionit. Demokracitë lindore dhe ballkanike janë akoma të brishta dhe me shumë problematika në arritjen dhe aplikimin e standardeve të demokracive perëndimore. Pavarësisht përmirësimeve, standardet demokratike të lirive politike, barazisë sociale, respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, shoqëritë dhe shtetet ballkanike janë akoma larg të qenit demokraci të zhvilluara. Ato shpesh prodhojnë kriza paqëndrueshmërie politike e ekonomike (kriza e vitit 1997 në Shqipëri, lufta e Kosovës, kriza e vitit 2001 në Maqedoni, etj.), të cilat stimulojnë rritjen e emigracionit nga këto vende. Një faktor tjetër jo pak i rëndësishëm janë edhe perceptimet mbi zhvillimin politik, ekonomik, social, kohëzgjatjen e zhvillimit të proceseve demokratike, korrupsionin, konfliktet e brendshme politike, etj., të cilat krijojnë një lloj padurimi të popullsisë të vendeve ballkanike, për pritshmërinë e zhvillimit të tyre si dhe humbje besimi të ardhmja dhe të perspektiva. Faktor tjetër, është nxitja artificiale që i bëhet popullsisë së vendeve tona nga elementë dhe organizata kriminale, përfituese direkt nga migrimi i njerëzve, nëpërmjet deformimit, apo abuzimit me informacione për gjoja “punësim masiv në vendet e Europës”, “politika moskthimi në atdhe të azilantëve”, “kërkesa për fuqi punëtore të ndryshme në Perëndim”, etj.

Të gjithë këta faktorë përfshirë edhe kufizimin e lëvizjes së lirë për shkak të sistemit të vizave, apo të pamundësisë së qëndrimit të përhershëm në Perëndim dhe në SHBA, kanë stimuluar fluksin permanent të emigrantëve që kërkojnë azil nga vendet ballkanike. Këta janë faktorë, të cilët janë analizuar në mënyrë permanente nga shtetet e organizmat

Taçi, P.
dhe Vreka, J.
« Sfidat e
migracionit dhe
veprat penale
që zhvillohen
me këtë
fenomen »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

¹ FRONTEX, Risk Analysis Unit. *Annual Risk Analysis, 2014*. Frontex reference number: 5119/ 2014, Warsaw, May 2014, (f.37).

evropiane, si vende pritëse të këtij emigracioni, por edhe në bashkëpunim me shtete ballkanike si vende të origjinës për të gjetur zgjidhjet dhe rrugët e nevojshme në zhvillimin politik, ekonomik e social të këtyre të fundit. Dhe zgjidhjet kanë funksionuar dhe funksionojnë në vazhdimësi. Bashkimi Europian dhe SHBA japin ndihmë permanente për zhvillimin e institucioneve demokratike edhe në fushën ekonomike për shtetet e Ballkanit Perëndimor. Po kështu, Bashkimi Europian dhe institucionet ndërkombëtare financiare (FMN, BB, BERZH, etj.), kanë zbatuar e zbatojnë programe dhe politika ekonomike, që përfshijnë stimulimin e biznesit vendas e atij të huaj në vendet tona, punësimin sezonal për shtetasit ballkanikë në vendet evropiane, por edhe punësim të përhershëm për profesione të veçanta, heqjen e sistemit të vizave për shtetasit e vendeve të Ballkanit, etj². Të gjitha strategjitë e mësipërme, bëhen edhe në favor të uljes së emigracionit ilegal nga Ballkani, duke përmirësuar kushtet e jetesës dhe të punësimit në vendet tona. Por, ç'po ndodh? Emigracioni i paligjshëm nga vendet ballkanike, veçanërisht nga Shqipëria, Kosova, Serbia dhe Maqedonia, në dy vitet e fundit po shkon përkundër pritshmërisë për ulje dhe po shfaq disa fenomene të panjohura më parë, si:

- Së pari, në dy vitet e fundit ka një shtim drastik të emigracionit të paligjshëm të shtetasve nga Ballkani drejt shteteve të Bashkimit Europian. Sipas statistikave zyrtare, emigracioni i paligjshëm në vitin 2014³ u rrit me rreth 33% përkundëjt vitit 2013 dhe disa herë më shumë në 6 mujorin e parë të vitit 2015 kundëjt 6 mujorit vitit 2014.⁴

- Së dyti, lëvizja e emigracionit të paligjshëm duket të jetë e mirorganizuar, jo spontane dhe vetë shtesa e njerëzve që emigrojnë, shumë më e mirinformuar se më parë, mbi vendet pritëse, legjislacionin e secilit prej tyre, veçanërisht atë mbi emigracionin dhe azilin, përdorimin e rrugëve tokësore, detare dhe e agjencive të udhëtimit, etj.

Lëvizja e emigracionit të paligjshëm nga vendet ballkanike nuk është më kaotike, por duhet mirorganizuar, gjë që të jep të kuptosh dhe analizosh se persona, grupe e interesa kriminale të caktuara, janë nxitësit, organizatorët dhe përfituesit kryesorë të kësaj veprimtarie. Pyetja që shtrohet, është: përse Ballkani? Tashmë e prej dy vjetësh, Ballkani është vend problematik origjine, me një numër galopant, në rritje, për azilkërkuesit ekonomikë dhe vend tranziti i migracionit ilegal, që shfaqet përmes zhvendosjeve masive të popullsisë të disa shteteve në konflikt, si Siria, Afghanistani, etj., por dhe nga vende postkonfliktuale, por që rezultojnë të paqëndrueshme, si Libia, në drejtim të vendeve të zhvilluara të Bashkimit Europian. Arsyet kryesore se përse ndodh kjo në Ballkan, mund të përmbliidhen kështu:

- Ballkani është një nga rrugët e mundshme më të mira gjeografike për të shkuar në Europë, për emigracionin e nxitur nga lufta në Siri e Irak.⁵

- Kalimi nëpër shtetet ballkanike i këtij emigracioni është konceptuar më i lehtë edhe nga pikpamja e legjislacionit dhe integritetit të organeve ligjzbatuese të këtyre vendeve, për goditjen e fenomenin dhe kontrabandimit të qenieve njerëzore. Ajo që përmendëm më lartë, për demokracitë dhe institucionet e brishta të vendeve ballkanike, përkthehet për trafikantët dhe kontrabandistët e qenieve njerëzore, si mundësi më e mirë korruptimi për strukturat shtetërore dhe zbatim i dobët i ligjit e si rezultat, pengesë

**Taçi, P.
dhe Vreka, J.**
« Sfidat e
migracionit dhe
veprat penale
që zhvillohen
me këtë
fenomen »

² FRONTEX, Risk Analysis Unit. *Annual Risk Analysis, 2014*. Frontex reference number: 5119/2014, Warsaw, May 2014, (f.7).

³ INSTAT, Raport i vitit 2014, "Migracionin në Shqipëri, viti 2012-2014".

⁴ Të dhëna zyrtare të Ministrisë së Brendshme, për numrin e azilkërkuesve nga Shqipëria, për vitin 2014 dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2015.

⁵ Townsend, Riley M. *The European Migrant Crisis*. North Carolina, United States: Lulu.com, 2015, (f.2).

e dobët për zhvillimin e emigracionit.

-Vendet ballkanike kanë vetë fluks emigracioni drejt Europës, gjë që e bën më të lehtë përzjerjen dhe natyrisht edhe kalimin e emigracionit nga Lindja e Mesme. Është dhe një përzgjedhje e menduar dhe e llogaritur mirë nga grupet apo organizatat kriminale për të kamufluar kontrabandimin e qenieve njerëzore nëpërmjet emigracionit ilegal.⁶

Duke analizuar dukurinë e rritjes së migracionit nga Ballkani, elementë të organizimit dhe faktorë të tjerë ndikues në të, rezultojnë se një nga burimet kryesore që stimulojnë këtë rritje është sofistifikimi i veprimtarisë së organizuar kriminale në fushën e kontrabandimit të qenieve njerëzore, e cila do të analizohet në vijimësi.

3. Fenomenet kriminale që shoqërojnë migracionin

Fenomenet kriminale që shoqërojnë migracionin, si, trafikimi, kontrabandimi i qenieve njerëzore, kalimi i paligjshëm i kufirit, eksportimi i terroristëve, falsifikimi i dokumentacionit, etj., janë tashmë fenomene të njohura dhe transnacionale për të gjitha vendet që përballen me këtë dukuri. Emigracioni i paligjshëm është një fenomen që shoqërohet me një kompleks problematikash, me të cilat duhet të përballen veçanërisht vendet pritëse të Bashkimit Evropian, të cilat kanë edhe fluksin më të madh të azilkërkuësve. Emigracioni i paligjshëm është një fenomen që mbart si problem kryesor akomodimin dhe sistemimin e emigrantëve në vendet pritëse. Akomodimi dhe sistemimi i emigrantëve, është jo vetëm një problem vendi dhe kushtesh, por edhe një problem i vazhdueshëm ekonomik, sepse detyrimisht, kjo shtresë njerëzish ka nevojë të përditshme të ushqehet, por edhe të mjekohet e të arsimohet minimalisht me gjuhën, ligjet dhe rregullat bazë të jetesës së shtetit pritës. Emigracioni i paligjshëm mbart edhe probleme të tjera, të cilat lidhen me rendin dhe sigurinë në shtetet pritëse. Problematika e emigracionit, e lidhur me rendin dhe sigurinë për organet ligjzbatuese të vendeve pritëse, është e nivelit të brendshëm dhe atij të jashtëm, deri në nivel sigurie kombëtare.

- Siguria e brendshme. Fluksi i madh i emigrantëve shoqërohet edhe me probleme të sigurisë brenda radhëve të tyre. Kushtet e këqija gjatë lëvizjes së emigrantëve, përzjerja e komuniteteve migratore gjatë lëvizjes apo qëndrimit në kampe, përqendrimi i madh i njerëzve në kushte të përkohshme relativisht jo të mira, penetrimi i elementëve kriminalë, kontrabandistë e trafikantë të çdo lloji që mundohen të përfitojnë nga situatat e refugjatëve, etj. – të gjitha këto, krijojnë situata komplekse, që nga konfliktet e thjeshta e deri tek prishjet masive të rendit e sigurisë nga emigrantët.

- Siguria e jashtme. Një problem tjetër që lidhet me sigurinë e emigrantëve është edhe fakti që në shumë raste, arsye nga më të ndryshmet si, frikë nga emigracioni, ksenofobi apo edhe bindje me natyrë raciste, etnike, fetare etj., bëjnë që një pjesë e popullsisë apo grupime të ndryshme të vendeve pritëse, të mos i mirëpresin emigrantët, të kundërshtojnë ardhjen e tyre apo edhe të shkaktojnë probleme të rënda duke u konfrontuar apo duke sulmuar emigrantët ose vendqëndrimet e tyre. Është fakt, që nëpërmjet emigracionit të paligjshëm përfitojnë:

- trafikantët e qenieve njerëzore;
- kontrabandistët e qenieve njerëzore;
- elementë kriminalë të cilët, për t'i ikur përndjekjes ligjore në vendet e tyre dhe

Taçi, P.
dhe Vreka, J.
« Sfidat e
migracionit dhe
veprat penale
që zhvillohen
me këtë
fenomen »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

⁶ McCormick, Di John. *European Union Politics*. London: Palgrave Macmillan, 2015, (f.382).

për të humbur gjurmët e aktivitetit të tyre të mëparshëm paraqiten nën maskën e azilkërkuesit në vendet pritëse;

- elementë me tendenca radikale fetare, terroriste.⁷

- Siguria kombëtare. Problemeve të mësipërme, ekonomike dhe të sigurisë, që mbart emigracioni dhe që duhen zgjidhur u është shtuar edhe një faktor tjetër akoma më problematik, ai i sigurisë kombëtare për vendet pritëse. Në disa nga veprimet terroriste, të drejtuara dhe të kryera ndaj shteteve europiane gjatë viteve të fundit ka dalë në pah një fakt i rëndësishëm që sapo vjen dhe po konfirmohet në rrugë zyrtare. Një pjesë e personave të përfshirë në veprimet e fundit terroriste (veçanërisht në ato në Francë e Belgjikë), kanë ardhur në Europë duke shfrytëzuar emigracionin e paligjshëm. Një faktor i rëndësishëm ky, që vë në pah nevojën që kanë këto vende për të marrë në konsideratë dhe për të rishikuar politikat mbi emigrimin e paligjshëm, me qëllim që ky i fundit të mos jetë burim edhe i veprimtarive terroriste në vendet pritëse. “90% e emigrantëve që shkojnë në BE, i kryejnë udhëtimet nëpërmjet rrjeteve kriminale... rrjetet e kontrabandës sigurojnë edhe një mundësi për terroristë potencialë...”⁸

Emigracioni i paligjshëm, siç duket, është parë edhe si një rrugë e përshtatshme nga terroristët për të hyrë në Europë. Nëpërmjet kësaj rruge elementët terroristë mund të kamuflohen lehtë si njerëz të vuajtur dhe mund të përfitojnë lehtësisht nga procedurat e azilit; mund të fshehin të kaluarën e tyre, – siç mund të jetë pjesëmarrja e mëparshme në vendet e tyre në grupime terroriste – duke paraqitur dokumente të falsifikuara; mund ta bëjnë të pamundur për organet ligjzbatuese dhe të migracionit të vendeve pritëse, verifikimin mbi emigrantin, duke qenë se vijnë nga zona në gjendje lufte. Shfrytëzimi i migracionit të paligjshëm nga grupime apo organizata terroriste, shënon një pikë tjetër zhvillimi negativ për këtë fenomen. Nëse deri më tash, emigracioni i paligjshëm vlerësohej me nota negative në problemet që shkaktonte, në aspektin ekonomik dhe në atë të kriminalitetit që importonte, tashmë atij i është shtuar edhe një element tjetër i një rrezikshmërie të lartë, që cenon sigurinë kombëtare të çdo vendi pritës, – ai i eksportimit të terrorizmit. Dhe, nëse shtetet e Bashkimi Europian, mund të tolerojnë dhe të zotërojnë elementë të cenimit të sigurisë së brendshme, apo sigurisë së jashtme, në lidhje me emigracionin ilegal, ata kurrsesi nuk mund të bëjnë asnjë lëshim në lidhje me elementë që cenojnë sigurinë e tyre kombëtare. Sa thamë më sipër, transportimi nëpërmjet emigracionit ilegal të kriminalitetit dhe tashmë së fundi edhe të terrorizmit, shënon si sfidë kombëtare për të tashmen dhe të ardhmen, problemin e emigracionit ilegal dhe kontrollin e tij.

4. Legjislacioni aktual dhe lufta ndaj migracionit të paligjshëm

Legjislacioni aktual që lufton migracionin e paligjshëm dhe veprat penale që zhvillohen duke shfrytëzuar tendencën e popullsisë ballkanike për migrim, shfaqin domosdoshmërinë e përmirësimit të legjislacionit në fushën e veprave penale që lidhen me migracionin. Në dy vitet e fundit është vënë re një rritje e menjëhershme dhe e pajustificuar e fluksit të emigracionit të paligjshëm, nga vendet ballkanike, në mënyrë specifike, emigracionit nga Shqipëria e Kosova, por edhe nga Maqedonia e Serbia.

⁷ FRONTEX, Risk Analysis Unit. *Annual Risk Analysis*, 2015. Frontex reference number: 4613/2015, Warsaw, April 2015, (f.42).

⁸ Gazeta Shqiptare. “700 emigrantë të vdekur në afërsi të ishullit të Sicilisë”, 19.4.2015.

*Taçi, P.
dhe Vreka, J.*
« Sfidat e
migracionit dhe
veprat penale
që zhvillohen
me këtë
fenomen »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

Rritja e menjëhershme e fluksit të emigracionit të paligjshëm është shoqëruar edhe me shfaqjen e mënyrave e dukurive të reja, të pazakonta në këtë proces emigrimi.

Gjatë vitit 2014 janë evidentuar 48 raste për veprën penale “dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”. Gjatë së njëjtës periudhë të vitit 2013, janë evidentuar 29 raste për veprën penale “dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”.⁹

Për të qartësuar më tej se pse e quajtmë të pajustificuar, rritjen e fluksit migrator në dy vitet e fundit, nga Ballkani drejt Europës, po i rikthehem përsëri një analize të shkurtër të faktorëve migratorë dhe disa dukurive të veçanta që shoqërojnë këtë migrim nga Ballkani drejt Europës. Në mënyrë të përmbledhur, faktorët janë si në vijim.

Kushtet ekonomiko-shoqërore në Shqipëri, por edhe në Kosovë, Maqedoni, Serbi, etj., gjatë vitit 2014 dhe në vazhdim të vitit 2015 nuk kanë pësuar ndryshime esenciale që të kenë kaq ndikim sa për të shkaktuar një fluks të menjëhershëm dhe një rritje (apo edhe ulje) galopante të emigrantëve të paligjshëm, që kërkojnë azil ekonomik në Perëndim. Si referencë për këtë gjë, mund të merren raportet e rritjes ekonomike vjetore për këto shtete, të nxjerra nga institucionet financiare ndërkombëtare.¹⁰

Në këtë proces migrimi, vihet re një mënyrë e koordinuar lëvizjeje drejt vendeve ku kërkohet azil, veçanërisht duke përdorur rrugët tokësore ose detare dhe nëpërmjet agjencive të udhëtimit. Kjo gjë nuk mund të realizohet ndryshe përveçse nëpërmjet një veprimtarie të organizuar në mënyrë klandestine nga organizime kriminale që kontrabandojnë qenie njerëzore. Është logjike që persona të cilët duan të emigrojnë në Perëndim, nuk mund të përputhin pa pasur një pikë njoftimi apo kontakti, vendin dhe automjetin e lëvizjes, në të njëjtën orë dhe vend dhe të nisen në një mënyrë, e cila është dukshëm e organizuar.¹¹

Si shembull mund të sjellim këtë rast: Më datë 18.12.2014, rreth orës 09.00 nga Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit, Vlorë, u mor informacion se në drejtim të Brindisit do të udhëtojnë me autobusët e linjave shumë shtetas shqiptarë të moshave të reja, të cilët kanë si destinacion Gjermaninë dhe do të kërkojnë atje azil ekonomik. Mbas verifikimit të dokumentacionit, u bë refuzimi i daljes nga Republika e Shqipërisë e 265 shtetasve shqiptarë, të cilët nuk plotësonin kushtet për të udhëtuar në vendet e Bashkimit Evropian. Të ndarë këta sipas agjencive të transportit: “Ariani Trevell” - 40 shtetas; “Agimi Trevell” - 185 shtetas; “Alb Bus Turs” - 10 shtetas; “Hermes” - 30 shtetas.¹²

Në këtë proces migrimi, konstatohet me lehtësi se, emigrantët kanë informacione të sakta për rrugët që do të ndjekin dhe destinacionin e synuar, legjislacionin e vendeve ku tranzitohen dhe legjislacionin e vendeve pritëse, që lidhet me trajtimin e azilkërkuesve deri dhe tek trajtimet ekonomike që mund të përfitojnë, të cilat ndryshojnë nga një shtet në tjetrin. Është domethënë fakti që u konfirmua para pak kohësh në shtypin evropian se, azilkërkuesit drejtoheshin drejt Suedisë dhe jo drejt Danimarkës, duke qenë të mirinformuar se legjislacioni i këtij vendi ishte më favorizues se sa ai i Danimarkës dhe mundësitë e qëndrimit në shtetin suedez ishin më të larta. Ndryshe sa më parë, emigracioni i viteve të fundit, ka pasur përdorim më masiv të rrjeteve sociale për të përhapur të ashtuquajturat njoftime: “Kërkesa nga vendet Perëndimore për fuqi punëtore”, “vendet Perëndimore nuk kthejnë njerëz më në vendet e origjinës”, “për

⁹ Policia e Shtetit. *Analiza e Drejtorisë së Policisë Kufitare*, viti 2014.

¹⁰ Banka Kombëtare e Shqipërisë. *Raporti vjetor i Bankës së Shqipërisë për zhvillimin e ekonomisë shqiptare*; *Raporti vjetor 2015, për zhvillimin e ekonomisë shqiptare*, FMN dhe BB.

¹¹ Cierco, Teresa. *The European Union Neighbourhood: Challenges and Opportunities*. Routledge, 2016, (f.40-53).

¹² Policia e Shtetit. *Analiza e Drejtorisë së Policisë Kufitare*, viti 2014.

emigrim të organizuar nga agjenci të ndryshme të licencuara”, etj. Ekziston një përputhje e çuditshme e fenomeneve si: lëvizja e mirorganizuar, në një sistem zinxhir njerëzish dhe mjetesh në dispozicion të emigrantëve dhe, informacioni i plotë dhe i detajuar, i zotëruar nga emigrantët, cili për të qenë i saktë nuk mund të sigurohet në mënyrë rastësore. Kjo gjë konstatohet edhe te emigracioni që vjen nga Siria, Iraku, Libia, etj. Natyrshëm lind pyetja: “Kush e zotëron, e shpërndan dhe është i interesuar si përfitues nga përhapja e këtij lloji informacioni?”. Me sa duket, ky informacion, me qëllim shtimin e numrit të atyre që emigrojnë ilegalisht, shpërndahet në mënyrë të organizuar nga kontrabandistët e qenieve njerëzore, të cilët parapaguhen prej emigrantëve për t’u siguruar kalimin nga vendi i origjinës në atë të pritjes. Pak muaj më parë, kur fluksi i azilantëve ishte në një rritje të paparë, shtypi i huaj bënte një analizë të përfitimeve që nxirreshin nga organizimi i emigracionit të paligjshëm, nga individë apo grupe kriminale, duke pasur parasysh që asnjë veprim përkundrejt emigrantëve, nga ata që merrnin përsipër t’i transportonin drejt Europës, nuk ishte humanitar, por paguhej me para në dorë¹³. Çdo emigrant paguante të paktën mbi 2000 euro për të udhëtuar nga vendi i origjinës në vendet evropiane. Sipas llogarive, dilte se ishin me miliona euro të fituara nga organizatorët e emigracionit të paligjshëm.¹⁴

Shpeshherë, në terminologjinë dhe gjuhën e shtypit e medie, personat që përfitojnë nga zhvillimi i emigracionit të paligjshëm quhen trafikantët të qenieve njerëzore. Natyrshëm, pas analizës së mësipërme të disa faktorëve nxitës dhe organizues të emigracionit të paligjshëm, duhet të rishikojmë nëse legjislacioni për të luftuar këtë fenomen i përgjigjet kësaj situatë dhe këtij aktualiteti. Po t’i referohemi legjislacionit do të vëmë re se Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (Pjesa e Posaçme), ka vetëm dy nene që vendosin para drejtësisë personat që nxisin artificialisht, organizojnë, realizojnë dhe përfitojnë nga emigracioni i paligjshëm dhe konkretisht:

Neni 297, Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror: Kalimi i paligjshëm i kufijve shtetërorë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet; Neni 298, Ndhimja për kalim të paligjshëm të kufijve: Strehimi, shoqërimi, vënia në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të lundrimit, të fluturimit ose i mjeteve të tjera të transportit apo çdo ndihme tjetër, me qëllim kalimin e paligjshëm të kufirit të Republikës, ose për hyrjen e paligjshme të një personi në një shtet tjetër, pa qenë shtetas i tij, ose që nuk ka leje qëndrimi në atë shtet, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një deri në katër vjet dhe gjobë nga tre deri në gjashtë milion lekë. Kur ndihma jepet për qëllime fitimi dënohet me burgim nga tre në shtatë vjet dhe gjobë nga katër deri në tetë milionë lekë. Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim, ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet dhe gjobë nga gjashtë deri në tetë milionë lekë.¹⁵

5. Rekomandime për ndryshime në legjislacionin penal

Me qëllim përmirësimin e rezultateve në përpjekjen e frenimit të aktivitetit të

¹³ Gallagher, Anne T. dhe yFiona David. *The International Law of Migrant Smuggling*. Cambridge University Press, 2014, (f.28).

¹⁴ Agjencia SOT NEWS, “The Times, Klandestinët, trafikimi i tyre bëhet nga bandat shqiptare”, 17.8.2015. Gazeta MAPO, “Le Monde: Perandoria fitimprurëse e trafikantëve - mes tyre 7 banda shqiptare”, 16.08.2015. Gazeta Shqiptare, “Trafikantët e emigrantëve fituan 6 miliardë dollarë në 2015-n” (studim i përbashkët i INTERPOL dhe EUROPOL), 17.05.2016.

¹⁵ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

Taçi, P.
dhe Vreka, J.
« Sfidat e
migracionit dhe
veprat penale
që zhvillohen
me këtë
fenomen »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

paligjshëm të lidhur emigracionin, sugjerojmë që të rishikohen nenet e mësipërme të Kodit Penal, me të cilat luftohet emigracioni i paligjshëm, sepse mendojmë që nuk janë të mjaftueshme për të luftuar kontrabandimin e qenieve njerëzore; ndërsa nenet e Kodit Penal, për trafikimin e qenieve njerëzore, nuk mund të përdoren për të luftuar kontrabandimin e qenieve njerëzore. Ka ndryshime esenciale midis kontrabandimit dhe trafikimit të qenieve njerëzore:

- Trafikimi i qenieve njerëzore ka si element të domosdoshëm rekrutimin dhe shfrytëzimin e viktimës për përfitime ekonomike ose të paktën vërtetimin se kryerja e rekrutimit është bërë për qëllime shfrytëzimi të viktimës.

- Kontrabandimi i qenieve njerëzore, nuk ka për qëllim shfrytëzimin e mëtejshëm të viktimës përveçse përfitimin ekonomik nëpërmjet organizimit të transportimit të paligjshëm të tij dhe, shkëputjen e çdo kontakti me emigrantin e paligjshëm, në momentin që ky i fundit mbërrin në vendin pritës.

- Ndërsa në kontrabandim, gjithashtu nuk ka rekrutim tipik të emigrantit nga kontrabandisti; ajo është më shumë një marrëdhënie që mund të etiketohet “Pay to take service” (Paguaj për t’u shërbyer). Në trafikim të qenieve njerëzore, rekrutimi është një nga fazat kyçe të kësaj veprimtarie kriminale të organizuar.

- Ndërsa në krimin e trafikimit të qenieve njerëzore, viktima përfundon për t’u shfrytëzuar në vendin e destinacionit që vendos trafikanti shfrytëzues, në kontrabandimin e qenieve njerëzore, pikën e mbërritjes e përcakton emigranti; kontrabandisti merr përsipër vetëm transportimin.

- Në trafikimin e qenieve njerëzore, viktima favorizohet nga trafikanti ku shpenzimet e transportimit dhe gjithë kostot e tjera i merr përsipër trafikanti, të cilat i përdor më pas edhe si detyrim i pashlyer nga viktima, për ta shfrytëzuar këtë të fundit në vazhdimësi. Në rastin e kontrabandimit të qenieve njerëzore, asnjë emigrant i paligjshëm nuk mund të nisë aventurën e tij pa parapaguar shpenzimet e udhëtimit.

Kontrabandimi i qenieve njerëzore, krahasuar me trafikimin e qenieve njerëzore, nga organizimet kriminale, ka disa përparësi. Së pari, kontrabandistët e qenieve njerëzore, duke qenë se shpeshherë kanë shfrytëzuar situatat e rënda që kanë përjetuar emigrantët e paligjshëm, - si ato të konflikteve luftarake ndëretnike, shtetërore, fetare etj., - nga organizmat e ndryshme ndërkombëtare, qeveritë dhe organet ligjzbatuese kryesisht të vendeve pritëse, veprimtaria e tyre është dukur më shumë si shpëtimtare për këto shtresa që emigrojnë, sesa si shfrytëzuese e përfituese¹⁶. Së dyti, përfitimi nga kontrabandimi i qenieve njerëzore, realizohet në një kohë të shkurtër dhe pa u rrezikuar nga vazhdimësia kriminale, si trafikimi i qenieve njerëzore gjatë shfrytëzimit të viktimave që zhvillohet në një hark kohor të palimituar. Së treti, legjislacioni i sotëm, është tepër favorizues, krahasuar me atë të trafikimit të qenieve njerëzore. Ai nuk rrezikon, as kufizim të lirisë për një kohë të gjatë e as sekuestrim të pasurive të vëna me anë të aktiviteteve kriminale dhe, nuk është analitik, që të dënojë edhe veprimtarinë ndihmëse në këtë aktivitet kriminal. Kjo e fundit, shërben për ta goditur këtë aktivitet që në fillimet e tij dhe jo vetëm mbas realizimit të qëllimit. Sugjerojmë, se sa më sipër, duhet riparë legjislacioni për të përcaktuar dispozita të qarta, të plota dhe efektive kundër fenomenit kriminal të kontrabandimit të qenieve njerëzore, dispozita të cilat duhet të realizojnë dënime efektive për këtë kategori kontrabandistësh. Kryesor është parashikimi në Kodin Penal i dispozitave të veçanta mbi kontrabandimin e qenieve njerëzore si dhe përfshirjen

**Taçi, P.
dhe Vreka, J.**
« Sfidat e
migracionit dhe
veprat penale
që zhvillohen
me këtë
fenomen »

Polici
dhe
Siguria
nr.3, 2016

¹⁶ Boister, Neil dhe Robert J. Currie (red). *Routledge Handbook of Transnational Criminal Law*. London: Routledge, 2014, (f.190).

e tyre në figurat e krimit të organizuar, gjë e cila përcaktohet nga:

- Organizimi kriminal i sofistikuar i kontrabandistëve (askush nuk e beson se emigrantët sirianë, irakianë, kurdë apo libianë nisen nga vendi i tyre dhe i varin shpresat e udhëtimit tek ndihma e ndonjë banori vendas, që mund ta kontaktojnë rastësisht në kufijtë jugorë shqiptarë, serbë, kroatë apo maqedonas).

- Fitimet nga kontrabandimi i qenieve njerëzore janë konkurruese me fitimet e realizuara nga aktivitetet e tjera të krimit të organizuar si, droga, prostitucioni i organizuar, trafiqet e ndryshme, etj.

- Rrezikshmëria shoqërore tepër e lartë e këtij transporti, deri në sakrifikim të emigrantëve (mjaftojnë rastet e viktimizeve të kamionëve me emigrantë drejt Anglisë, kamioni me mbi 70 persona të vdekur në Austri, mbytyet e anijeve në afërsi të Greqisë, Turqisë e Libisë, të ndodhura muajt e fundit të këtij viti, vetëm nga mbingarkesa me emigrantë, që kontrabandistët e bëjnë për të fituar më shumë).¹⁷

- Shtirja ndërkombëtare e kësaj veprimtarie të organizuar kriminale.

Klasifikimi në figurat e krimit të organizuar të veprave penale të kontrabandimit të qenieve njerëzore, do të bëjë të mundur sekuestrimin e pasurive të rrjedhura nga ky aktivitet kriminal. Në parandalimin apo uljen e efekteve negative të fenomenit të emigracionit të paligjshëm, përveç politikave të tjera shtetërore, një vend të rëndësishëm zë edhe politika penale dhe zbatimimi i saj, e cila sa më mirë t'i përgjigjet realitetit aq më efektive rezulton në këtë sfidë gjithëpërfshirëse për shoqërinë dhe shtetin tonë, Kosovën por edhe për çdo vend tjetër.

6. Përfundime

Politika të ndryshme sociale e shtetërore, që lidhen me trajtimin e familjeve të varfra dhe me probleme të mprehta sociale si dhe regjistrimin, kontrollin dhe arsimimin e fëmijëve që vijnë nga shtresa të varfra, minoritete lëvizëse apo familje me problematika të rënda sociale, do të ishin më të efektshme në parandalimin e emigrimit dhe kufizimin e aktiviteteve të paligjshme që kanë lidhje me emigrimin. Sfidat e madhe me qëllim përballjen dhe uljen e shifrave të emigracionit të paligjshëm, përbën një problem shqetësues për vendin tonë, Kosovën dhe gjithë Ballkanin. Kjo sfidë, nuk është dhe nuk zgjidhet vetëm nga legjislativi penal dhe nga veprimtaria e organeve gjyqësore e atyre ligjzbatuese, të cilat duhet pranuar se veprojnë kryesisht pasi situata kriminale ka ndodhur, ose kur është në zhvillim. Emigracioni i paligjshëm, ka nevojë urgjente për veprimtari parandaluese, po aq sa edhe vepruese. Ky fenomen ka nevojë për një koordinim të plotë të veprimtarive të institucioneve shtetërore, OJQ-ve dhe strukturave të tjera që merren me shtresat sociale në nevojë, për të arritur objektiva në disa drejtime kryesore, si:

- Njohja me legjislativin dhe rregullat e migrimit, që është një drejtim parësor për të cilin duhet të investohen gjithë strukturat shtetërore dhe të tjera, për të arritur një nivel të mirë, të njohurive që duhet të ketë popullsia e vendit tonë për këtë problem.

- Një fushë tjetër e veprimtarive që kufizojnë emigracionin e paligjshëm, janë politikatat sociale në lidhje me shtresat më të varfra të popullsisë, por edhe shtresat e etnisë rome. Këto politika duhet të ndikojnë sa më shumë në:

- regjistrimin e këtyre shtresave në të gjitha veprimtaritë kryesore si, të shkollimit të

*Taçi, P.
dhe Vreka, J.*
« Sfidat e
migracionit dhe
veprat penale
që zhvillohen
me këtë
fenomen »

Polici
dhe
Siguria
nr.3, 2016

¹⁷ Gazeta Shqiptare. "Tjetër kamion me refugjatë 71 të vdekur, tre fëmijë në gjendje të rëndë", 28.08.2015.

fëmijëve, të ndihmës ekonomike, të përfshirjes në fushata të bamirësisë apo të tjera për shtresa në nevojë, të vendbanimit, të listave zgjedhore, njoftimeve të punësimit, etj.;

- informimin mbi punësimet sezonale jashtë shtetit, mundësitë e lëvizjes dhe regjistrimit për këto punësime, demaskimin e menjëhershëm të informacioneve desinformuese, për gjoja punësime masive jashtë shtetit, kërkesa për azilantë, etj.;

- vënien para përgjegjësive ligjore, deri në mbyllje të aktiviteteve ekonomike, të kompanive, subjekteve apo personave që përdorin këto shërbime të licencuara nga shteti, në favor të zhvillimit të emigracionit të paligjshëm.

- Njohja, regjistrimi dhe akomodimi në qendra sociale i fëmijëve që vijnë nga familje me problematika të rënda sociale.

Më sipër u përmend që një faktor që ndikon në rritjen e emigracionit të paligjshëm është edhe perceptimi për realitetin ku jetojmë, mundësitë e shkollimit dhe punësimit ose në mënyrë më të përmblendhur, perceptimi për të ardhmen e secilit prej nesh. Politikat e mësipërme, pikërisht, realizojnë fuqizimin e shpresës së njerëzve e veçanërisht të shtresave më të varfra si dhe largimin e ndjesisë së të qenit i harruar nga shteti yt.

Referenca

1. FRONTEX, Risk Analysis Unit. *Annual Risk Analysis, 2014*. Frontex reference number: 5119 / 201, Warsaw, May 2014.
2. FRONTEX, Risk Analysis Uni. *Annual Risk Analysis, 2015*. Frontex reference number: 5119/2015, Warsaw, April 2015.
3. INSTAT, Raport i vitit 2014, "Migracionin në Shqipëri, viti 2012-2014".
4. *Të dhëna zyrtare të Ministrisë së Brendshme*, për numrin e azilkërkuesve nga Shqipëria, për vitin 2014 dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2015.
5. Townsend, Riley M. *The European Migrant Crisis*. North Carolina, United States: Lulu.com, 2015.
6. McCormick, Di John. *European Union Politics*. London: Palgrave Macmillan, 2015.
7. FRONTEX, Risk Analysis Unit. *Annual Risk Analysis, 2015*. Frontex reference number: 4613/2015, Warsaw, April 2015.
8. Gazeta Shqiptare. "700 emigrantë të vdekur në afërsi të ishullit të Sicilisë", 19.4.2015.
9. Policia e Shtetit. *Analiza e Drejtorisë së Policisë Kufitare*, viti 2014.
10. Banka Kombëtare e Shqipërisë. *Raporti vjetor i Bankës së Shqipërisë për zhvillimin e ekonomisë shqiptare; Raporti vjetor 2015, për zhvillimin e ekonomisë shqiptare FMN dhe BB*.
11. Cierco, Teresa. *The European Union Neighbourhood: Challenges and Opportunities*. Routledge, 2016.
12. Gallagher, Anne T. dhe yFiona David. *The International Law of Migrant Smuggling*. Cambridge: Cambridge University Press, 2014.
13. Agjencia SOT NEWS, "The Times, Klandestinët, trafikimi i tyre bëhet nga bandat shqiptare", 17.8.2015.
14. Gazeta MAPO, "Le Monde: Perandoria fitimprurëse e trafikantëve - mes tyre 7 banda shqiptare", 1 6.08.2015.
15. Gazeta Shqiptare, "Trafikantët e emigrantëve fituan 6 miliardë dollarë në 2015-n" (studim i përbashkët i INTERPOL dhe EUROPOL), 17.05.2016.
16. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
17. Boister, Neil dhe Robert J. Currie (red). *Routledge Handbook of Transnational Criminal Law*. London: Routledge, 2014, (f.190).
18. Gazeta Shqiptare. "Tjetër kamion me refugjatë 71 të vdekur, tre fëmijë në gjendje të rëndë", 28.08.2015.

**Taçi, P.
dhe Vreka, J.**
« Sfidat e
migracionit dhe
veprat penale
që zhvillohen
me këtë
fenomen »

Polici
dhe
Siguria
nr.3, 2016

Sulmet kompjuterike dhe siguria kombëtare



■ **Msc Arjan MUÇA**
Prokuroria e Përgjithshme

Abstrakt

Përdorimi i teknologjisë së informacionit nga dita në ditë po njej një rritje të madhe në botë. Jeta e përditshme është lidhur me sistemet kompjuterike. Sisteme ushtarake dhe të sigurisë kombëtare janë të lidhura me funksionimin e sistemeve kompjuterike. Përdorimi në rritje i teknologjisë së informacionit ka rritur edhe mundësinë e sulmeve ndaj këtyre sistemeve por që do të sillnin pasoja të rënda dhe do të cenonin sigurinë kombëtare. Shtetet pararojë në përdorimin e teknologjisë së informacionit kanë kuptuar që bashkëpunimi ndërkombëtarë është arma më e mirë për të ulur rreziqet e sulmeve me pasoja të rënda. Këto shtete kanë ndërmarr iniciativa ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe kanë rritur bashkëpunimin ndërmjet tyre.

Përdoruesit e teknologjisë së informacionit në Shqipëri po rriten nga dita në ditë në numër. Kriminaliteti në fushën e teknologjisë është duke u rritur nga viti në vit sipas statistikave zyrtare. Sisteme të rëndësishme janë instaluar në shumë fusha jetike të vendit. Shqipëria nuk është i imunizuar nga mundësia e sulmeve të cilat do të sillnin pasoja të rënda dhe do të cenonin sigurinë kombëtare. Në Shqipëri janë ndërmarr masa të rëndësishme legjislative, organizative për të ulur dhe minimizuar rrezikun e sulmeve kompjuterike.

Për një të ardhme më të sigurt janë të nevojshme masa legjislative, organizative dhe trajnime të stafëve të institucioneve të cilave janë drejtpërdrejtë të ngarkuar me parandalimin e sulmeve kompjuterike procedimin penal të autorëve të tyre dhe me zvogëlimin e pasojave të këtyre sulmeve.

Muça, A.
« Sulmet kompjuterike dhe siguria kombëtare »

Fjalëkyçe:

kibernetika, siguria, sulmet kompjuterike, siguria kombëtare, procedimin penal, krime kompjuterike, terrorizëm kibernetik.


Policimi dhe
Siguria
nr.3, 2016

1. Hyrje

Përdorimi i internetit vazhdon të rritet me një shpejtësi të madhe. Jeta e përditshme po varet gjithnjë e më shumë nga përdorimi i teknologjisë së lartë. Shumë fusha kritike, duke filluar nga ato qeveritare, të sigurisë ushtarake dhe civile, shëndetësore, të transportit, të telekomunikacionit e të komunikimit etj., janë duke punuar të lidhura në rrjet dhe duke përdorur teknologjinë e informacionit. Në sistemet kompjuterike të sotme janë duke u ruajtur dhe duke u transferuar të dhëna në miliona gb (gigabytes). Sistemi financiar botëror në epokën e globalizimit është i ndërruar nga sistemet kompjuterike. Shumica e qeverive të vendeve të zhvilluara të botës, e kanë lidhur punën e tyre me funksionimin e rrjeteve kompjuterike.

Fuqia e informatikës është rritur në mënyrë të jashtëzakonshme në bashkëpunim me reduktimin e shpenzimeve dhe sot kompjuterët janë kudo¹.

Tabela 1. Përdorues interneti në botë nga viti 2000 deri në vitin 2016.



Muça, A.
« Sulmet kompjuterike dhe siguria kombëtare »

Policimi dhe Siguria
nr.3, 2016

¹ <http://www.internetlivestats.com/internet-users/#trend>. Parë për herë të fundit më dt. 25 maj 2016.

Lidhjet e kompjuterëve në rrjet kanë sjellë komunikim më të lehtë, më të shpejtë dhe më të lirë. Infrastruktura globale e informacionit është bërë me rëndësi jetike për ekonominë në të gjithë botën, duke u kërcënuar si një objekt kryesor i sulmeve terroriste dhe shkatërruese në botë.

Një dekadë më parë, nuk mund të parashikohet se si teknologjia e informacionit dhe e telekomunikacionit do të bëhej pjesë e jetës sonë të përditshme, apo se sa ne do të ndërvareshim prej saj. Teknologjia ka lidhur bashkësinë ndërkombëtare në nivel global duke sjellë përfitime të mëdha, por ajo gjithashtu ka rritur mundësinë e ardhjes së pasojave të rënda në raste se sulmohet. Gjithnjë e më shumë po raportohen sulme kompjuterike në sisteme kompjuterike të rëndësishme.

2. Terrorizmi kompjuterik

Sot është bërë e qarte se interneti dhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit mund të konsiderohen si mjete politike. Aftësia për të komunikuar nëpërmjet fjalëve, imazheve dhe tingujve, mbështet fuqinë për të bindur, për të informuar, ushqen debatin, diskutimin, fuqinë e propagandës, shpifjeve apo informatave të rreme. Sot kjo nuk është më pronë e vetme e atyre që zotërojnë shtypshkronja, radio stacione, apo rrjetet televizive. Çdo kompjuter i lidhur në internet është potencialisht një shtypshkronjë, një stacion transmetimi, apo një gazetë. Në shekullin e 21, terroristët janë tërhequr nga mundësia për t'u lidhur me internet, pasi është një mjet ideal propagande. Në të kaluarën, ata komunikonin nëpërmjet akteve të dhunës dhe këto akte tërhoqën vëmendje të mjaftueshme për të publikuar autorët ose për shpjeguar arsyetimet e tyre ideologjike dhe politike. Me ardhjen e internetit, të njëjtat grupe mund të shpërndajnë informacionin e tyre, të paprekur nga institucionet e qeverisë.

Rëndësinë e madhe të internetit e tregoi dhe përdorimi i medieve sociale në Turqi, gjatë grushtit të shtetit të dështuar në datën 15 korrik 2016. Në datën 15 korrik 2016, Presidenti i Turqisë, Erdogan, përdori një nga mediat sociale, "FaceTime", duke u bërë thirrje mbështetësve të qeverisë, të cilët dolën në numër të madh në sheshet e Turqisë, duke qenë kështu faktor kryesor në neutralizimin e grushtit e shtetit.² Por, edhe pjesëtarët e grushtit të shtetit të dështuar, menjëherë sapo filluan sulmin ndaj institucioneve në Turqi, bllokuan rrjetet sociale³, "Faceebok" dhe "Twitter".

Grupet terroriste ndërkombëtare, kanë aftësinë për të sulmuar infrastrukturën e teknologjisë së informacionit në botë, qoftë duke përdorur mjete relativisht të thjeshta. Metodatat e përdorura, mund të jenë metoda tradicionale terroriste si, bomba - drejtuar fizikisht ndaj objekteve ku ndodhen qendra të rëndësishme të teknologjisë së informacionit dhe komunikacionit, por mund të mbështeten edhe në persona me aftësi të mira kompjuterike, qofshin këta të fundit edhe të paguar. Në vitin 1998, është raportuar se 12 nga 30 organizatat terroriste të identifikuara nga Departamenti i Shtetit i SHBA-së, kishin faqet e tyre në internet, ndërsa sot numri i tyre është rritur më shumë. Terrorizmi, në përgjithësi, mund të përkufizohet si përdorimi ose kërcënimi për

Muça, A.
« Sulmet
kompjuterike
dhe siguria
kombëtare »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

² Boyle, Darren. "How FaceTime stopped the Turkish coup: President Erdogan's last-ditch mobile phone call to privately owned TV station mobilised mass support by harnessing social media", në *Dailymail*, 17 July 2016. Parë për herë të fundit, më dt. 20 korrik 2016:

<http://www.dailymail.co.uk/news/article-3693987/How-FaceTime-stopped-Turkish-coup-President-Erdogan-s-ditch-mobile-phone-call-privately-owned-TV-station-mobilised-mass-support-harnessing-social-media.html>

³ "Orë pas ore / Grushti i shtetit në Turqi, shkon në 300 numri i viktimave", *Gazeta Panorama*, 17 korrik 2016. Parë për herë të fundit, më dt. 20 korrik 2016:

<http://www.panorama.com.al/ore-pas-ore-grushti-i-shtetit-ne-turqi-shkon-ne-300-numri-i-viktimave/>

përdorimin e dhunës, me motivime politike ose fetare, drejtuar ndaj objektivave joushtarake, me qëllim ndikimin në publik.

Nga kombinimi i fjalës “terrorizëm” dhe “cyber” (kompjuterike), mund të themi si përkufizim, se, terrorizmi kompjuterik është sulmi ose kërcënimi për sulme, ndaj sistemeve kompjuterike ose nëpërmjet sistemeve kompjuterike, për të frikësuar apo të detyruar një qeveri apo popullsinë, për të mbështetur objektivat politike apo sociale të sulumuesve. Këto sulme, duhet të sjellin si pasojë, dëme me kosto të lartë në infrastrukturën jetësore, që realisht do të frikësonin popullsinë. Kjo gjë do të thotë, se sulmet nuk do të rezultonin në dhunë të drejtpërdrejtë ndaj jetës, por do të preknin funksionimin normal të jetesës së popullatës. Legjislacionet kombëtare, por edhe ndërkombëtare, nuk kanë dhënë një përkufizim ligjor për terrorizmin kompjuterik⁴.

Në vitin 1999, në një raport të Qendrës për Studimin e Terrorizmit dhe Luftës Asimetrike (CSTIW) në Shkollën Pasuniversitare Detare në Monterey, Kaliforni, “terrorizmi kompjuterik” është përkufizuar si “...shkatërrimi i paligjshëm ose prishje e pronës dixhitale për të frikësuar apo detyruar njerëzit”⁵. Ndërsa në një raport të NATO-s, të vitit 2001, terrorizmi kompjuterik përkufizohet si “...çdo akt terrorizmi... që përdor sistemet e informacionit ose të teknologjisë kompjuterike si armë ose si shënjestër.”⁶

Nga këto përkufizime, kuptohet se terrorizmi kompjuterik nuk është vetëm sulm, por edhe përdorimi i propagandës, nga grupet terroriste në përgjithësi, për të përhapur idetë e tyre. Në disa faqe interneti, grupe të ndryshëm personash tregojnë dhe paraqesin programe kompjuterike të cilat do t’u shërbenin grupeve terroriste për të dëmtuar sistemet kompjuterike të shteteve në shënjestër të tyre. Gjatë dy muajve të vitit 2011, grupi “Lulz Security” (LulzSec), ka sulmuar faqe interneti të institucioneve dhe kompanive me emër, siç ishin rastet e sulmeve ndaj kompanisë “Sony” dhe “Nintendo”, por edhe ndaj faqeve të CIA-s, Senatit Amerikan dhe disa stacioneve televizive, faqen e policisë së Arizonës, të policisë britanike etj.

Agjencitë e zbatimit të ligjit dhe të sigurisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por jo vetëm, si CIA apo Departamenti i Mbrojtjes, kanë qenë të preferuara për t’u sulmuar nga piratët informatikë. Në fillimet e tyre sulmet kompjuterike kryheshin prej të rinjve me aftësi kompjuterike të mira dhe në shumicën e rasteve këta persona nuk kishin ndonjë përfitim material nga këto sulme. Zbulimi dhe arrestimi i këtyre personave ishte respektivisht i lehtë, derisa në fushën e sulmeve kompjuterike filluan të shfaqeshin dyshime të bashkëpunimit të tyre me shtete të ndryshme. Nga “Raporti i Krimeve në Internet”, raportohet se humbjet nga sulmet kompjuterike në vitin 2015 ishin 1 070 711 522 dollarë amerikan. Vendet më të prekura kanë qenë Shtetet e Bashkuara të Amerikës me 80.2%; Britania e Madhe me 2.47%; Nigeria me 2.2%; Kina me 1.91 % dhe India me 1.46%⁷

⁴ Në Kodin Penal Shqiptar, në nenin 230 të tij, kërkohet nga ana objektive kryerja e veprimeve të dhunshme për tu konsideruar si akt terrorist.

⁵ Westphal Jr., Raymond (red.). *War and Virtual War The Challenges to Communities, Volumi I*. Oxford: Inter-Disciplinary Press Oxford, 2002, (f. 91).

⁶ Mates, Michael (raportues). NATO Parliamentary Assembly, NATO Parliamentary Assembly, “Technology and Terrorism, Draft Interim Report”, prill 2001.

Raporti i Nënkomitetit të teknologjisë ushtarake të NATO-s. Parë për herë të fundit, më dt. 15 korrik 2016: http://www.tbmm.gov.tr/ul_kom/natopa/raporlar/bilim%20ve%20teknoloji/AU%20121%20STC%20Terrorism.htm

⁷ “Raporti i Krimeve në Internet”, viti 2015, faqe 14. Raporti përgatitet nga IC3 (Internet Crime Complaint Center), e cila ka për mision paraqitjen publikut një mekanizëm të besueshëm dhe të përshtatshëm të raportimit dhe të furnizojë me informacion Byronë Federale të Hetimeve (FBI) në lidhje me aktivitetin e dyshuar në Internet. https://pdf.ic3.gov/2015_IC3Report.pdf.

Parë për herë të fundit, më dt. 1 korrik 2016.

Muça, A.

« Sulmet kompjuterike dhe siguria kombëtare »

Policimi dhe Siguria nr.3, 2016

Në vitin 2010 Kina u akuzua për spiunazh kompjuterik, pasi sulmoi kompjuterët e kompanive kontraktore të Departamentit të Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara, duke marrë detaje për avionët F-35. Gjithashtu, Kina është akuzuar se në vitin 2009 ndërmori sulme ndaj kompanisë Google. Në vitin 2009, Koreja e Veriut u fajësua se ndërmori sulme masive kundër SHBA-së dhe Koresë së Jugut, duke sulmuar shumë faqe interneti ku u përshi edhe faqja e NASDAQ, Shtëpia e Bardhë, Departamenti i Thesarit dhe Shërbimi Sekret. Më 24 nëntor 2014, një grup “hacker” i identifikuar me emrin “Gardianët e Paqes” (GOP) sulmuan dhe morën të dhënat konfidenciale nga shoqëria “Sony Pictures Entertainment”. Një muaj më vonë, ky grup kërkoi nga shoqëria “Sony” që të tërheqë nga tregu një komedi ku flitej për një komplot kundër liderit të Koresë së Veriut, Kim Jong. Zyrtarët e Shteteve të Bashkuara, pas vlerësimit të programeve, teknikës dhe burimeve të përdorura në sulm, deklaruan se sulmi u sponsorizua nga Koreja e Veriut. Në vitin 2008, qeveria gjeorgjiane akuzoi Rusinë për orkestrimin e një bllokimi të shërbimeve të internetit në Gjeorgji, vetëm një ditë para konfliktit ushtarak të Gjeorgjisë dhe Ruisë në Osetinë e Jugut.

Një nga rastet më të spikatur, është një seri sulmesh kibernetike që filluan në datën 27 prill 2007, duke bllokuar faqet e internetit të institucioneve në Estoni, duke përfshirë parlamentin estonez, bankat, ministritë, gazetat dhe transmetuesit, si pasojë e një vendimi të marrë nga qeveria estoneze për të hequr përmendoren e ushtarit të panjohur nga Talini, vepër sovjetike. Ky rast është studiuar intensivisht nga shumë vende dhe ekspertët e kanë konsideruar si ngjarja e dytë më e madhe e sulmeve kompjuterike të sponsorizuara nga shteti, pas “shiu titan”⁸. Megjithëse nuk u gjenden prova se shteti rus ishte përgjegjës për këtë sulm, grupet etnike ruse të mbështetura nga Rusia kanë marrë përsipër këtë sulm. Duke parë listën e sulmeve të mësipërme shihet një implikim i shteteve me demokraci jo të konsoliduar ose me sisteme diktatoriale. Kjo situatë e përfshirjes së shteteve në sulme kompjuterike, është e rrezikshme pasi do të sillte pasoja më të mëdha se sulmet nga individë ose grupe kriminale ose terroriste, me aftësi të mira kompjuterike. Në përgjithësi, shënjestra e këtyre sulmeve kanë qenë institucionet e sigurisë së SHBA-së dhe në veçanti, sistemet e mbrojtjes ushtarake, që do të sillnin dobësimin e aftësisë ushtarake. Kjo situatë është vlerësuar me një vëmendje të veçantë edhe nga strukturat planifikuese dhe vendimmarrëse të NATO-s. Në Bruksel janë krijuar struktura specifike për mbrojtjen e rrjeteve kompjuterike.

Ministria gjermane e Mbrojtjes, duke parë numrin në rritje të sulmeve kompjuterike, ku çdo ditë kryhen 2500 deri në 6500 sulme ndaj rrjeteve të Gjermanisë, ka planifikuar të krijojë një strukturë të posaçme e cila do të koordinojë 15 000 punonjësit civil dhe ushtarak të teknologjisë së informacionit që punojnë për ushtrinë gjermane⁹. Rreziku nga sulmet kompjuterike u theksua edhe më shumë në konceptin e ri strategjik të NATO-s, në takimin e mbajtur në Lisbonë, në nëntor 2010, ku u parashikua: “Sulmet

⁸ Bodmer, Kilger, Carpenter dhe Jones. *Organized Cyber Threat Counter-Exploitation*. New York: McGraw-Hill Osborne Media, 2012, (f. 43).

Shiu Titan (Titan Rain) ka të bëjë me një seri sulmesh të koordinuara, të sistemeve kompjuterike amerikane, që nga viti 2003. Sulmet ishin të etiketuara si me origjinë kineze, me natyrë spiunazhit, të sponsorizuara nga shteti - spiunazh korporatash. Në fillim të dhjetorit 2005, drejtori i institutit SANS, një institut i sigurisë në SHBA, tha se sulmet ishin “rezultat i hakerave ushtarakë kinezë, që u përpoqën për të mbledhur informacion mbi sistemin amerikan.” Hakersat e ‘Shiut Titan’ fituan akses në rrjetet kompjuterike të SHBA-së, duke përfshirë ato të Lockheed Martin, Sandia National Laboratories, Redstone Arsenal, dhe NASA.

⁹ “Bundeswehr rüstet sich für Cyber-Angriffe”. *n-tv.de*, 17 shtator 2015. Parë për herë të fundit, më dt. 5 korrik 2016.

<http://www.n-tv.de/politik/Bundeswehr-ruestet-sich-fuer-Cyber-Angriffe-article15951756.html>

kompjuterike po bëhen më të shpeshta, më të organizuara dhe më të kushtueshme në lidhje me dëmin që ato shkaktojnë... Ato mund të përshkallëzohen deri në pragun e kërcënimit të zhvillimit kombëtar dhe të sigurisë...”.

Prej shumë vitesh edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Strategjinë e saj të Sigurisë Kombëtare, parashikohet si rrezik kryesor për sigurinë e saj edhe kërcënimet nga sulmet kibernetike. Në shumë pjesë të saj parashikohen masa kundër këtyre lloj sulmeve “...ne jemi duke formësuar standarde për sigurinë kibernetike dhe duke ndërtuar kapacitete ndërkombëtare për të ndërprerë dhe hetuar kërcënimet kibernetike...”¹⁰.

3. Situata e kriminalitetit kibernetik në botë

Situata në pamje të parë duket pesimiste pasi numri i sulmeve kompjuterike është shtuar dhe pasojat e tij janë gjithnjë edhe më të mëdha. Aftësitë e rrjeteve kompjuterike duket se janë të cenueshme. Aftësitë teknike të mbrojtjes së rrjeteve nga sulmet kompjuterike, rriten pothuajse në të njëjtën shkallë me aftësitë e personave që i godasin këto rrjete mbrojtëse. Kjo është logjike, pasi janë njerëzit të cilët krijojnë programe dhe pajisje kompjuterike mbrojtëse dhe po njerëzit, mundet që t’u kundërvihen këtyre masave. Një krim tradicional ka një vendngjarje konkrete, të prekshme dhe që mund të këqyret dhe nga ku mund të grumbullohen prova të mjaftueshme për fajësinë e autorëve. Por, një sulm kompjuterik nuk ka një vendngjarje klasike. Sulmi mundet të realizohet nga mijëra kilometra larg dhe pasoja të jetë në një shtet tjetër. Megjithatë, kjo nuk është një situatë pa zgjidhje. Përgjigja e agjencive të zbatimit të ligjit ka qenë e shpejtë dhe komplekse. Pas sulmit që u realizua nga grupi “Lulz Security” ndaj sistemeve kompjuterike, reagimi i agjencive të zbatimit të ligjit ishte i shpejtë, duke arrestuar një 19 vjeçar, pjesë e grupit “LulzSec”, i cili ndërmori sulmin ndaj policisë britanike (SOCA) duke e detyruar grupin të shpërndahej.

Sulmet prekën në përgjithësi faqet e internetit, duke mos hyrë dot në bazat e të dhënave të institucioneve që sulmuan. Për shumë kohë u bënë publike edhe materiale konfidenciale të mesazheve elektronike të Departamentit të Shtetit të SHBA-së nga faqja e internetit *WikiLeaks*. Në pamje të parë, të krijohet ideja se situata është shumë e rëndë, përderisa është arritur që të merren materiale konfidenciale nga rrjetet kompjuterike të SHBA-së, i cili është vendi pararojë i teknologjisë së informacionit. Por, nga hetimet, u zbulua që këto materiale i ishin dhënë Julian Assange, nga një punonjësi ushtrisë së SHBA-së, gjë që mund të kishte ndodhur edhe me materiale të shkruara në letër. Zotësia kompjuterike e Julian Assange, qëndroi në faktin se ishte ai, që arriti të deshifronte këto materiale, pasi ato ishin të koduara.

Prej rreth 20 vjetësh nga shumë shtete, realizimi i një sulmi kompjuterik është konsideruar si krim dhe i dënueshëm në shumicën e legjislacioneve të tyre. Parashikimi si krime në shumicën e ligjeve penale të botës, ka bërë që sulmet me pasoja të mëdha të jenë në rënie. Shpenzimet për hetimet e këtyre lloj krimeve kërkojnë kosto dhe kohë të gjatë, pasi siç thamë, nuk përfshihet vetëm një shtet, por shumë shtete e shumë sisteme kompjuterike; bashkëpunimi në luftën kundër këtyre lloj sulmeve është parë si prioritet dhe zgjidhje afatgjatë. Një nga nismat kryesore në këtë drejtim, u ndërmor nga Këshilli i

Muça, A.
« Sulmet kompjuterike dhe siguria kombëtare »

Policimi dhe Siguria
nr.3, 2016

¹ The White House, Washington, USA. *National Security Strategy*, 2015. Parë për herë të fundit, më dt. 3 korrik 2016:
https://www.whitehouse.gov/sites/default/files/docs/2015_national_security_strategy.pdf

Evropës. Për unifikimin e luftës kundër krimeve kompjuterike, u hartua dhe u miratua nga Këshilli i Evropës “Konventa për Krimin Kibernetik” ose siç njihet ndryshe, “Konventa e Budapestit”. “Konventa për Krimin Kibernetik” është miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës në Sesionin e 109-të (më 8 nëntor 2001) dhe u hap për nënshkrim në Budapest, më 23 nëntor 2001, në konferencën ndërkombëtare për krimin kibernetik.

“Konventa për Krimin Kibernetik” vendos tre detyrime themelore për shtetet anëtare:

- (1) përqasjen e legjislacionit penal të brendshëm;
- (2) përqasjen e legjislacionit procedural penal;
- (3) zgjerimin e juridiksionit penal.

Me iniciativë të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, në datën 30 korrik 2010 nga 15 vende, u nënshkrua një deklaratë e përbashkët në kuadër të bashkëpunimit në luftën kundër sulmeve kompjuterike¹¹.

Nga kjo deklaratë rezulton se lufta kundër sulmeve kompjuterike, kërkon përgjigje të përbashkët dhe shprehet qartë nevoja për bashkëpunim ndërkombëtar kundër kërcënimeve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të komunikacionit. Bashkimi Evropian duke i konsideruar një shqetësim në rritje sulmet kompjuterike, në vitin 2005 ka miratuar vendimin kornizë të Këshillit numër 222 / JHA, datë 24 shkurt 2005, “Mbi sulmet kundër sistemeve të informacionit”. Më pas, në vitin 2013 ka miratuar direktivën numër 40/2013, “Mbi sulmet kundër sistemeve të informacionit” direktivë e cila shfuqizoi vendimin kornizë të vitit 2005. Sipas kësaj direktive, shtetet anëtare të Bashkimit Evropian i kanë konsideruar këto sulme si një kërcënim kundër lirisë, sigurisë dhe drejtësisë: “Sulmet kundër sistemeve të informacionit, dhe, në veçanti, sulmet e lidhura me krimin e organizuar, janë një kërcënim në rritje në Bashkimin Evropian, . . . Kjo përbën kërcënim kundër lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, për një shoqëri më të sigurt të informacionit...”¹². Për këtë arsye vendeve anëtare ju është kërkuar përafrimi i legjislacionit dhe parashikimi i sulmeve kompjuterike si vepra penale të dënueshme nga legjislacionet penale kombëtare. Bashkimi Evropian ka ngarkuar dhe ka krijuar shumë struktura të specializuara në luftën kundër kërcënimeve kompjuterike¹³.

4. Situata e sulmeve kompjuterike në Shqipëri dhe masat e marra

Prej vitesh edhe Shqipëria po ecën me hapin botëror në përdorimin e internetit dhe të sistemeve kompjuterike. Qeveria dhe shoqëria shqiptare kanë ndërmarrë shumë nisma, të cilat kanë bërë që edhe në Shqipëri të bëhet domosdoshmëri dhe normalitet përdorimi i sistemeve kompjuterike. Në Shqipëri e përdorin internetin 1 815 145 njerëz, që përfaqëson 60.1 % të popullatës me një rritje 24 herë nga viti 2000¹⁴.

Muça, A.
« Sulmet kompjuterike dhe siguria kombëtare »

Policimi dhe Siguria
nr.3, 2016

¹¹ Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues nga këto shtete: SHBA, Rusi, Kinë, Britani e Madhe, Francë, Gjermani, Estoni, Bjellorusi, Brazil, Indi, Itali, Izrael, Katar, Kore e Jugut dhe Afrikë e Jugut. <http://www.unidir.org/pdfactivitespdf5-act483.pdf>.

¹² The European Parliament and The Council of the European Union. “Directive 2013/40/EU of The European Parliament and of The Council of 12 August 2013 on attacks against information systems and replacing Council Framework Decision 2005/222/JHA”. *Official Journal of the European Union*, 14.8.2013. Parë për herë të fundit, më dt. 20 qershor 2016: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2013:218:0008:0014:EN:PDF>.

¹³ Eurojust, Europol, European Cyber Crime Centre, European Network and Information Security Agency (ENISA).

¹⁴ Statistikë e datës 31 mars 2013, e marrë nga “Internet World Stats”. Parë për herë të fundit në datën 10 qershor 2016: <http://www.internetworldstats.com/stats4.htm>.





Tabela 2. Përdoruesit e internetit në Shqipëri, 2004 -2013.

Shumë prej institucioneve kryesore në vend janë duke punuar me sisteme kompjuterike të lidhura në rrjet. Këtu mund të përmendim sistemet shumë të suksesshëm që funksionojnë në Ministrinë e Brendshme, TIMS, MEXES dhe Regjistri Themeltar i Shtetasve. Sisteme të suksesshme funksionojnë edhe në Ministrinë e Financave (Tatimet, Doganat dhe FIU), në Ministrinë e Mbrojtjes, Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), në Ministrinë e Transportit dhe Punëve Publike, te Regjistrimi i Mjeteve dhe Patentave, në Ministrinë e Drejtësisë, te Regjistri i Gjendjes Gjyqësore, te Sistemi i Noterëve, te Sistemi bankar shqiptar, etj. Sistemi gjyqësor pothuajse funksionon i gjithi edhe në formë elektronike. Aktualisht është në fazën përfundimtare edhe sistemi kompjuterik i prokurorisë CAM-s. U përmendën institucionet e mësipërme pasi janë institucionet kryesore të sigurisë në vend. Puna në këto institucione është e bazuar në sistemet kompjuterike dhe analizimin e të dhënave nga këto sisteme. Në krahasim me vendet e zhvilluara, Shqipëria është pas në përdorimin e blerjeve elektronike “online”. Ky përdorim masiv i sistemeve kompjuterike ka rritur riskun e sulmeve ndaj këtyre sistemeve. Nga treguesit statistikor të Prokurorisë rezultojnë se situata me ndërhyrje në sistemet kompjuterike në Shqipëri ka filluar, por nuk është në përmasa që të cenon funksionimin normal të vendit. Në përgjithësi raportimet kanë qenë për vepra penale të ndodhura ndaj individëve ose biznesit dhe jo ndaj institucioneve qeveritare.

Tabela 3¹⁵. Krimet kompjuterike regjistruar dhe dërguar për gjykim në vitin 2015.




Muça, A.
« Sulmet kompjuterike dhe siguria kombëtare »

Policimi dhe Siguria
nr.3, 2016

¹⁵ Treguesit statistikor për kriminalitetin në Shqipëri, u referohen të dhënave të zyrës së statistikave të Prokurorisë së Përgjithshme dhe raportit vjetor, viti 2013 të Prokurorisë të Përgjithshme.


Numri i ulët i procedimeve për krimet kompjuterike të dërguar për gjykim ka të bëjë me faktin se në shumicën e rasteve provat kërkohen me letërporosi ndërkombëtare, pasi pothuajse të gjithë serverët janë jashtë territorit të Shqipërisë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës në marrëdhëniet e saj juridiksionale me jashtë vihen në lëvizje për të mbledhur prova në lidhje me forma të rënda të kriminalitetit si terrorizëm, krim i organizuar korrupsion, krime të dhunshme ose krime me dëm të konsiderueshëm financiar ¹⁶

Tabela 4. Krimet kompjuterike regjistruara në vitin 2015.



Numri i vogël i krimeve kompjuterike duke përfshirë “mashttrimin kompjuterik”(neni 143/b), tregon se autorët e veprave penale në Shqipëri parapëlqejnë të kryejnë krime të cilat sjellin përfitim ekonomik, pasi “mashtrimi kompjuterik” është veprë penale e cila kërkon përfitim material. Arsye tjetër e numrit të ulët janë edhe masat e marra nga institucionet qeveritare dhe ato kushtetuese për të ulur në minimum rrezikun. Kështu, përveç sistemit bankar, që u përmend më lartë, të gjitha sistemet kompjuterike në përdorim nga institucionet e sigurisë shqiptare, janë rrjete të mbyllur (intranet) duke mos lejuar mundësi fizike të kontaktit të shkelëseve të ligjit me këto sisteme. Kështu, të gjitha sistemet e Ministrisë së Brendshme e Ministrisë së Mbrojtjes funksionojnë vetëm në këto institucione dhe mundësia për të ndërhyrë nga jashtë është pothuajse zero, pasi nuk kanë lidhje me internetin.

Tabela 5. Numri të pandehurve, nga viti 2009 deri në vitin 2014.




Muça, A.
« Sulmet kompjuterike dhe siguria kombëtare »

Policimi dhe Siguria nr.3, 2016

¹⁶ Procedimi penal numër Nr.355 datë 20.02.2014 i Prokurorisë pranë Gjykatës së shkallës së Parë, Vlorë.


Krimet kompjuterike mund të ndahen në dy grupime të mëdha: vepra penale të cilat kanë si shënjestër sistemet kompjuterike¹⁷ dhe vepra penale të cilat kryhen nëpërmjet sistemeve kompjuterike¹⁸.

Tabela 6. Krimet kompjuterike nga viti 2009 deri në vitin 2014.



Grafiku i mësipërm tregon rritjen e madhe të veprave penale kompjuterike, nga viti 2009¹⁹ deri në vitin 2014 me pothuajse 17 herë. Në analizë të treguesve statistikorë, rezulton se numrin më i madh të veprave penale kompjuterike e zë vepra penale e “mashttrimit kompjuterik”, parashikuar nga neni 143/b i Kodit Penal. Pësia specifike që zë kjo veprë penale, është 46 % e të gjithë veprave penale kompjuterike. Numri i lartë i kësaj veprë penale lidhet me kartat e vjedhura dhe të klonuara, gjë që sjell edhe përfitime të mëdha për autorët e këtyre veprave penale. Kjo veprë është paraqitur edhe me ndërhyrjen në komunikimet elektronike ndërmjet shoqërive tregtare dhe më pas përfitime nga llogaria bankare ose pagesat nga këto shoqëri.

Tabela 7. Përqindja e krimeve kompjuterike nga viti 2009 deri në vitin 2014.



¹⁷ Neni 74/a, Shpërndarja kompjuterike e materialeve kompjuterike pro gjenocidit ose krimeve kundër njerëzimit. Neni 84/a, Kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterike. Neni 119/a, Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobie nëpërmjet sistemeve kompjuterike. Neni 119/b, Fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemeve kompjuterike. Neni 143/b, Mashtrimi kompjuterik. Neni 186/a, Falsifikimi kompjuterik. Neni 192/b, Hyrja e paautorizuar kompjuterike. Neni 293/a, Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike. Neni 293/b, Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike. Neni 293/c, Ndërhyrja në sistemet kompjuterike. Neni 293/ç, Keqpërdorimi i pajisjeve.

¹⁸ “Pornografia”, parashikuar nga Neni 117 i Kodit Penal, kur kjo veprë kryhet nëpërmjet sistemeve kompjuterike; “Vepra të turpshme”, parashikuar nga paragrafi i katërt i nenit 108 i Kodit Penal, kur kjo veprë penale kryhet nëpërmjet sistemeve kompjuterike.

¹⁹ Treguesit statistikorë të veprave penale kompjuterike fillojnë nga viti 2009, pasi këto vepra penale u shtuan me ligjin Nr. 10023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal”.

Nga studimi i rasteve të ndodhura në Shqipëri, vlen të përmendet bashkëpunimi në goditjen e grupeve të cilat përfitonin nga përdorimi i kartave të kreditit të vjedhura dhe më pas të klonuara, duke proceduar dhe dënua edhe shtetas të huaj²⁰ ose i grupeve të cilët në mënyrë të padrejtë, përfitonin shërbime të televizioneve me pagesë.²¹

Janë bërë publike edhe mashtrime që kryhen nga shtetas, në përgjithësi nga vendet e Afrikës, të cilët nëpërmjet mesazheve SMS ose postës elektronike përfitojnë nga persona shqiptarë shuma parash, duke i shpallur “fitues” lotarie ose trashëgimie²².

Numrin e dytë të veprave penale kompjuterike e zë vepra penale “Ndërhyrje në sistemet kompjuterike” vepër penale e parashikuar nga neni 293/b të Kodit Penal. Kjo vepër është e përhapur në këtë masë, pasi shumë përdoruesve të rrjeteve sociale ju ndërhyhet në adresat e tyre duke ju ndryshuar fjalëkalimet²³. Këto vepra penale kryhen në përgjithësi pa përfitim nga autorët e tyre dhe zakonisht ata janë të rinj me aftësi shumë të mira në fushën e teknologjisë së informacionit. Kjo vepër është shoqëruar në disa raste edhe me kërkesën për pagesa në shkëmbim të mos publikimit të fotografike intime të përdoruesve të faqeve sociale.²⁴

Në ditët që po përgatitej ky shkrim, BBC raportoi se faqja e internetit e policisë së Jorkshirit Jugor ishte sulmuar nga shqiptarët.²⁵ Ashtu si nëpër botë, edhe në Shqipëri, interneti ka shërbyer për të bërë publike thirrje nga grupe ekstremiste. Një rast i tillë është zbuluar dhe goditur nga bashkëpunimi i mirë ndërmjet institucioneve të sigurisë shqiptare dhe të Prokurorisë, ku u arrit të arrestohej dhe të dënohej nga gjykata e rrethit gjyqësor Durrës një shtetas shqiptar²⁶ i cili përdorte internetin për të bërë thirrje për “luftën e shenjtë”. Megjithatë, ekzistojnë informacione që edhe sistemi bankar shqiptar ka qenë i preferuar për t’u goditur nga sulme të tilla, por pak sulme të tilla janë raportuar në agjencitë e zbatimit të ligjit, pasi bankat kanë menduar se do të ishte një reklame negative për to, nëse do të bëhej publike ndërhyrja në to. Për të siguruar një mbrojtje më të madhe këtyre sistemeve, qeveria shqiptare ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në aspektin e legjislacionit dhe atë organizativ.

4.1 Masat legjislative

Institucionet shqiptare kanë konsideruar si rrezik për sigurinë kombëtare sulmet kibernetike. Në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të vitit 2014 është parashikuar se

²⁰ Vendimi numër 82 datë 17.01.2014, Gjykata e shkallës së Parë Tiranë, me anë të cilit janë shpallur fajtorë të pandehurit me shtetësi malajziane M. P. dhe L. K., për veprën penale të “mashtrimit kompjuterik” parashikuar nga neni 143/b/2 i Kodit Penal; Vendimi numër 1213, datë 16.04.2015, Gjykata e shkallës së Parë Tiranë, me anë të së cilit është shpallur fajtor, i pandehuri kosovar, Z. B., për veprën penale “mashtrim kompjuterik”, parashikuar nga neni 143/b/2 i Kodit Penal; Vendimi numër 4639, datë 23.12.2015, Gjykata e shkallës së Parë Tiranë, me anë të së cilit është shpallur fajtor i pandehuri me shtetësi turke, S. B., për veprën penale “mashtrim kompjuterik”, parashikuar nga neni 143/b/2 i Kodit Penal.

²¹ Vendimi numër 1112, datë 21.07.2010, Gjykata e shkallës së Parë Tiranë.

²² Në datën 30 qershor 2011, Policia e Shtetit, bën të ditur se kohët e fundit janë evidentuar disa raste mashtrimesh të kryera nëpërmjet postës elektronike, pre e të cilave kanë qenë qytetarë shqiptarë. Parë për herë të fundit në datën 12 qershor 2016: http://www.asp.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=1408%3Apolicia-e-shtetit-kujdes-ne-perdorimin-e-e-mailit-adresa-juaj-mund-te-perdoret-per-te-mashtruar-te-tjeret&catid=41%3Ainformation-for-press&lang=sq.

²³ Vendimi numër 640 datë 02.03.2016, Gjykata e shkallës së Parë Tiranë me anë të cilit është shpallur fajtor i pandehuri I.SH. për veprën penale “Ndërhyrjen në të dhënat kompjuterike” parashikuar nga neni 293/b të Kodit Penal.

²⁴ Vendimi numër 2556 datë 14.10.2015 i Gjykatës së Lartë.

²⁵ <http://www.bbc.com/news/uk-england-south-yorkshire-36633280>. Parë për herë të fundit në datën 1 qershor 2016.

²⁶ Në 12 tetor 2009, u arrestua në Durrës shtetasi Artan Kristo ose siç njihet ndryshe Muhamed Abdullahi për “nxitje, thirrje publike dhe propagandë për kryerjen e veprave me qëllime terroriste”. Video me pamje terroriste shoqëruar me tekst në shqip ku bëhet thirrje për luftë janë publikuar në një faqe interneti me emrin “Forum-islamik”, www.forumi-islamik.com. Parë për herë të fundit në datën 10 maj 2016.

Shqipëria është e ekspozuar “...ndaj rreziqeve të natyrës kibernetike me aktorë shtetërorë dhe joshetërorë. Sulmet kibernetike kanë potencial për të dëmtuar rëndë shkëmbimin e informacionit në institucionet publike, të telekomunikacionit dhe sistemin financiar e bankar, duke shkaktuar edhe ndërprerje të shërbimeve jetike...”²⁷

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave, numër 973, datë 02.12.2015 është miratuar “Dokumenti i politikave për sigurinë kibernetike 2015–2017”, dokument mjaft i rëndësishëm për mbrojtje nga sulmet kompjuterike me pasoja të rënda. Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8888, datë 25.4.2002 ka ratifikuar Konventën për Krimin në Fushën e Kibernetikës, ndërsa në vitin 2004 është ratifikuar edhe protokollin shtesë i kësaj konvente. Për të reflektuar angazhimet e Shqipërisë në kuadër të Konventës së Krimit Kibernetikë, Ministria e Drejtësisë ndërmori nismën për parashikimin e shtesave në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë dhe në Kodin e Procedurës Penale. Këto nisma u finalizuan respektivisht me miratimin e ligjit nr. 10023, datë 27.11.2008 dhe nr. 10054, datë 29.12.2008.

Nenet e shtuara në Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penal janë pothuajse parashikimet që ka bërë Konventa për Krimet Kompjuterike.

Përpara shtesave të prezantuara me ligjin nr. 10023/2008, si krime kompjuterike parashikohet vetëm në nenin 192/b²⁸ “Ndërhyrje në transmetimet kompjuterike”, veprë penale e cila ishte e pa mjaftueshme. Duke i konsideruar veprat penale në fushën e kibernetikës të karakterit të veçantë në drejtim të vendit të kryerjes së veprës penale dhe të mundësisë së ardhjes së pasojës në vende relativisht larg nga kryerja e veprimeve, është shtuar një pike e veçantë në normën penale që rregullon zbatimin e ligjit penal shqiptar për veprat penale të kryera nga shtetasit e huaj. Në nenin 7 është shtuar germa “j”²⁹, në të cilën përcaktohet se “shtetasit e huaj mbajnë përgjegjësi sipas ligjit penal shqiptar për kryerjen jashtë territorit shqiptar e veprave penale në fushën e teknologjisë së informacionit në një prej dy rasteve alternative:

- i. kur i janë shkaktuar dëm interesave të shtetit shqiptar;
- ii. kur i janë shkaktuar dëm interesave të shtetasve shqiptarë.

Në paragrafin e dytë të 192/b dhe në nenet e tjera të shtuara në Kodin Penal, parashikohen si rrethana cilësuese hyrja e paautorizuar në sistemet kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo sistem tjetër kompjuterik me rëndësi publike. Këto veprime janë parashikuar me dënime më të larta pasi janë konsideruar drejtë për drejtë se cenojnë sigurinë kombëtare. Me ndryshimet e bëra në kodin penal pothuajse janë parashikuar si vepra penale të gjitha llojet e sulmeve kundër sistemeve kompjuterike

4. 2. Masa organizative

Qeveria shqiptare në kuadër të luftës kundër krimeve kompjuterike ka ndërmarrë masa shumë të rëndësishme organizative. Kështu në Laboratorin e Policisë Shkencore është ngritur dhe funksionon me shumë sukses sektori i ekspertimeve kompjuterike. Ky

²⁷ Strategjia e Sigurisë Kombëtare 2014, f. 23.

²⁸ Neni 192/b,

Ndërhyrja në transmetimet kompjuterike (shtuar me ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001, neni 53).

Ndërhyrja në çdo formë, në transmetimet dhe programet kompjuterike përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Po kjo veprë, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim gjer në shtatë vjet.

²⁹ j) vepra penale në fushën e teknologjisë së informacionit.

Muça, A.

« Sulmet kompjuterike dhe siguria kombëtare »

Policimi dhe Siguria
nr.3, 2016

sektor e filloi punën e tij në vitin 2009, me mbështetjen e strukturave homologe të policisë britanike dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe është i pajisur me programet dhe pajisjet bashkëkohore kompjuterike dhe aktet e ekspertimit që kryen janë shumë cilësore. Gjithashtu edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, është krijuar një strukturë e specializuar për zbulimin, ndjekjen dhe hetimin e krimeve kompjuterike.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, në bashkëpunim me struktura të specializuara homologe të vendeve të Evropës dhe SHBA-së, ka realizuar shumë kurse trajnimi në këtë fushë. Gjithashtu, edhe në Prokurorinë e Përgjithshme është krijuar një strukturë e specializuar vetëm për krimet kompjuterike. Në sistemin e trajnimeve vazhduese të prokurorëve dhe gjyqtarëve prej vitit 2009, Shkolla e Magjistraturës ka bërë pjesë të programit të trajnimit vazhdues kurse për krimet kompjuterike, që ka rezultuar si domosdoshmëri. Me anë të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar 'sekret shtetëror'", i ndryshuar me ligjin nr. 9541, datë 22.5.2006 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar 'sekret shtetëror'", është krijuar në Shqipëri "Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar" (DSIK).

Një ndër detyrat kryesore të kësaj drejtorie, është edhe certifikimi i sistemeve kompjuterike që lidhen me sigurinë kombëtare³⁰. Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 922, datë 19.12.2007, "Për sigurimin e informacionit të klasifikuar 'sekret shtetëror' që prodhohet, ruhet, përpunohet apo transmetohet në sistemet e komunikimit", përcakton procedura specifike për sistemet kompjuterike që përpunojnë e mbajnë të dhëna kompjuterike në institucionet e sigurisë. Mbi bazën e angazhimit të Shqipërisë me Këshillin e Evropës, nga ana e Qeverisë Shqiptare janë ndërmarrë masa shumë të rëndësishme edhe për mbrojtjen e të dhënave personale. Në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" janë bërë parashikime edhe për të dhënat personale të automatizuara, duke ngritur edhe strukturën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gjithashtu me anën e ligjit nr. 9288, datë 7.10.2004 "Për ratifikimin e konventës "për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale", Parlamenti Shqiptar ka ratifikuar konventën e Këshillit të Evropës, "Për mbrojtjen e të dhënave personale kompjuterike".

5. Konkluzione dhe rekomandime

Progresi i konsiderueshëm, është bërë në trajtimin e sulmeve ndaj teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në botë, duke rritur bashkëpunimin jo vetëm në fushën penale, por edhe bashkëpunimin në administrimin e krizave që kanë ardhur si pasojë e sulmeve kompjuterike. Bashkëpunimi midis shteteve dhe midis shtetit, sektorit privat dhe shoqërisë civile, është i rëndësishëm për përmirësimin e sigurisë së informacionit. Ndërtimi i kapaciteteve të përshtatshme është me rëndësi jetike për të arritur sukses në siguri, për të ndihmuar vendet në zhvillim në përpjekjet e tyre për të rritur sigurinë e infrastrukturës kritike kombëtare të informacionit. Megjithëse qeveria shqiptare ka

Muça, A.
« Sulmet kompjuterike dhe siguria kombëtare »

Policimi dhe Siguria
nr.3, 2016

66

³⁰ Neni 6 / b) aftësi apo dobësi, kapacitete të sistemeve, instalimeve, projekteve dhe planeve që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare;

c) veprimtari të shërbimeve informative, me forma dhe metoda të punës, me kriptologji në objektet e mjetet teknike, në vendet ku përpunohet dhe në arkivat ku ruhet informacioni;

Neni 25 / 2. Mbikëqyr rregullat e sigurimit fizik, ushtarak dhe elektronik të informacionit të klasifikuar, si dhe të anës teknike të marrjes, përpunimit, administrimit dhe arkivimit të tyre.

ndërmarrë hapa të rëndësishëm në drejtim të luftës kundër sulmeve kompjuterike, ajo duhet të rrisë kapacitetet teknike të strukturave që angazhohen me teknologjinë e informacionit. Kjo kërkon edhe një mbështetje më të madhe financiare, duke siguruar aftësi më të mëdha njerëzore dhe materiale, si programe dhe pajisje kompjuterike, që do të zvogëlonin mundësinë e sulmeve kompjuterike dhe pasojat e tyre.

Hetimet e deri tanishme të rasteve të pornografisë me të mitur dhe joshjes nëpërmjet internetit në botë, kanë treguar se kanë qenë të suksesshme duke përdorur mjete speciale hetimi. Kështu një nga mjetet më efikase, është përdorimi i agjentëve të infiltruar të cilët hyjnë në komunikim me të dyshuarit dhe veprimet e simuluar. Kodi jonë i procedurës penale nuk e parashikon si mundësi agjentin e infiltruar dhe veprimet e simuluar, për hetimin e krimeve kompjuterike. Për këtë, kërkohet që për veprat penale kompjuterike të lejohen veprimet e simuluar ose agjent në mbulim.

Me ndryshimet që i janë bërë Kodit të Procedurës Penale, me ligjin 10054, datë 29.12.2008, janë parashikuar procedura konkrete për marrjen dhe sekuestrimin e të dhënave kompjuterike. Në nenin 191/a dhe në nenin 208/a, ligjvënësi ka parashikuar procedurën e marrjes dhe sekuestrimit të së dhënave kompjuterike në raste të hetimeve në fushën e teknologjisë. Ky parashikim ligjor ngushton edhe hapësirën e përdorimit të së dy mjeteve për kërkim të provës në rastet kur hetohet për vepra penale të tjera, por që kanë ose parashikohet të jenë të lidhura me të dhëna kompjuterike. Për këtë propozohet të hiqet parashikimi *“në rastin e procedimeve për vepra penale në fushën e teknologjisë së informacionit”*.

Po në të dy nenet 191/a dhe 208/a, të Kodit të Procedurës Penale, ligjvënësi ka parashikuar se të dhënat kompjuterike janë konfidenciale dhe për marrjen dhe sekuestrimin e tyre ka ngritur nivelin e lejimit në gjykatë. Megjithatë janë prova të brishta, janë njëlloj si gjithë provat e tjera që merren ose sekuestrohen nga policia gjyqësore ose prokurori. Provat kompjuterike ligjvënësi i ka parashikuar si “prova dokumente” duke u vendosur në SEKSIONI VIII të Kreut II, “Llojet e provave”. Duke i konsideruar këto prova si “prova dokument”, mendoj që edhe ngritja e nivelit për marrjen dhe sekuestrimin e tyre është e panevojshme dhe duhet të jetë e njëjtë me provat dokument.

Referenca

1. <http://www.internetlivestats.com/internet-users/#trend>. Parë për herë të fundit më dt. 25 maj 2016.
2. Boyle, Darren." How FaceTime stopped the Turkish coup: President Erdogan's last-ditch mobile phone call to privately owned TV station mobilised mass support by harnessing social media", në *Dailymail*, 17 July 2016. Parë për herë të fundit, më dt. 20 korrik 2016:
<http://www.dailymail.co.uk/news/article-3693987/How-FaceTime-stopped-Turkish-coup-President-Erdogan-s-ditch-mobile-phone-call-privately-owned-TV-station-mobilised-mass-support-harnessing-social-media.html>
3. "Orë pas ore / Grushti i shtetit në Turqi, shkon në 300 numri i viktimave", *Gazeta Panorama*, 17 korrik 2016. Parë për herë të fundit, më dt. 20 korrik 2016:
<http://www.panorama.com.al/ore-pas-ore-grushti-i-shtetit-ne-turqi-shkon-ne-300-numri-i-viktimave/>
4. Kodi Penal Shqiptar.
5. Westphal Jr., Raymond (red.). *War and Virtual War The Challenges to Communities, Volumi I*. Oxford: Inter-Disciplinary Press Oxford, 2002
6. Mates, Michael (raportues). NATO Parliamentary Assembly, NATO Parliamentary Assembly, "Technology and Terrorism, Draft Interim Report", prill 2001.
Raporti i Nënkomitetit të teknologjisë ushtarake të NATO-s. Parë për herë të fundit, më dt. 15 korrik 2016: http://www.tbmm.gov.tr/u_l_kom/natopa/raporlar/bilim%20ve%20teknoloji/AU%20121%20STC%20Terrorism.htm
7. IC3 (Internet Crime Complaint Center), "Raporti i Krimeve në Internet", viti 2015.
https://pdf.ic3.gov/2015_IC3Report.pdf. Parë për herë të fundit, më dt. 1 korrik 2016.
8. Bodmer, Kilger, Carpenter dhe Jones. *Organized Cyber Threat Counter-Exploitation*. New York: McGraw-Hill Osborne Media, 2012.
9. "Bundeswehr rüstet sich für Cyber-Angriffe". *n-tv.de*, 17 shtator 2015. Parë për herë të fundit, më dt. 5 korrik 2016.
<http://www.n-tv.de/politik/Bundeswehr-ruestet-sich-fuer-Cyber-Angriffe-article15951756.html>
10. The White House, Washington, USA. *National Security Strategy*, 2015. Parë për herë të fundit, më dt. 3 korrik 2016: https://www.whitehouse.gov/sites/default/files/docs/2015_national_security_strategy.pdf
11. The European Parliament and The Council of the European Union. "Directive 2013/40/EU of The European Parliament and of The Council of 12 August 2013 on attacks against information systems and replacing Council Framework Decision 2005/222/JHA". *Official Journal of the European Union*, 14.8.2013. Parë për herë të fundit, më dt. 20 qershor 2016:
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2013:218:0008:0014:EN:PDF1>
12. Statistikë e datës 31 mars 2013, e marrë nga "Internet World Stats". Parë për herë të fundit në datën 10 qershor 2016: <http://www.internetworldstats.com/stats4.htm>.
13. Prokuroria e Përgjithshme, "Të dhënat e zyrës së statistikave, dhe raportit vjetor, i Prokurorit të Përgjithshëm, viti 2013".
Gjykata e shcallës së Parë Tiranë, *Vendime*.
14. Në datën 30 qershor 2011, Policia e Shtetit, bën të ditur se kohët e fundit janë evidentuar disa raste mashtrimesh të kryera nëpërmjet postës elektronike, pre e të cilave kanë qenë qytetarë shqiptarë. Parë për herë të fundit në datën 12 qershor 2016:
http://www.asp.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=1408%3Apolicia-e-shtetit-kujdes-ne-perdorimin-e-e-mailit-adresa-juaj-mund-te-perdoret-per-te-mashtruar-te-tjertet&catid=41%3Ainformation-for-press&lang=sq.
Gjykata e Lartë, *Vendime*
15. BBC, <http://www.bbc.com/news/uk-england-south-yorkshire-36633280>. Parë për herë të fundit në datën 1 qershor 2016.
16. Strategjia e Sigurisë Kombëtare së Republikës së Shqipërisë, 2014.

Muça, A.
« Sulmet
kompjuterike
dhe siguria
kombëtare »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

Kultura e organizatës dhe lidershipi



■ Prof. Asc. Dr. **Edmond BRANESHI**
Ministria e Mbrojtjes

Abstrakt

Natyrë e udhëheqjes strategjike, është e tillë sa që ndikimi i drejtuesve, nuk është vetëm tek individët, por edhe tek sistemet dhe proceset e përdorura nga organizatat për të arritur rezultatet e dëshiruara. Një prej këtyre metodave jo të drejtpërdrejta të udhëheqjes, është ajo nëpërmjet kulturës së organizatës. Kultura në shumë raste është përcaktuar thjesht si “forma ose mënyra se si ne i bëjmë gjërat”. Kultura është koncept i fuqishëm, në këtë mënyrë shumë individë të përfshirë në proceset kulturore i shohin metodat ose rrugët aktuale si mundësinë e bërjes së gjërave “saktë” dhe “drejtë”. Udhëheqësit të cilët kuptojnë kulturën janë në gjendje të kuptojnë individët e pozicionuar dhe të përfshirë në “aktivitete, ngjarje” ose në çështjet e drejtimit. Kultura përcakton rregullat dhe standardet e funksionimit të organizatës. Në këtë kuadër, kultura trajtohet si një element i domosdoshëm për ndryshimin e suksesshëm të organizatës dhe rritjen në maksimum të vlerës dhe dobisë së kapitalit njerëzor. Klima është një dukuri afatshkurtër që krijohet nga lidershipi aktual. Ajo është e lidhur drejtpërdrejt me personalitetin e drejtuesit, mënyrën e tij të drejtimit dhe të komunikimit. Në procesin e drejtimit duhet të bëhet kujdes që të mos ngatërrojmë kulturën me klimën, sido që të dyja përforcojnë njëra tjetrën në mënyrë të ndërsjellët. Është detyrë e lidershipit të shfrytëzojë këto dy forca të dallueshme që të diktojnë se si të vepron për të realizuar misionin e përkatës. Një sfidë e rëndësishme për drejtuesit sot është përcaktimi i kulturës më të efektshme për organizatën e tyre dhe, kur është e nevojshme, ndryshimi i kulturës së organizatës për të qenë më pranë suksesit.

Braneshi, E.
« Kultura
e organizatës
dhe
lidershipi »

Fjalëkyçe:

lidershipi, kultura e organizatës, kultura e drejtimit, klima e organizatës.

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

1. Çfarë janë organizatat

Organizatat, në themel janë struktura shoqërore ku një individ në shoqëri me të tjerët ka mundësi të arrijë nivele realizimi të caktuara, që ndryshe do të ishin të paarritshme. Organizatat sigurojnë kushtet dhe kuadrin për të vepruar në mjediset tona të ndryshme. Njeriu, nga natyra e tij është i shoqërueshëm dhe kërkon të bashkohet me të tjerët për arritjen e qëllimeve të përbashkëta. Një individ me interesa të caktuara, për të hyrë në karrierën ushtarake, bëhet pjesëtar i forcave të armatosura. Organizatat në vetvete paraqesin një pikë kulmore të rendit shoqëror që lidh individin me një organizëm kolektiv. Kështu për shembull, një shkollë përbën një organizatë nxënie (mësimi); shoqëria jonë është një organizatë që ofron shërbim dhe udhëheqje; vendi i punës ku ne hyjmë sipas profesionit mund të jetë një organizatë ushtarake, një organizatë shërbimi, një organizatë industrie apo prodhimi, etj. Me fjalë të tjera, “organizatat janë një gjetje apo instrument shoqëror, të krijuara nga njerëzit për të realizuar gjëra, që arritja e tyre në një mënyrë tjetër do të ishte e pamundur. Ato janë gjetje apo zbulime shoqërore që mbledhin njerëz të ndryshëm, dije dhe zakonisht, materiale të llojeve të ndryshme dhe u japin atyre strukturë e sistem që të bëhen një e tërë e integruar”¹.

Është natyra dhe forca e organizatave, që grumbullon interesat, nevojat dhe dëshirat e njerëzve në një entitet, që përfaqëson atë që realisht ata duan. Kështu, një shkollë mbledh së bashku mësuesit dhe popullsinë e një shoqërie dhe transmeton kulturën dhe zakonet e saj në popull. Një spital mbledh së bashku mjekët dhe ofruesit e tjerë të kujdesit shëndetësor, teknologjinë e tij për diagnostikimin dhe trajtimin e atyre që janë të sëmurë. Një ushtri mbledh së bashku oficerët, nënoficerët, ushtarët, rekrutët dhe punonjësit civilë për mbrojtjen e integritetit të vendit.

Organizatat rriten dhe ndryshojnë sipas nevojave të shoqërisë. Në raste të caktuara,

Braneshi, E.
« Kultura
e organizatës
dhe
lidhshipi »

Pollicimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

¹ Litterer, Joseph A. *The Analysis of Organizations*. New York: John Wiley and Sons, Inc. ,1973.

shoqëria mund të ketë nevojë për mbajtjen e një forcë të madhe ushtarake për shkak të mjedisit jo të favorshëm, ose arsimimi të drejtuar, ose kujdesi shëndetësor, ose... Në kushte të tjera, shoqëria mund të bëjë pa disa nga këto organizata. Kështu, një ushtri e mbështetur në shërbimin e detyrueshëm ushtarak mund të bëhet ushtri vullnetare; arsimimi pas një farë niveli të shkollimit të detyruar, mund të bëhet gjithashtu vullnetar. Qendrat e mëdha mjekësore mund t'i lënë vend klinikave të shqendëruara që janë më afër njerëzve. Me pak fjalë, organizatat kanë një mënyrë jetese që i përgjigjet “kapriçove” të mjedisit.

2. Kultura e organizatës

Koncepti për kulturën e organizatës lidhet sa me drejtimin e shkencave publike aq edhe me drejtimin e biznesit apo të sektorit privat. Në kushtet e ndryshimit të shpejtë të mjedisit dhe ndikimit të vazhdueshëm në efektshmërinë e organizatës, institucionet shkencore, (ashtu sikundër shumica e organizatave të tjera) po rishqyrtojnë seriozisht atë çfarë ato bëjnë dhe si mund të përcaktojnë dhe plotësojnë më mirë objektivat e tyre. Me përcaktimin e objektivave, është e domosdoshme të adresojnë llojin e kulturës që është e nevojshme për të çuar përpara këto qëllime e objektiva dhe për të garantuar kryerjen me sukses të ndryshimeve të nevojshme.

Veç kësaj, studimet mbi efektshmërinë e organizatës, gjithnjë e më shumë theksojnë rëndësinë e kulturës në motivimin dhe rritjen në maksimum të vlerës dhe dobisë së pasurisë intelektuale e shkencore të saj, përkatësisht të kapitalit njerëzor.² Kjo është veçanërisht e rëndësishme në njohjen e organizatave të fuqishme, ku bëjnë pjesë dhe Forcat e Armatosura. Ky rishikim i studimit mbi kulturën e organizatës bën të qartë që:

- së pari, kultura është element i domosdoshëm për ndryshimin e suksesshëm të organizatës dhe rritjen në maksimum të vlerës dhe dobisë së kapitalit njerëzor;
- së dyti, menaxhimi i kulturës duhet të bëhet një kompetencë kryesore lidërshepi;
- së treti, ndërsa kultura e duhur mund të jetë një kusht i domosdoshëm për suksesin e organizatës, ajo në asnjë mënyrë nuk mund të jetë një kusht i mjaftueshëm.

Një sfidë e rëndësishme për drejtuesit është të përcaktojnë se cila është kultura më efektive për organizatën e tyre dhe, kur është e nevojshme, si të ndryshojnë kulturën e organizatës në mënyrë efektive.

Natyrshëm lind pyetja: çfarë është kultura e organizatës? Për të nuk ka një përkufizim të vetëm. Ajo mund të përcaktohet “...një sistem hamendësish themelore të përbashkëta që grupi i ka mësuar gjatë zgjidhjes së problemeve të tij të përshtatjes së jashtme dhe integritit të brendshëm, të cilat kanë funksionuar mjaft mirë për t’u konsideruar të dobishme dhe për rrjedhojë për t’ua mësuar anëtarëve të rinj si një mënyrë korrekte për të perceptuar, gjykuar dhe menduar në lidhje me këto probleme”³, apo “...një tërësi kuptimesh, bindjesh e gjykimesh të përbashkëta, sipas të cilave organizohet veprimtaria e grupit... dhe që gjejnë shprehje te gjuha, nuancat e së cilës janë tipike për grupin”.⁴

Kultura e organizatës zhvillohet në përputhje me vlerat, bindjet e hamendjet e shoqërisë ku bën pjesë organizata. Ajo u mësohet njerëzve të rinj nëpërmjet programeve ose ndikimit të saj, si mënyrë e “drejtë” për të menduar e vepruar si në mjedisin e

² Gjatoja Ruzhdi dhe A. Lala, K. Xharo, E. Braneshi. *Udhëheqja Strategjike*. Tiranë: Shtëpia Botuese “GEER”, 2010, (f. 252).

³ Schein, E. H. *Organizational Culture and Leadership*. San Francisco: Jossey-Bass, 1988.

⁴ Becker, H. S. dhe B. Geer. “Latent culture”. *Administrative Science Quarterly* 5: 303-313.

brendshëm dhe të jashtëm.

Kultura është ajri që thithim brenda organizatës, fryma që përcjellim në çdo moment të punës sonë me vartësit, bashkëpunëtorët, partnerët. Është shpirti unik, shkëndija që i jep jetë çdo projekti dhe ideje, motor lëvizës i biznesit.⁵ Brenda kulturës së organizatës gjendet pjesa më e mirë e çdo punonjësi, duke filluar nga drejtuesit (që janë me më shumë përvojë) e deri tek më të rinjtë. Ajo ka të bëjë me ndjenjën kolektive të punonjësve në lidhje me sesi ndihen ata brenda organizatës. Kultura e organizatës gjendet në gjërat e shkruara dhe të pashkruara, në historitë që ju tregojmë punonjësve të rinj ndërsa i përgjigjemi pyetjes: si bëhen gjërat në këtë organizatë? Kultura transmetohet përmes qëndrimit dhe sjelljes kolektive të punonjësve si dhe përmes proceseve të komunikimit. Ajo krijohet si kontribut i çdo punonjësi të organizatës por edhe udhëheq sjelljen e çdonjërit.

Në kuptimin bazë, kultura ekziston kur individët ndajnë sëbashku një kornizë referimi për të interpretuar dhe vepruar ndërmjet tyre dhe në raport me botën në të cilën jetojnë. Kjo kornizë e përbashkët referimi, përfshin gjuhën, vlerat, besimet, krijimet dhe interpretimet e përvojës. Ajo pasqyrohet në zakonet, traditat dhe komunikimin si edhe në karakteristika të tjera të vrojtueshme të komunitetit.⁶ Në këtë kuadër, kultura ndihmon në ndërtimin e sistemit të duhur imunitar të organizatës, ofron kuadrim brenda së cilit punonjësit ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe me grupet e interesit. Është filtër për përzgjedhjen e punonjësve të rinj por edhe një avantazh për të tërhequr më të mirët. Ajo na ndihmon në krijimin e harmonisë mes vlerave që mbart ushtria, vlerave që shfaqin ushtarakët e punonjësit civilë dhe vlerave që perceptojnë rekrutët dhe njerëzit që kërkojnë t'i bashkohen asaj.

Kultura përcakton rregullat dhe standardet e funksionimit, por duhet kujdes për ta mbajtur gjallë, për të qenë në harmoni me të në çdo aspekt të punës, në të kundërt do të ngelet në kuadrin e dëshirës dhe sjelljet tona nuk do të jenë në harmoni me të. Përqafimi, respektimi dhe zbatimi i kulturës së Forcave të Armatosura nuk është subjekt i zgjedhjes personale të ushtarakëve e punonjësve, është detyrë e gjithsecilit ta kuptojë, ta respektojë dhe ta reflektojë çdo ditë. Çdo njeri është rojtar i kulturës, është përgjegjësia dhe e drejta e tij të mos lejojë askënd tjetër që ta shkelë atë. Kultura ka një ritual: sa më shumë vlerësohet dhe reflektohet në punën tonë, aq më shumë rritet vlera e saj, aq më e pakopjueshme dhe unike bëhet ajo.⁷ Kultura ndikon në mënyrën se si anëtarët veprojnë e komunikojnë mes tyre, si zgjidhin problemet, si vlerësojnë situatat, si parashikojnë, dallojnë të drejtën nga e gabuara, si vendosin përparësitë dhe si reagojnë ndaj aspekteve të tjera. Drejtuesit e nivelit strategjik duhet të kenë në konsideratë e të sigurojnë që vlerat institucionale dhe të deklaruara të jenë në përputhje si me vlerat e strukturës më të madhe shoqërore si dhe me vetë nevojat e organizatës. Veç kësaj, drejtuesit e nivelit strategjik, duhet të sigurojnë se me anë të politikave, doktrinave, rregulloreve dhe zbatimit të procedurave përkatëse, ata po prodhojnë rezultatet e dëshiruara.

Me kalimin e kohës, kultura rrënjësohet kaq shumë brenda organizatës dhe anëtarëve të saj, sa që një pjesë e mirë e kësaj kulture bëhet natyrë e dytë dhe shpesh merret si e vërtetë (sigurtë). Kultura krijon kuptimin (gykimin) kryesor në lidhje me atë se çfarë

⁵ Naçi, Vasil dhe Alma Bici. *Është rruga jonë, rruga e suksesit në Agna grup*. Tiranë: Agna Leadership Academy 2013, (f. 11).

⁶ Papa, Michael J. dhe Tom D. Daniels, Barry K. Spiker. *Komunikimi organizativ, qasjet dhe prirjet*. Tiranë: UET Press, 2009, (f. 108).

⁷ Naçi dhe Bici. *Është rruga jonë...* (f. 13).

përfaqëson organizata dhe mënyrën se si funksionon ajo. Ajo bën të mundur që anëtarët e organizatës të kuptojnë e t'i bëjnë ballë mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm të organizatës gjatë përmbushjes së qëllimeve të saj. Kultura ndikon gjithashtu edhe në mënyrën se si anëtarët e organizatës perceptojnë, mendojnë e veprojnë në lidhje me njëri-tjetrin si dhe ndaj sfidave dhe rasteve apo gjasave të brendshme e të jashtme. Vlerat kulturore përcaktojnë kufijtë e gjykimit dhe sjelljes së pranueshme, duke filluar nga veprime të tilla të thjeshta si veshja e uniformës, për të vazhduar në veprime më tepër komplekse siç është zhvillimi i operacioneve luftarake. Kultura ndikon në mënyrën se si njerëzit flasin e komunikojnë me njëri tjetrin, si zgjidhin problemet, vlerësojnë situatat, zhvillojnë parashikimet, përcaktojnë të drejtën nga e gabuara, vendosin përparësitë dhe si reagojnë ndaj shumë aspekteve të tjera të organizatës dhe sjelljeve ndërpersonale.

Së fundi, në mjedisin e brendshëm të karakterizuar nga paqëndrueshmëria, pasiguria, kompleksiteti dhe paqartësia, kultura ndikon në sjelljen e vartësve, sidomos kur ata përballesh me një situatë të veçantë ku mungojnë procedurat "standarde" të veprimit. Zakonet dhe traditat e llojit të Forcës, doktrinën e bëra të njohura nëpërmjet manualeve, politikave e shprehura në rregullore, procedurat standarde të veprimit, si dhe filozofia e deklaruar që udhëheq organizatën, janë disa nga mënyrat më të rëndësishme që e bëjnë kulturën të dukshme dhe të kapshme. Gjithashtu, kultura përçohet nëpërmjet revistave që trajtojnë çështje profesionale, botimeve historike e biografike, medias, ceremonive dhe traditës së organizatës. Të gjithë këto çështje mbartin disa aspekte të kulturës në organizatën e Forcave të Armatosura.

Kultura duhet parë edhe si mjet lidhësi. Ndoshta, një nga rolet më të rëndësishme të lidhësit është zhvillimi dhe menaxhimi i kulturës organizative e cila mund të përcaktojë nëse një organizatë është në gjendje ose jo për të shpërndarë premiset e saj strategjike. Kultura është e lidhur me performancën e organizatës kur janë plotësuar tri kriteret.⁸ Së pari, kultura duhet të jetë e lidhur me strategjinë, që do të thotë sjelljet e vëna në dukje dhe të shpërblyera janë në fakt të domosdoshme për të çuar përpara dhe plotësuar objektivat e organizatës. Së dyti, kultura duhet të jetë e fuqishme, që do të thotë se njerëzit bien dakord për atë që e vlerësojnë si të rëndësishme dhe për të cilën punojnë.⁹ Së treti, nëse organizatës me kalimin e kohës i duhet të ruajë nivele të larta të performancës, duhet të theksohet një vlerë thelbësore në risitë, përshtatjet dhe ndryshimet.¹⁰ Jetëgjatësia e një organizate varet nga bashkëpunimi i anëtarëve me njëri-tjetrin për të arritur qëllimet. Liderët janë përgjegjës për krijimin e normave që e mbështesin këtë lloj bashkëpunimi.¹¹

3. Kultura e organizatës, sintezë e nënkulturave të saj

Koncepti i nënkulturave është veçanërisht i rëndësishëm të merret në konsideratë kur përshkruajmë kulturën e një organizate, Për ne, kultura e një organizate nuk është një formë monolite, e kontrolluar nga lart prej drejtuesve. Megjithatë ata (drejtuesit)

⁸ Chatman, J., dhe S. Cha. "Leading by Leveraging Culture". *California Management Review* 45, no. 4 (2003): 20-34.

⁹ O'Reilly, C. A. "Corporations, Culture and Commitment: Motivation and Social Control in Organizations". *California Management Review* 3, no. 1 (1989): 9-25.

¹⁰ Sorenson, J. B. "The Strength of Corporate Culture and the Reliability of Firm Performance". *Administrative Science Quarterly* 47, no. 1 (2002): 70-91.

¹¹ *Manual i Teorisë dhe Praktikës së Liderimit*. Tiranë: Shtëpia Botuese Universitare UFO Press, 2011, (f. 178).

luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin dhe ndikimin e kulturës së organizatës, gjithashtu është e nevojshme të ekzaminohet roli që luajnë punonjësit për krijimin dhe mbështetjen e kulturës përmes shkëmbimeve të tyre me njëri-tjetrin në punë. Në mënyrë që të jemi më të qartë, le të marrim në shqyrtim një nga vrojtimit e Clifford Geertz-it¹² në librin “Interpretimi i kulturave”.¹³ Geertz arsyeton se “njeriu është një kafshë e kapur në rrjetën e domethënies që ai vetë ka thurur... kjo rrjetë është kultura”. Si rrjetat, kulturat thuren nga individët, të cilët bashkëveprojnë brenda një sistemi social dhe krijojnë rregullat dhe normat e tyre. Është interesante se rrjetat e thurura nga pjesëtarët kulturorë janë njëherësh kufizuese dhe mobilizuese. Ashtu si rrjeta që kufizon lëvizjet e merimangës në zonën e mbuluar prej saj, edhe kultura e një organizate i mban veprimet e punonjësve në nivel të konsideruar të pranueshëm nga normat dhe rregullat brenda sistemit. Megjithatë, rrjetat nuk janë vetëkufizuese, ato e lejojnë merimangën të lëvizë. Gjithashtu, kjo është e vërtetë për rrjetat e thurura nga punonjësit që bashkëveprojnë ndërmjet tyre në punë. Rrjetat e thurura brenda një organizate, i fuqizojnë punonjësit, duke u mundësuar veprimin në mënyra të legjitimuara nga kultura e tyre, e krijuar kolektivisht. Së fundmi, rrjetat janë fushëbeteja ku merimangat sulmojnë prentë e tyre. Në mënyrë të ngjashme, kur pjesëtarët e organizatës thurin rrjetat e tyre kulturore, mund të ketë beteja kuptimore dhe në lidhje me krijimin e një tipi të caktuar kulture dhe jo një tjetri.

Unë do të dëshiroja ta zgjeroja metaforën e Geertz-it, duke e përshkruar kulturën e një organizate si koleksion rrjetash të ndërlydhura. Këto rrjeta të ndërlydhura përfaqësojnë nënkulturat brenda organizatës. Çdo nënkulturë, është njëfarë mënyre unike, për shkak të punonjësve që ngërthen; megjithatë, ngase nënkulturat janë të ndërlydhura dhe të shtratëzuara brenda një organizate të vetme, ato kanë gjithashtu karakteristika të përbashkëta dhe kuptime e interpretime të ndara bashkërisht.¹⁴

Le ta konkretizojmë te Forcat e Armatosura, që janë një organizatë e madhe. Për çdo njeri që ka pasur rastin të lëvizë në njësi, reparte, baza apo garnizone të ndryshme të Forcave të Armatosura, është shumë e qartë se “mënyra e bërjes së gjërave” ndryshon nga një lloj force në tjetrën, nga njëra njësi në tjetrën. Çdo lloj force, i përgjigjet kërkesave të saj, duke vendosur politika që gjykohen më efektive për kohën dhe vendin e dhënë. Prandaj, kultura në Forcën Tokësore nuk mund të jetë e njëjtë me atë në Forcën Detare apo Forcën Ajrore e megjithatë ato mishërojnë të njëjtat vlera bazë, të kulturës së Forcave të Armatosura në tërësi.

Kjo vërehet edhe brenda vetë strukturave të llojeve të forcave. Kështu për shembull, kulturat e trupave të këmbësorisë, forcave komando, forcave speciale, etj., në Forcën Tokësore, ndryshojnë mes tyre (pra, kanë “mënyra të ndryshme të bërjes së gjërave”), por ato mishërojnë edhe të njëjtat bindje dhe vlera bazë të kulturës së Forcës Tokësore. Një shqyrtim i tyre, zbulon ndryshime edhe në kulturat e specialiteteve apo njësi brenda forcave. Megjithatë, ato i përmbahen ideologjive, vlerave thelbësore të FA.

Drejtuësit e efektshëm në nivel strategjik, kuptojnë e vlerësojnë gjithë këto ndryshime që ekzistojnë brenda strukturave të ndryshme të Forcave të Armatosura, gjithashtu dhe diferencat kulturore që sjellin protagonistë të ndryshëm në mjedisin e jashtëm të Forcave të Armatosura.

Një mënyrë efektive veprimi në rastin e përballjes me nënkultura të ndryshme është

¹² Papa, et al. *Komunikimi organizativ* ... (f. 108).

¹³ Geertz, C. *The interpretation of cultures*. New York: Basic Books, 1973.

¹⁴ Papa, et al. *Komunikimi organizativ* ... (f. 109).

përqendrimi jo në ato gjëra që i ndajnë organizatat e ndryshme, por përkundrazi, në ato gjëra që i bashkojnë ato. “Ngjitësi” që integron apo bashkon nënkulturat e ndryshme brenda një organizate të dhënë, në të shumtën e rasteve, janë vetë vlerat e organizatës.¹⁵ Metodrat e punës dhe procedurat mund të ndryshojnë nga njëra organizatë në tjetrën, dhe kjo për arsye shumë të forta. Së fundi, shumë organizata, veçanërisht ato në sferën ushtarake, janë të interesuara për të njëjtën vlerë dhe pikërisht për atë që ka të bëjë me gjendjen përfundimtare të dëshiruar: paqen, stabilitetin dhe të drejtat e individit. Kur është e përshtatshme, drejtuesit e nivelit strategjik duhet ta kuptojnë dhe përforcojnë këtë vlerë që përputhet ndër organizata të ndryshme si dhe të vlerësojnë këndvështrimet e ndryshme të mundshme që sjellin si organizatat ushtarake ashtu dhe ato joushtarake. Pra sot, një sfidë e lidërshiptit strategjik është garantimi që këto nënkultura të jenë në përputhje me thelbin e kulturës strategjike.

4. Kultura përballë “klimesë”

Mënyra e të vepruarit në organizatë është e lidhur me praninë e dy forcave të dallueshme që të diktojnë se si të veprosh: kultura dhe klima. Klima është ndjenja (ndjesia, emocioni) e organizatës, perceptimet dhe qëndrimet individuale dhe të përbashkëta të anëtarëve të organizatës¹⁶. Ndërsa kultura është thellësisht burimi natyror i organizatës (siç e theksuam më sipër), që është rezultat i sistemeve, rregullave, traditave dhe zakoneve formale dhe joformale që zbatohen për një kohë të gjatë¹⁷. Klima është dukuri afatshkurtër që krijohet nga lidërshipti aktual. Klima përfaqëson besimet rreth “ndjenjës” e cila vjen nëpërmjet asaj çfarë njerëzit besojnë rreth veprimtarive të organizatës. Këto veprimtari ndikojnë në motivimin dhe kënaqësinë individuale dhe kolektive. Veprimtari të tilla përfshijnë:

- Sa i aftë është drejtuesi për të qartësuar prioritetet, synimet dhe qëllimet e organizatës?

- Çfarë pritjet prej nesh?

- Cili është sistemi i mirënjohjes, shpërblimeve dhe ndëshkimeve në organizatë?

- Sa i aftë dhe kompetentë janë drejtuesit?

- A janë drejtuesit të lirë të marrin vendime?

- Çfarë do të ndodhë në qoftë se unë bëj një gabim?

Në këtë kuadër, klima e organizatës është e lidhur drejtpërdrejt me lidërshiptin dhe stilin e tij të drejtimit, bazuar kjo, në vlerat, atributet, aftësitë, veprimet si dhe prioritetet e drejtuesit. Sjellja (karakteri) i drejtuesit është faktori më i rëndësishëm që ndikon te klima. Kjo do të thotë që drejtuesi është përgjegjës për klimën e organizatës. Drejtuesi kontribuon në një klimë pozitive kur sjellja e tij pasqyron kompetencë dhe është në mbështetje të vlerave, bindjeve e hamendjeve thelbësore të organizatës. Ja sa bukur, e përshkruan klimën pozitive Laurence Haughton, në librin, “Jo çfarë thua, por çfarë bën”: “...Puna të jep gëzim dhe, kur mbaron dita, mezi pret të vijë e nesërmja. Njerëzit janë atje ku të gjithë bëjnë shumë punë në më pak kohë, pa iu bërë titur dhe pa i detyruar njeri, ...puna e rëndë nuk të duket aq stresuese sa në vendet e tjera, madje dhe sakrificat nuk të duken ndonjë gjë e madhe.¹⁸ Anëtarët nuk do të pranojnë një klimë që bie ndesh

¹⁵ Gjataja, et al. *Udhëheqja*. . . (f. 52).

¹⁶ Chehab, Ramzey S. *The Art of Leadership*. Kentucky: Lexington, KY 2012, (f. 22).

¹⁷ Ibid.

¹⁸ Haughton, Laurence. *Jo çfarë thua por çfarë bën*. Tiranë: Max, 2006, (f. 240).

me vlerat kulturore, bindjet dhe hamendjet e organizatës. Luhatjet në klimën e organizatës, ose prezenca në vazhdimësi e një klime negative, gërryejnë besimin, sigurinë dhe mirëbesimin e anëtarëve dhe ndikojnë për keq në gatishmërinë dhe efektshmërinë e organizatës. Është pikërisht klima e ngrohtë që reflekton drejtuesi në marrëdhënie me njerëzit, që duhet t'u japë njerëzve "një arsye që të ngrihen nga shtrati në mëngjez"¹⁹.

Nga ana tjetër, kultura është dukuri afatgjatë dhe komplekse. Kultura përfaqëson pritsmërinë ose shpresën e përbashkët të organizatës. Vizioni kolektiv dhe tradicionalja e përbashkët që përcakton organizatën, janë pasqyrim i kulturës së tyre. Drejtuesit, individualisht nuk mundën kurrsesi të krijojnë ose ndryshojnë kulturën, sepse kultura është pjesë e organizatës dhe mjedisit ku ata veprojnë.²⁰ Kultura ndikon në karakteristikat e klimës nëpërmjet efektit të saj në veprimet dhe procesin e të menduarit të drejtuesit. Por, çdo gjë që ju bëni si drejtues, do të ndikojë në klimën e organizatës.

5. Përfundime

Në procesin e lidërshiptit strategjik, duhet të bëjmë kujdes me kulturën dhe klimën e organizatës. Ato konsiderohen si dy forca që ndikojnë në suksesin e saj. Për të pasur një organizatë sa më kohezive dhe unike, drejtuesit duhet të mbanë parasysh:

- Të mos ngatërrojnë kulturën e organizatës me klimën e saj. Kultura përbën bazën e klimës dhe në një shkallë të madhe, ajo e përcakton atë. Kultura, është një dukuri komplekse dhe afatgjatë. Drejtues të veçantë nuk mund të krijojnë apo ndryshojnë lehtë një kulturë të caktuar.

- Të mos klasifikojnë kulturën vetëm si aspekt i personelit të organizatës, që ndikon vetëm në anën njerëzore të saj. Ndikimi i kulturës shkon përtej anës njerëzore dhe ndikon te qëllimet dhe misioni bazë i organizatës.

- Të mos kujtojnë drejtuesit se mund të kontrollojnë kulturën, ashtu siç mund të kontrollojnë shumë aspekte të tjera të organizatës. Kultura është ndryshe, sepse ajo në një shkallë të madhe përcaktohet e kontrollohet nga anëtarët e organizatës, dhe jo nga drejtuesit. Kultura mund të kontrollojë drejtuesit në vend që të kontrollohet prej tyre.

- Jo të gjithë aspektet e një kulture janë të rëndësishme apo mund të kenë një ndikim të madh në funksionimin e organizatës. Disa elemente mund të kenë pak ndikim, drejtuesit duhet të dallojnë cilët elemente janë të rëndësishëm dhe të fokusohen në to.

- Klima është dukuri afatshkurtër, që krijohet nga lidërshipti. Përcaktuesi kryesor i klimës së organizatës është sjellja e drejtuesve. Ajo pasqyron perceptimin e tyre për njerëzit, stilin e lidërshiptit, aftësitë, dijet, pikëpamjet dhe përparësitë. Drejtuesit, me veprimin e tyre, bëjnë të ditur çfarë ata tolerojnë ose çfarë jo. Sjellja e drejtuesve krijon një klimë që ndikon te çdo pjesëtar i organizatës.

Thelbi i lidërshiptit është aftësia për të kuptuar kulturën ekzistuese dhe për të modeluar kulturën e vlerat e organizatës në mbështetje të vizionit, ndërsa ruan mbështetjen e vartësve e anëtarëve të një shoqërie më të madhe.

Braneshi, E.
« Kultura
e organizatës
dhe
lidërshipti »

Polici
dhe
Siguria
nr.3, 2016

¹⁹ Ibid, (f. 320).

²⁰ Orhani, Qetësor, et al. *Udhëheqja Ushtarake 1*. Tiranë: Qendra e shtypit, Botimeve dhe Përkthimeve Ushtarake, 2009, (f. 35).

Bibliografia

1. Litterer, Joseph A. *The Analysis of Organizations*. New York: John Wiley and Sons, Inc., 1973.
2. Gjataja Ruzhdi dhe A. Lala, K. Xharo, E. Braneshi. *Udhëheqja Strategjike*. Tiranë: Shtëpia Botuese "GEER", 2010.
3. Schein, E. H. *Organizational Culture and Leadership*. San Francisco: Jossey-Bass, 1988.
4. Becker, H. S. dhe B. Geer. "Latent kulture". *Administrative Science Quarterly* 5: 303-313.
5. Naçi, Vasil dhe Alma Bici. *Është rruga jonë, rruga e suksesit në Aëna grup*. Tiranë: Aëna Leadership Academy 2013.
6. Papa, Michael J. dhe Tom D. Daniels, Barry K. Spiker. *Komunikimi organizativ, qasjet dhe prirjet*. Tiranë: UET Press, 2009.
7. Chatman, J., dhe S. Cha. "Leading by Leveraging Culture". *California Management Review* 45, no. 4 (2003): 20-34.
8. O'Reilly, C. A. "Corporations, Culture and Commitment: Motivation and Social Control in Organizations". *California Management Review* 3, no. 1 (1989): 9-25.
9. Sorenson, J. B. "The Strength of Corporate Culture and the Reliability of Firm Performance". *Administrative Science Quarterly* 47, no. 1 (2002): 70-91.
10. *Manual i Teorisë dhe Praktikës së Lidërsipit*. Tiranë: Shtëpia Botuese Universitare UFO Press, 2011.
11. Geertz, C. *The interpretation of cultures*. New York: Basic Books, 1973.
12. Chehab, Ramzey S. *The Art of Leadership*. Kentucky: Lexington, KY 2012.
13. Haughton, Laurence. *Jo çfarë thua por çfarë bën*. Tiranë: Max, 2006.
14. Orhani, Qetësor, et al. *Udhëheqja Ushtarake 1*. Tiranë: Qendra e shtypit, Botimeve dhe Përkthimeve Ushtarake, 2009.
15. Litterer, Joseph A. *The Analysis of Organizations*. New York: John Wiley and Sons, Inc., 1973.

Braneshi, E.
« Kultura
e organizatës
dhe
lidhshipi »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

Policia Gjyqësore, të bëhet pjesë e reformës në drejtësi



■ **Msc Adriatik AGO**
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Ka kaluar pothuajse një dekadë e gjysmë që nga miratimi i ligjit "Për Policinë Gjyqësore", si dhe, janë në fuqi disa akte normative të Prokurorit të Përgjithshëm apo të Ministrit të Brendshëm ose dhe akte normative të përbashkëta midis këtyre institucioneve. Me gjithë ndryshimet e mëdha, që kanë ardhur nga veprimi i shumë faktorëve objektivë dhe subjektivë, ende mund të themi se profili i Policisë Gjyqësore në vendin tonë, nuk e ka gjetur vendin që i takon. Dallimet dhe ndryshimet që janë përcaktuar në ligj apo në akte të tjera nënligjore, për sa i përket shërbimeve të Policisë Gjyqësore nëpër institucione, me seksionet e Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë, dashur pa dashur kanë krijuar profile të ndryshëm si, në drejtim të rekrutimve, të arsimit, trajtimeve financiare dhe administrative. Gjithashtu, për vënien në efikasitet të kësaj strukture të domosdoshme, në hetimin e kriminalitetit apo të çdo shkelje ligjore që konsumon figurë krimi, respektimi i të gjithë kërkesave që normon ligji nuk ka qenë në lartësinë e duhur, kur bëhet fjalë burimet njerëzore të këtyre shërbimeve, për çështjet disiplinore, për lëvizjet, për transferimet, për emërimet, për trajnimet e personelit etj. Me shumë rëndësi paraqet riorganizimi i Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit, si e vetmja strukturë e specializuar dhe përgjegjëse për luftën kundër kriminalitetit, në çdo formë që ai shfaqet. Të rejat e ligjit të ri për Policinë e Shtetit, reforma territoriale administrative dhe shumë sfida që dalin përpara kësaj strukture, kërkojnë medeoemos reformimin e këtij shërbimi dhe në kushtet aktuale të bëhet pjesë e reformës në drejtësi, si një nga reformat më jetëdhënëse të institucioneve të shtetit shqiptar.

Agó, A.
« Policia
Gjyqësore
të bëhet pjesë
e reformës
në drejtësi »

Fjalëkyçe:

Policia e Shtetit, procesi i të provuarit, shërbimet e Policisë Gjyqësore, kapacitetet hetimore, atributi i Policisë Gjyqësore.

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

1. Hyrje

Proceset e integritit kanë përfshirë gjithë institucionet e shoqërisë e të shtetit, në një varg reformash të karakterit politik, legjislativ, strukturor, ekonomik e më gjerë. Për vetë problematikat e grumbulluara ndër vite, sot ka dalë në pah se, reforma në drejtësi është nga më kryesoret, pasi lidhet me ekzistencën e shtetit demokratik, me respektimin e parimeve bazë të funksionimit të tij, por edhe me luftën ndaj fenomeneve si atë të korrupsionit, të krimit të organizuar, luftës kundër terrorizmit etj. Reforma në drejtësi për vetë objektin e saj, është me një spektër të gjerë tematikash dhe për realizimin me sukses, kërkohen që të preken kushtetuta, ligje organike të funksionimit të pushtetit gjyqësor, të organit të akuzës, pse jo edhe të shumë institucioneve të rëndësishme me burim formimi kushtetues, si KLD, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, etj.

2. Reforma në Policinë Gjyqësore

Aktualisht, është bërë e njohur edhe paketa e reformatore, e cila ka një numër të konsiderueshëm të akteve ligjore që do të miratohen sipas procedurave të caktuara. Jam munduar që të ndjek proceset e deritanishme të kësaj reforme, të njihem me titujt dhe përmbajtjen e paketës reformatore, por nuk më ka zënë syri që të ketë nisma për sa i përket reformimit të Policisë Gjyqësore të shtetit shqiptar. Ndoshta, ekipi i ekspertëve nuk e ka konsideruar atë si çështje prioritare dhe e ka të ndërvarur me ndryshimet e mëvonshme të ligjeve të kësaj fushe. Edhe në disa dokumente të rëndësishme strategjike të disa institucioneve si, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, etj., nuk kam konstatuar që të jenë vënë objektiva mbi reformën në Policinë Gjyqësore që vepron sot. Ndërkohë që, në dokumentin e Strategjisë së Rendit Publik 2015-2020, është parashikuar riorganizimi i Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit, si një ndër objektivat prioritare në fushën e sigurisë, por për pozicionin, vendin dhe rolin që ka Policia e

Ago, A.
« Policia
Gjyqësore
të bëhet pjesë
e reformës
në drejtësi »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

Shtetit, ajo nuk mund të behet lider në këto reforma, por vetëm bashkëpunuese me institucionet kryesore që kanë këtë përgjegjësi.¹

Sot, çdokush, person i fushës ose jo, mund të shtrojë pyetjet: “A duhen reformuar strukturat hetimore?”, “A është efikas modeli aktual i policisë gjyqësore?”, “A i përgjigjet ai volumit dhe specifikave që kanë dalë në rendin e ditës në çështjet e kriminalitetit, në fushën e krimit të organizuar, në atë të korrupsionit, të terrorizmit, apo dhe në fenomenet e reja të krimeve si, ato kompjuterike, të krimit ekonomik e financiar etj., ku autorët shfrytëzojnë krahas formave e metodave të mirëstudiuara edhe të rejat e teknologjisë, të komunikimit, të fuqisë financiare, etj.?”.

3. Kapacitetet e hetimit, në përgjegjësinë e re ligjore

Pra, shqetësimi aktual është, se kapacitete hetimore kemi për të përballuar cilësisht këtë përgjegjësi ligjore, e cila duhet pranuar se, me gjithë treguesit pozitivë të këtyre viteve të fundit, problematikat i ka të shumta; ngjarjet e rënda të pazbuluara kanë zënë rrënjë dhe ende nuk po shikojnë dritën e zbardhjes, dhjetëra kallëzime bëhen nga strukturat audite për raste korruptive, abuzive e pse jo edhe për vjedhje me fondet publike. Vetë politika ngre lloj-lloj akuzash të karakterit individual a institucional; shumë agjenci e inspektorate, kryejnë inspektime, konstatojnë shkelje ligjore, pranojnë e dërgojnë vetë materiale në organin e akuzës për fillim të hetimeve dhe marrje nën përgjegjësi penale të personave konkret etj. Përfundimet, janë tepër të dobëta, ku midis tyre, ka çështje që nuk fillohen, pasi argumentohet se nuk plotësojnë kushtet procedurale; ka edhe nga ato që regjistrohen dhe pushohen pas një kohe të gjatë të kryerjes së hetimeve. Personat publikë herë pas here deklarohen të pafajshëm, ndërkohë që, kur është ngritur akuza, zhurma ka qenë e madhe e mediatike madje ka pasur raste që hetimet janë ndjekur edhe me masë sigurie “arrest në burg/shtëpi”, etj. Sot, në modelet e punës së institucioneve të akuzës, ku bashkautor është edhe Policia Gjyqësore, është hequr dorë nga analizat dhe nxjerrjet e përgjegjësi, kur deklarohet një pafajësi, kur ndryshon një akuzë, një masë sigurie, kur shkelen rregullat e sekretit apo afatet e hetimeve, etj. dhe këto konstatohen në seancë gjyqësore nga mbrojtja ose media. Nuk kemi parë që në raste të tilla, të jetë mbajtur qëndrim, të jetë analizuar rasti ose personat përgjegjës të jenë identifikuar dhe të jenë marrë masa ndëshkimore ose të paktën të jetë ndaluar mospërsëritja nga të tjerët e një gjëje të tillë. Nëpër ligje, kode e deri te shumë akte të përbashkëta të organit të akuzës me institucione të tjera, të duket se gjërat janë të rregulluara, se çdo gjë “shkon vaj”, por në praktikë as që bëhet fjalë për respektimin e pse jo, edhe për njohjen e tyre. Që nga koha e krijimit të saj e deri më sot, shtyllat kryesore të organizimit dhe funksionimit të Policisë Gjyqësore në sistemin akuzues, janë:

a) Seksionet e Policisë Gjyqësore, seksionet e posaçme, etj. Në këto seksione ka oficerë të Policisë Gjyqësore të emëruar nga Prokurori i Përgjithshëm si dhe nga ministri i Brendshëm, ai i Financave, ai i Mbrojtjes etj. Policia gjyqësore e seksioneve në Prokurori, ngarkohet vetëm me kryerjen e hetimeve paraprake, të procedimeve penale që nisin mbi bazë kallëzimesh, ose materialeve të auditit, etj.

b) Shërbimet e Policisë Gjyqësore, ku përfshihen të gjitha strukturat e Policisë së

Ago, A.
« Policia
Gjyqësore
të bëhet pjesë
e reformës
në drejtësi »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

¹ “Dokumenti i Strategjisë së Rendit Publik dhe plani i veprimit 2015-2020”, miratuar me VKM nr. 702, datë 26.08.2015.

Shtetit, si: ato kriminale, të rendit, të qarkullimit, kufitare etj., dhe policitë e tjera si: Policia Ushtarake, Policia Tatimore, Policia Doganore, Policia e Ndërtimit, Policia e Burgjeve etj., si dhe çdo polici tjetër, që me ligjin organik të krijimit të saj, do t'i njihet cilësia e ushtrimit të funksioneve të tilla.²

4. Domosdoshmëria e përfshirjes së Policisë Gjyqësore në reformën për drejtësi

Me pak fjalë, Policia Gjyqësore, ka barrën dhe përgjegjësinë për zbulimin, hetimin dhe dokumentimin e veprës penale. Arsyet që të shtyjnë për të menduar se, modeli aktual duhet t'i nënshtrohet reformës brenda saj e të përfshihet në reformën në drejtësi, janë të shumta. Në një artikull, mund të mos përfshihen të gjitha, por, ato fillojnë që nga kompozimi i “dy llojeve” të Policisë Gjyqësore, detaj që të jep pasqyrën se Policia Gjyqësore në shtetin shqiptar është e kompozuar në dy pushtete: në pushtetin ekzekutiv dhe në vartësinë e organit të Prokurorisë, që tek ne është konceptuar si një organ i një lloji të veçantë “*sui generis*”, duke mos qenë as në gjyqësor e as në ekzekutiv. Ndërkohë që, modelet e shumta të vendeve të BE-së, e kanë të përfshirë atë në pushtetin ekzekutiv. Për rrjedhojë, vijnë natyrshëm edhe arsye të tjera që krijojnë dallime, si: caktimi i ndryshëm i kushteve dhe kriterëve për rekrutimet, trajtimet, jetën administrative të tyre dhe shumë marrëdhënieve të tjera që mund të jenë fiksuar me ligjin organik të organizimit të Policisë Gjyqësore, por që në praktikë nuk kanë gjetur zbatim. Në fund të fundit, baza ligjore e tyre është e njëjtë dhe produktet që duhet të japin janë të njëjta: të kryejnë hetime dhe asgjë tjetër. Atëherë, pse dy lloje të ndryshme strukturash, dy varësi, dy lloje sistemesh arsimore për “o.p.gj”-të, “agjentët”?

Në praktikë, gjatë këtyre viteve, shumë probleme nuk kanë shkuar sipas ligjit; komisioni i procedimit disiplinor nuk ka vepruar si duhet; shkeljet e konstatuara janë marrë pak në analizë; janë dhënë pak masa disiplinore që i njej ligji; është rakorduar pak ose aspak për emërimet, transferimet, shkarkimet në Policinë Gjyqësore të Policisë së Shtetit, duke respektuar kërkesat e ligjit. Këto marrëdhënie janë lënë në heshtje ndër vite dhe shumë herë kanë qenë në varësi të pëlqyeshmërisë subjektive. Disa herë, është ndërhyrë në ligjin organik të Policisë Gjyqësore³ dhe është bashkëpunuar ose rakorduar pak midis institucioneve, pasi ka munguar analiza, njohja e gjendjes dhe vizioni reformativ për përmirësimin e saj. Kështu shpjegohet ndërhyrja në vitin 2012,⁴ ku u vendos që të barazohet përgjegjësia e punonjësit të Policisë së Shtetit, që mbante gradën “kryeinspektor” me “oficerin e policisë gjyqësore” dhe të kryente veprimtari procedurale njësoj si ky i fundit.

4.1 Ndërhyrjet e pastuduara

Praktika vërtetoi se, një ndërhyrje e tillë ishte tepër e pastuduar. Ajo nuk gjeti zbatim asnjëherë, aq me pak sot, ku në Policinë e Shtetit, kjo gradë policore nuk ekziston, ndërsa ligji është akoma në fuqi. Janë shumë të padetajuara veprimet që përmend Kodi i Procedurës Penale, kur bëhet fjala për tre termat: “policia gjyqësore”, “oficeri i policisë

Ago, A.
« Policia
Gjyqësore
të bëhet pjesë
e reformës
në drejtësi »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

² Ligji nr 8677 datë 02.11.200, “Për organizimin e funksionimin e Policisë Gjyqësore”, neni 8-15.

³ Ligji 10301, datë 15.07.2010 “Për një ndryshim në Ligjin për Policinë Gjyqësore”, neni 5.

⁴ Ligji 10301, datë 15.07.2010 “Për një ndryshim në Ligjin për Policinë Gjyqësore”, neni 5, 6 dhe 7.

gjqësore” dhe “agjenti i policisë gjyqësore”. Edhe Urdhri i përbashkët midis Ministrisë së Rendit dhe Prokurorisë së Përgjithshme në vitin 2008,⁵ apo udhëzime të tjera, nuk kanë detajuar në mënyrë konkrete veprimtarinë e gjithsecilit nga rolet, duke sjellë mosveprime dhe rënie të cilësisë së hetimeve. Pra, në tërësinë e vet, reforma duhet të ketë në qendër, rregullimin e të gjitha marrëdhënieve që ka nxjerrë praktika e kryesisht raportet e Policisë Gjyqësore me Prokurorinë, që si raporte procedurale, të shërbejnë në zhvillimin e hetimeve paraprake, të rrisin cilësinë e objektivitetin dhe të jenë të paanshme dhe gjithëpërfshirëse. Nga studimet e derisotme, rezulton se për shkaqe edhe të karakterit subjektiv, nuk janë ndërmarrë reforma me synim forcimin e kapaciteteve të hetimit; është mjaftuar me ndryshime apo përmirësime sipërfaqësore; nuk janë bërë investime me buxhete të veçanta për infrastrukturën e krijimin e kushteve normale për lehtësimin e punës.

4.2 Problemet në burimet njerëzore

Pika më e dobët e këtyre strukturave janë burimet njerëzore. Në këto funksione janë rekrutuar personel tepër i dobët nga pikëpamja arsimore, pa përvojë, pse jo edhe personel klientelist, i ardhur nga struktura të tjera, që nuk kanë asnjë lidhje me profesionin e vështirë, por tepër të bukur të hetimit. Ka mjaftuar kryerja e kurseve afatshkurtra të trajnimit, ose trajnimet nga donatorë e homologë të huaj që janë të atashuar pranë institucioneve tona. Në Policinë e Shtetit, shërbimit të Policisë Gjyqësore, - si një nga shërbimet bazë të hetimeve, i cili përballon pothuajse gjithë figurat e krimit të Kodit Penal, - për vite me radhë, nuk i ka funksionuar arsimi policor tradicional për të nxjerrë specialistë hetimi, ndërkohë që janë trashëguar dëme të mëdha në drejtim të rekrutimit të personave me arsim të cunguar, pasi kurset trajnuese për gradë policore, nënkuptonin arsimin profesional të mirëfilltë; janë bërë kalime në strukturat hetimore nga radhët e shërbimeve të tjera, që nuk lidheshin me hetimin, por që ishin të detyruar për këtë, për shkak të politikave të burimeve njerëzore, duke i dhënë përparësi gradës dhe jo arsimit apo formimit real të punonjësit.

5. Problemet e mbartura në Policinë e Shtetit

Përfshirja e Policisë Gjyqësore në reformën në drejtësi bëhet e domosdoshme edhe për shkak të problemeve, të mbartura ndër vite dhe të paqarta, që gjenden në Policinë e Shtetit. Siç dihet, nga gjithë baza ligjore aktuale që rregullon veprimtarinë e këtij institucioni, dalin në pah dy lloj aktivitetesh, e konkretisht:

a) aktivitete administrative, parahetimore gjurmuese (hetimet proaktive);

b) aktivitete paragjyqësore që lidhen me kryerjen e veprimtarisë procedurale (hetimi paraprak). Të parat, d.m.th, aktivitetet administrative, kryhen pasi një gjë e tillë rrjedh nga fakti se, Policia e Shtetit është pjesë e pushtetit ekzekutiv dhe ka ligjin e saj ku pasqyrohen objektet e punës dhe fushat e veprimit. Bashkë me homologët e saj të tjerë të administratës publike, si shërbimi pyjor, policia ushtarake, strukturat tatimore, doganore, inspektorate të ndryshme, ajo ka për synim realizimin e parandalimit dhe të shtrëngimit administrativ, të shkeljeve të konstatuara sipas procedurave përkatëse. Por, e veçanta në Policinë e Shtetit është se, veprimtaria administrative e saj shtrihet edhe në

Ago, A.
« Policia
Gjyqësore
të bëhet pjesë
e reformës
në drejtësi »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

⁵ Urdhër i Përbashkët, MB & PP, viti 2008 “Për funksionimin e Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit”.

disa drejtime të tjera që vet ligji organik ja njuh si tagër, të cilat janë:

a) veprimtaria informative; b) mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale, apo mbledhja, administrimi dhe ruajtja e informacionit policor dhe, c) procedimi policor, (hetimi proaktiv)⁶. Këto tagra që ushtrohen, dallojnë nga veprimtaria procedurale penale dhe kryhen nga strukturat e Policisë së Shtetit, me uniformë, të cilat automatikisht gëzojnë edhe atributin e Policisë Gjyqësore. Kjo, duhet të kuptohet mirë dhe qartë.

Të dytat, dallohen nga këto veçori: a) nga aktivitetet detyruese, b) nga aktiviteti urdhërues ose i deleguar, dhe, c) nga aktivitetet ndihmëse ose të deleguara nga gjykata ndërmjet prokurorit.⁷ Është shumë e rëndësishme që të kuptohet se, aktiviteti detyrues është pothuajse i njëjtë me atë administrativ të Policisë së Shtetit, kur bëhet fjalë për veprimtari parandaluese kriminale. Pikërisht këtu është dhe thelbi i kësaj reforme, që të bëhet ndarja e punës midis njerëzve të së njëjtës strukturë, por që dikush të marrë përsipër aktivitetin detyrues apo aktivitetin administrativ (parandalimin), dhe dikush tjetër të marrë përsipër aktivitetin urdhërues apo delegues procedural. Hetimi ose veprimtaria procedurale kryhet nga ato struktura të administratës shtetërore, që ligji organik i tij (shtetit), ua njuh këtë atribut, por për shkak të mos qartësisht të dallimeve midis veprimtarive të mësipërme, parandalimit dhe veprimtarisë procedurale (gjyqësore), apo të mospërcaktimit të strukturave dhe njerëzve konkretë, për të kuptuar secili, se çfarë do të kryejë, vështirëson të kuptuarit e doktrinës mbi Policinë Gjyqësore, si në teori, ashtu edhe në rastin e zbatimit të saj në praktikë.

E meta e madhe, - e trashëguar kjo, në Policinë e Shtetit, - është mosnjohja në detaje e aktiviteteve/roleve të Policisë Gjyqësore, moslistimi dhe mosndjekja nga afër e problemeve që nxori praktika gjatë zbatimit të modelit aktual, deri në mosmarrjen e masave konkrete për përbalimin e tyre. Ne jemi tunduar nga interesat e çastit dhe nuk jemi ndalur për të analizuar se “pse u bë ky ose ai ndryshim?”, “çfarë produkti sollli?”, “kush është përgjegjës i kësaj pune, qoftë për të mirë ose qoftë për të keq?”, etj. Në këtë mënyrë, ka kaluar koha, të metat kanë zënë rrënjë, përgjegjësia asnjëherë nuk është ndarë, kostot e tyre nuk janë administruar dhe pasojat i vuan shoqëria apo organizata e Policisë së Shtetit. Detyra jonë është, që në tërë organigramën strukturore të Policisë së Shtetit, të bëjmë implementimin e integruar të aktiviteteve të Policisë Gjyqësore, ose e kundërta, aktiviteteve të Policisë Gjyqësore, t’u gjejmë strukturën e përshtatshme, duke caktuar se çfarë roli i takon të kryejë secilit, pa konflikt kompetencash.

Në shtypin e përditshëm, është krijuar ideja se krijimi dhe funksionimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit, do t’i japë zgjidhje përfundimtare hetimit dhe se ky është modeli i strukturave hetimore që na duhen sot, etj. Mbroj mendimin se, organizimi i BKH-së, si një strukturë e posaçme, do të kontribuojë në hetimin e veprave penale të veçanta, ndaj subjekteve të posaçme të cilët kërkojnë vëmendje të veçantë. Por, kjo nuk ka lidhje me shqetësimin që dua të ndaj me opinionin e kësaj fushe, për sa i përket kryerjes së reformës së Policisë Gjyqësore dhe përfshirjes së saj në reformën në drejtësi.

6. Rekomandimet e ndërkombëtarëve⁸

Po nuk funksionoi Policia Gjyqësore në nivelet vendore, në hallkat e para të konstatimit të veprës penale, edhe BKH do të çalojë. Ajo nuk do të furnizohet me

⁶ Material konsultativ i misionit MAPE II, “Për organizimin e Policisë Gjyqësore në Shqipëri”, viti 1999, (f. 14-25).

⁷ Po aty, f. 26-31.

⁸ “Gjyqësori dhe te drejtat themelore”, kapitulli 23. *Progres Raporti 2015 për Shqipërinë*. Bruksel, 10.11.2015.

informacione, të dhëna për çfarë ndodh përditë, në jetën kriminale të shoqërisë dhe shumë shpejtë do të veçohet dhe do e ndjejë izolimin e saj. BKH-ja, në fund të fundit duhet të kompozohet si një ndër hallkat e sistemit hetimor të shtetit. Madje, vet krijimi i kësaj strukture të posaçme, do e shtrojë si domosdoshmëri edhe reformimin e Policisë Gjyqësore në shkallë vendi. Për të disatën herë, organizmat ndërkombëtarë si PAMEKA IV, ICITAP, OSBE, kanë shtruar rekomandimet e tyre,⁹ për reformën në strukturat hetimore, për trajnime, investime, etj., me qëllim fuqizimin, rritjen e profesionalizmit, mbajtjen pastër të figurave për personelin, vendosjen e standardeve, kushteve e kriterëve në rekrutime e deri në mënyrat e trajtimit e tyre morale dhe materiale. Është momenti i duhur për një reforme të tillë, sidomos kur gjen përkrahje edhe nga partnerë tanë strategjikë, si SHBA-ja. Besoj se edhe nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit të qeverisë shqiptare me FBI-në, kohët e fundit, është një shprehje konkrete e kësaj mbështetje dhe inkurajimi për të ndërmarrë nisma të tilla reformatore për forcimin e kapaciteteve hetimore në vendin tonë.

7. Konkluzione

Siç e trajtuam dhe në këtë shkrim, është i domosdoshëm rishikimi dhe reformimi i Policisë Gjyqësore, në tërësinë e kompozimit të saj, në Kodin e Procedurës Penale, në ligjin e vet organik dhe për pasojë edhe në institucionet që e kanë këtë të drejtë. Për Policinë e Shtetit, kërkohet riorganizimi i këtij shërbimi në raport jo vetëm me ndryshimet strukturore e ligjore, por në radhë të parë, në raport me funksionimin e strukturave të specializuara që merren me administrimin e informacionit policor në interes të luftës profilaktike ndaj kriminalitetit dhe shfaqjeve të tjera të cenimit të rendit publik. Kjo analizë duhet bërë me treguesit e punës informativo-gjurmuese, që për fatin e keq, ka vite të tëra që ka pësuar rënie dhe ende nuk janë marrë masat e duhura për ringritjen e këtyre formave e metodave të punës, aq të domosdoshme për parandalimin e ngjarjeve dhe njohjen e situatave kriminale, sidomos të situatave të krimit të organizuar, fenomeneve të korrupsionit, trafikeve të ndryshme dhe akteve terroriste. Gjithashtu, kërkesa e kohës për ngritjen dhe funksionimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, kërkon sigurim të burimeve njerëzore nga më të kualifikuarat dhe më të pastrat, në drejtim të implikimeve apo qëndrimeve profesionale e qytetare. Mbështetja e këtyre reformave me infrastrukturë të domosdoshme, burime financiare dhe personel të kualifikuar, do bëjë që shërbimet e Policisë Gjyqësore, të jenë eficiente dhe të afta për dokumentimin e aktivitetit kriminal, sidomos në seancat e hetimit gjyqësor, aty ku bëhet “ndeshja” midis subjekteve procedurale për procesin e te provuarit, si një nga hallkat më të dobëta deri tani, të organit të akuzës dhe bashkë me të edhe të Policisë Gjyqësore.

Ago, A.
« Policia
Gjyqësore
të bëhet pjesë
e reformës
në drejtësi »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

⁹ Analiza 6 mujore e ecurisë së Programit të Misionit PAMEKA IV, shkurt –shtator 2014.

Referenca

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
2. Kodi Penal në fuqi, miratuar viti 1995, i ndryshuar.
3. Kodi Procedurës Penale në fuqi, miratuar viti 1995, i ndryshuar.
4. Dekret nr 1188, datë 10.8.1995 "Për policinë gjyqësore".
5. Ligji Nr. 8677, datë, 2.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", i ndryshuar.
6. Ligji nr. 10 301, datë, 15.7.2010, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8677, datë 2.11.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore".
7. Ligj nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit".
8. Strategjia e Policisë së Shtetit dhe Plani i Veprimit 2015-2020, miratuar me VKM nr. 702, datë 26.08.2015.
9. Urdhër i përbashkët "Për funksionimin e shërbimeve të Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit", midis Ministrisë së Brendshme dhe Prokurorisë së Përgjithshme, nr. prot. 1227/1, dt. 1.04.2008 dhe nr. prot. 1075/1, dt. 15. 04.2008.
10. Kapitulli 23, "Gjyqësori dhe të drejtat themelore", progres-raporti 2015 për Shqipërinë, Bruksel 10.11.2015.
11. Shala, Xhavit. *Rrjeti informativ në Policinë e Shtetit / 2005-2010*, studim.
12. Material konsultativ i misionit MAPE II, "Për organizimin e Policisë Gjyqësore në Shqipëri/1999".
13. Analiza 6 mujore e ecurisë së programit të misionit PAMECA IV, shkurt-shtator 2014.
14. Dokumenti i planifikimit strategjik të programit të BE-së, IPA II, për analizen e gjëndjes së sistemit të drejtësisë në Shqipëri.
15. Dokument analitik i Ministrisë së Drejtësisë, janar 2015 , "Informacion i detajuar sipas sektorëve të sistemit të drejtësisë në Shqipëri".

Ago, A.
« Policia
Gjyqësore
të bëhet pjesë
e reformës
në drejtësi »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

Asetet kriminale dhe strategjia kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe korrupsionit



■ Msc **Lutfi MINXHOZI**
Drejtorja e Përgjithshme e Policisë

Abstrakt

Gjurmimi, gjetja, ngrirja, sekuestrimi dhe konfiskimi i asetëve kriminale, është mënyra më efektive për të luftuar e rrënuar krimin e organizuar, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, korrupsionin, parandalimin e zhvillimit të krimit; është çështje thelbësore për drejtimin e fitimeve, për rikuperimin e viktimave të krimit, për riparimin e pasojave të tij, për garantimin e zhvillimit të ekonomisë së lirë, konkurrencës së ndershme, për forcimin e shtetit të së drejtës, sigurisë dhe lirisë së individit dhe për mbrojtjen e demokracisë. Për të mbrojtur shtetin e së drejtës, pronën e ligjshme, lirinë e individit, për të garantuar progresin shoqëror dhe zhvillimin ekonomik, duhet të merren masat vijuese: strukturat ligjore ekzistuese kanë nevojë të përmirësohen; zotërimi i asetëve të pajustificuara duhet të bëhet vepër penale më vete dhe një krim serioz bazë për hetimin pasuror; konfiskimi civil i asetëve të pajustificuara duhet të ndodhë pavarësisht ekzistencës së procedimit penal, pavarësisht dënimit për veprën penale bazë; nevojitet të përmyset koncepti i barrës së provës dhe prezumimit të pafajësisë në procedimet pasurore civile; të sigurohet njohja e dyanshme e urdhrave ndërkombëtar të ngrirjeve, sekuestrimeve, konfiskimeve, dhe rikuperimi i asetëve kriminale, për kompensimin e viktimave të krimit, forcimin e sistemit të drejtësisë dhe konsolidimin e autoriteteve të zbatimit të ligjit; të lehtësohet investigimi duke siguruar akses në regjistrat e pasurive, llogarive bankare për autoritetet e hetimit të krimit ekonomik e financiar dhe të krijohen mjete e metoda të reja për të mbështetur procedurat e konfiskimit të suksesshëm; të hartohen programe metodologjike e praktika për kompensimin e viktimave të krimit, për zbutjen ose eliminimin e pasojave të krijuara, etj. Të gjithë këta elementë që përmendëm do të trajtohen hap pa hapi në materialin vijues dhe në fund do të nxirren edhe përfundimet analizës.

Minxhozi, L.
« Asetet
kriminale dhe
strategjia
kundër krimit të
organizuar,
pastrimit
të parave dhe
korrupsionit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

Fjalëkyçe:

korrupsioni, sekuestrimi i asetëve kriminale, konfiskimi i asetëve kriminale, hetimi i asetëve kriminale, pastrim parash, sistemi i drejtësisë, procedimi penal.

1. Hyrje

Krimi ekonomik e financiar ka lindur që me lindjen e pronës private dhe ka ekzistuar bashkë me shoqërinë, në të gjitha etapat e zhvillimit të saj. Ai përbën sot një ndër shqetësimet madhore të shoqërisë dhe shtetit të së drejtës, si në shkallë vendi e rajoni edhe në nivel europian e global. Krimi ekonomik e financiar, si formë e kriminalitetit kompleks sjell pasoja të paparashikueshme. Ai shkatërron konkurrencën e ndershme, destabilizon tregun e lirë valutor e monetar, humb besimin në institucionet financiare¹ dhe jo financiare, bizneset dhe profesionet², investon në zgjerimin e krimit të organizuar dhe korruptimin e zyrtarëve publik, sjell destabilizim të situatave ekonomike, financiare e politike, dëmton demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe progresin

¹ "International standards on combating money laundering and financing of terrorism & proliferation". *FATF-Recommendations 2016/FATF/OECD* (f. 119-120). Parë për herë të fundit në datë 10.05.2016, në faqen elektronike:

http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/pdfs/FATF_Recommendations.pdf.

"Institution financiar" është çdo person fizik ose juridik, i cili si biznes kryen një ose më shumë aktivitete, apo operacione, për ose në emër të klientit, që kanë të bëjnë me: 1. Pranimin e depozitave dhe fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku. 2. Kreditimin. 3. Qeratë financiare. 4. Shërbimet e transferimit të vlerave monetare. 5. Lëshimin dhe menaxhimin e mjeteve të pagesave, (kartat e kreditit dhe debitit, çequet, çequet e udhëtimit, urdhrat e pagesave, parat elektronike. 6. Garancitë dhe angazhimet financiare. 7. Tregtinë e: a) Instrumenteve monetare të pagesës (çeqe, kambiale, certifikata depozitash etj); b) Këmbimin valutor; c) Shkëmbimin e normave të interesit, sigurimin në shërbimeve financiare; ç) Letrat me vlerë të transferueshme; e). Të ardhmen e tregtisë së mallrave. 8. Pjesëmarrjen në çështjet e letrave me vlerë dhe sigurimin në shërbimet financiare. 9. Menaxhimin e profileve individuale dhe kolektive. 9. Ruajtjen dhe administrimin e parave fizike ose letrave me vlerë likuide në emër të personave të tjerë. 11. Investimin, administrimin apo menaxhimin e fondeve ose parave në emër të personave të tjerë. 12. Nënshkrimin dhe vendosjen e sigurimit të jetës dhe të sigurimeve që lidhen me investimeve të tjera. 13. Ndryshimin e parave dhe të monedhave.

² "International standards on combating money laundering and financing of terrorism & proliferation". *FATF-Recommendations 2016/FATF/OECD* (f. 116-117). Institucionet jofinanciare, bizneset dhe profesionet janë: a) Kazinotë. b) Agjentët e pasurive të paluajtshme. c) Tregtarët e metaleve të çmuar. d) Tregtarët e gurëve të çmuar. e) Avokatët, noterët, kontabilistët dhe profesionet e tjera ligjore. f) Trustet dhe ofruesit e shërbimeve të kompanive, personave dhe bizneseve që nuk mbuloohen nga sh.p.k. e vendeve, ofruesit e shërbimeve për palët e treta, të cilët veprojnë si: a) agjenti i personave juridik; b) drejtor ose sekretar i një kompanie, partner i partneritetit, ose në pozicione të ngjashme në raport me personat e tjerë juridikë; c) zyrë për të regjistruar dhe siguruar adresat e: biznesit; strehimit; korrespondencës; administratave të kompanive, ortakët ose çdo person tjetër juridik; ose çdo marrëveshje. ç) Person në besim, kujdestar, për ushtrimin e funksionit ekuivalent për një formë tjetër të marrëveshjes ligjore. d) si një person i nominuar si aksioner për person tjetër.

ekonomik dhe shoqëror. Në kushtet aktuale të zhvillimeve globale të teknologjisë së informacionit, zhvillimeve të tregtisë së lirë të mallrave dhe lëvizjes së lirë e njerëzve e të kapitaleve, krahas progresit shoqëror u krijuan edhe mundësi e hapësira për zgjerimin e krimit të organizuar dhe realizimin e ëndrrës kriminale për të pastruar parat e krimit, për të fshehur origjinën e pasurisë, gjurmët e prejardhjes, për të përzier produktet kriminale dhe/ose për të investuar në aktivitete legale. Labirintet e krimit ekonomik e financiar janë komplekse, ndaj në këtë shkrim do të trajtojmë kryesisht, si më me interes, prapavijën financiare të krimit, gjurmimin, identifikimin, gjetjen me qëllim sekuestrimin, konfiskimin dhe rikuperimin e aseteve kriminale, e cila përbën strategjinë më të efektshme për të luftuar jo vetëm krimin ekonomik, korrupsionin dhe pastrimin e parave, por krimin e organizuar, terrorin, trafiket e paligjshme dhe çdo veprimtari kriminale tjetër me prapavijë financiare. Ndaj është e domosdoshme në kushtet aktuale nevoja e zhvillimeve të sistemeve koherente dhe efikase ligjore, bashkërendimi ndërinstytucional dhe ndërkombëtar, krijimi i mjeteve të reja për ndërtimin, organizimin, koordinimin dhe lehtësimin e bashkëveprimit e strukturave operacionale në shkallë vendi dhe në nivel ndërkombëtar.

2. Historik

Struktura dhe instrumente të rëndësishme ndërqeveritare ndërkombëtare, u angazhuan me kohë në luftën kundër krimit financiar e pastrimit të parave. Në vitin 1989, me iniciativë të ministrave të financave të vendeve më të zhvilluara (Grupi G⁷) u krijuan “Njësia e Veprimit Ndërkombëtare Kundër Zbardhjes së Kapitaleve”, e njohur si FATF dhe si GAFI, qëllimi kryesorë i së cilës ishte për të parandaluar kriminelët të përdornin sistemin financiar për të pastruar paratë e krimit. Prej vitit 1997, në Këshillin e Europës, u ngrit komiteti i ekspertëve të përzgjedhur për vlerësimin e masave kundër pastrimit të parave për vendet e Europës, i cili luan rolin e FATF për vendet nën juridiksionin e tij dhe që njihet si Komiteti MONEYVAL⁴. Fillimisht, ai quhej PC-R-EV. Ai luan rolin e FATF për vendet e Europës. Katër vendet të Europës, - Mbretëria e Bashkuar, Belgjika, Austria dhe Finlanda, - ishin iniciatore për të garantuar rrugën drejt konfiskimit. Ato krijuan dhe implementuan, në legjislationin e tyre të brendshëm kombëtar, sistemin e gjurmimit, konfiskimit dhe rikuperimit të aseteve kriminale. Të metat e strukturave ekzistuese në vendet e BE-së, vonesat në bashkëpunim dhe në ekzekutimin e letërprosrive, diktuan: nevojën e ndryshimeve ligjore, nevojën e konfiskimit jashtë dënimit kriminal (konfiskimin civil), krijimin e një vepre të re penale për zotërimin e aseteve të “pajustificuara”, sigurimin e dyanshëm të njohjes së urdhrave të ngrirjes dhe të konfiskimit si dhe zgjerimin e kufijve të vendit që ka mandatin e konfiskimit mbi një vend tjetër; detyrimin dhe obligimin për të siguruar informacion në llogaritë bankare; krijimin e zyrave kombëtare për gjetjen dhe marrjen e aseteve kriminale (ZKGJAK); organizimin efektiv të zyrave për menaxhimin e aseteve kriminale

Minxhozi, L.
« Asetet
kriminale dhe
strategjia
kundër krimit të
organizuar,
pastrimit
të parave dhe
korrupsionit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

³ G 7, është grupi i përbërë nga ministrat e financave dhe guvernatorët e bankave qendrore të 7 vendeve të industrializuara dhe më të zhvilluara ekonomikisht, siç janë Fondi Monetar Ndërkombëtar, Kanadaja, Franca, Gjermania, Italia, Japonia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara, të cilët mblihdhen dhe diskutojnë çështje ekonomike.

⁴ Website www.coe.int/moneyval dhe adresa e internetit <http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/moneyval/restricted/members/MONEYVAL>: Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit & armëve të dëmtimit në masë për vendet e Evropës. Parë për herë të fundit në datë, 8.5.2016.

(të njohura si; *AMO-Asset Management Office*), shkëmbimin e informacioneve mes zyrave dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar; rritjen e rolit dhe të drejtësisë europiane në këtë drejtim. Ekspertë ligjorë, investigativ, nga forcat e zbatimit të ligjit, të prokurorisë dhe të gjyqësorit të vendeve të Bashkimit Europian, me ftesë të Byrosë së Aseteve Kriminale të Irlandës dhe Europolit në tetor 2002, u mbledhën në një konferencë në hotelin e gjykatës, Camden, në Dublin. Objektivi i konferencë ishte që të paraqisnin rekomandimet për identifikimin, zbulimin dhe konfiskimin e fitimeve të krimit. Një nga rekomandimet kryesore ishte krijimi i një rrjeti ndërlidhës joformal të kontakteve nga agjencitë e zbatimit të ligjit, prokuroritë, drejtësia dhe gjykatat europiane, për të bashkëpunuar për identifikimin, gjetjen sekuestrimin, konfiskimin dhe rikuperimin e aseteve kriminale. Qëllimi i krijimit të rrjetit ndërlidhës të zyrave Camden, ishte rritja e efektivitetit dhe e përpjekjeve për privimin e kriminelëve nga fitimet e tyre të paligjshme. Ky rrjet u zyrtarizua në konferencën e datës 22-23 shtator 2002 dhe mbante emrin “Camden”, atë të Hotelit të Gjykatës Dublin ku u mbajt edhe takimi i parë. Fillimi zyrtar i rrjetit Candem, për gjetjen e rikuperimin e aseteve kriminale i njohur si rrejt CARIN⁵- (Camden Asset Recovery Agency), ndodhi gjatë kongresit të themelimit të rrjetit (network) në Hagë, 22-23 shtator 2004.

Në këtë kongres u krijua rrjeti joformal i praktikantëve dhe ekspertëve të fushës me qëllim, përmirësimin dhe njohjen reciproke të metodologjisë dhe teknikave ndërkufitare për identifikimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e rikuperimin e produkteve të krimit. Rrjeti Camden ka përmirësuar e zgjeruar bashkëpunimin ndërkombëtar midis agjencive të zbatimit të ligjit, të drejtësisë, të procedimit dhe të gjyqësorit, si dhe synon të sigurojë një shërbim më efikas, ndërmjet vendeve në këtë fushë. Rrjeti i zyrave ndërlidhëse Camden, përbëhet nga 54 vende, 9 organizata ndërkombëtare e që janë të lidhura gjithashtu njëllor edhe me zyrat për gjetjen e aseteve kriminale të Afrikës Jugut, Amerikës Latine, Azisë e Paqësorit, Afrikës dhe Afrikës Jugore. Synimi i tij është që t'u sigurojë efektivitet përpjekjeve të strukturave të vendeve pjesëmarrëse, për të privuar kriminelët nga asetet e krimit. Shqipëria u bë anëtare e këtij rrjeti me statusin “observer” (vëzhgues) mbikëqyrës në 2006 dhe përfaqësohet me dy pika kontakti, ekspertët të fushës prej Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë.

Më datë 20.11.2008, Komisioni i Komunitetit Europian, në Bruksel, i dërgon letër nr. 766⁶ Parlamentit dhe Këshillit Europian, me titull: “Të ardhurat e krimit të organizuar, sigurim që ‘krimi nuk paguan’”, në të cilën trajton rëndësinë, nevojën e fokusimit në të ardhmen tek të ardhurat e krimit të organizuar, korrupsionit, zhvillimin e strukturave ligjore koherente të përshtatshme për lehtësimin e procedurave të

⁵ Camden Asset Recovery-Agency Network - CARIN-, është rrjet informal ndërkombëtar ndërlidhës i oficerëve, prokurorëve, gjyqtarëve, praktikues të fushës, e gupeve të kontaktit, të gjurmimit, sekuestrimit, konfiskimit dhe rikuperimit të aseteve kriminale, me sekretariat në Europol. Ata koordinojnë dhe bashkëpunojnë për gjetjen, sekuestrimin, konfiskimin dhe rikuperimin e produkteve të krimit. CARIN përbëhet nga 54 vende, 9 organizata ndërkombëtare e që janë të lidhura gjithashtu njëllor edhe me zyrat për gjetjen e aseteve kriminale të Afrikës Jugut, Amerikës Latine, Azisë e Pacifikut, Afrikës dhe Afrikës Jugore. Qëllimi i tij është të sigurojë efektivitet përpjekjeve agjencive bazë të vendeve pjesëmarrëse për të privuar kriminelët nga asetet e krimit. Takimi i parë, i ekspertëve të fushës të vendeve të Bashkimit Europian është mbajtur në Dublin, në vitin 2002 prej nga ka marrë edhe emrin e Hotelit Camden. CARIN është zyrtarizuar si rrejt në takimin e Hagës më datë 22 - 23 shtator 2004. Shqipëria ka caktuar dy pika kontakti me ekspert të fushës së hetimit të krimeve ekonomike e financiare dhe aseteve kriminale nga Policia e Shtetit dhe Prokuroria. Faqe e internetit www.carin-network.org. Parë për herë të fundit, në datë 8. 4. 2016.

⁶ Commission of the European Communities, Brussels, 20.11.2008 com (2008) 766 final Communication from the Commission to the European Parliament and the Council proceeds of organized crime ensuring that “crime does not pay”.

Minxhozi, L.

« Asetet kriminale dhe strategjia kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe korrupsionit »

Policimi dhe Siguria nr.3, 2016

bashkëpunimit, zhvillimin e legjislacionit bashkëkohor si dhe përcakton 10 prioritet strategjike për të ardhmen e luftës kundër krimit të organizuar e korrupsionit.

3. Organizmat ndërkombëtare

3.1 Njësia e veprimit ndërkombëtar kundër zbardhjes së kapitaleve, financimit të terrorizmit dhe prodhimit të armëve të dëmtimit në masë (FATF)

FATF synon të përbushë këtë qëllim, nëpërmjet vendosjes së standardeve dhe promovimit e implementimit efektiv ligjor, rregullatorëve dhe masave operacionale kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe të armëve të dëmtimit në masë. Për këto, FATF studioi dhe vendosi 40 rekomandime, si masa që duhet të implementojnë vendet për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit e të prodhimit të armëve të dëmtimit në masë, të cilat shërbejnë si standarde ndërkombëtare. Ato kanë të bëjnë kryesisht me identifikimin e rreziqeve dhe zhvillimin e koordinimit e politikave të brendshme, kriminalizimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe të armëve të dëmtimit në masë, aplikimin e masave parandaluese në sektorët financiarë dhe jofinanciarë, krijimin e autoriteteve përgjegjëse për investigimin e mbikëqyrjen dhe masa të tjera ndërinstucionale, për rritjen e transparencës, identifikimin e përfituesit përfundimtar dhe rritjen e forcuar të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Këto rekomandime, në raport me zhvillimet ndërkombëtare, rreziqet dhe pasojat që sjell krimi ekonomik dhe veçanërisht pastrimi i parave, financimi i terrorizmit dhe prodhimit i armëve të dëmtimit në masë, janë përmirësuar e rishikuar në vazhdimësi – në vitet 1990, 1996, 2001, 2003 dhe së fundi në vitin 2012. Pas ngjarjeve të 11 shtatorit, në Amerikë, në vitin 2001 këto rekomandime u pasuruan me 8 dhe më pas me rekomandimin e 9-të shtesë, për masat kundër financimit të terrorizmit e që kishin të bënin me kriminalizimin e financimit të terrorizmit, raportimin e transaksioneve që dyshohet se lidhen me financime të terrorizmit, ngrirjen e llogarive bankare të individëve dhe organizatave terroriste, kontrollin e parave fizike “cash”-it, kontrollin e transaksioneve në kufi, etj. Në vitin 2013, rekomandimet e FATF u përmblodhën serish në 40⁷ dhe që sot

⁷ 40 Rekomandimet e rishikuara konsistojnë në masat që duhen ndërmarrë nga vendet lidhur me: 1. Vlerësimin e rrisht dhe aplikimin e qasjeve të bazuara në rrisht; 2. Bashkëpunimin dhe koordinimin kombëtar; 3. Kriminalizimin e pastrimit të parave; 4. Konfiskimin dhe masat e përkohshme; 5. Kriminalizimin e financimit të terrorizmit; 6. Vendosjen e sanksioneve lidhur me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit; 7. Vendosjen e sanksioneve, lidhur me prodhimin e armëve të dëmtimit në masë; 8. Parandalimin e përdorimit nga terroristët të organizmave jofitimprurëse; 9. Rishikimin e ligjit për sekretin e institucioneve financiare e bankare; 10. Identifikimin e klientit; 11. Regjistrimin dhe mbajtjen e të dhënave. 12. Rritjen e vigjilencës ndaj personave të ekspozuar politikisht; 13. Rritjen e vigjilencës ndaj bankave korresponduese. 14. Masat specifike lidhur me shërbimeve të transferimit të parasë ose valutave; 15. Masat specifike identifikuese në kuadrin e zhvillimeve të reja teknologjike; 16. Masat specifike për identifikimin e klientëve në transfertat kablore; 17. Masa specifike për palët e treta; 18. Masat për kontrollin e brendshëm dhe degëve e filialeve të huaja; 19. Masat për kontrollin e vendeve me rrisht të lartë; 20. Raportimin e transaksioneve të dyshimta; 21. Masat për mbrojtjen ligjore të punonjësve lidhur me konfidencialitetin dhe në rastet kur raportojnë transaksionet e dyshimta; 22. Masat për identifikimin e klientëve dhe parandalimin e përdorimit të institucioneve jofinanciare, bizneseve dhe profesioneve IJFBP – DNFBP2; 23. Masat e tjera për IJFBP – DNFBP; 24. Transparencën dhe personat juridik përfitues përfundimtar. 25. Transparencën dhe rregullimet ligjore për përfituesin përfundimtar; 26. Rregullimin dhe mbikëqyrjen e IF; 27. Kompetencat e mbikëqyrësve; 29. Njësitë e Inteligjencës Financiare (NIF-FIU3). 28. Rregullat për mbikëqyrjen e IJFBP. 30. Përgjegjësitë ligjore për autoritetet e zbatimit të ligjit; 31. Kompetencat e autoriteteve zbatimit të ligjit dhe atyre investigative; 32. Korrierët e parave; 33. Statistikat e krahasueshme dhe efektive; 34. Rregulloret dhe reagimin ndaj veprimeve parandaluese. 35. Sanksionet; 36. Instrumentet ndërkombëtare. 37. Ndihmën e ndërsjellët ligjore. 38. Ndihmën e ndërsjellët ligjore për ngrirjen dhe konfiskimin; 39. Ekstradimin; 40. Forma të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar.

shërbejnë si standarde ndërkombëtare që duhet të përmbushen nga vendet për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. FATF, krahas rekomandimeve, ka botuar dhe rishikuar edhe metodologjinë për vlerësimin e përputhshmërisë teknike dhe efektivitetin e sistemit të masave kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe prodhimit të armëve të dëmimit në masë.

3.2 Komiteti MONEYVAL

MONEYVAL, është themeluar si një nënkomitet i Komisionit Europian të Këshillit të Europës për Problemet e Krimit (CDPC) dhe, vepron si një organ rajonal i tipit të FATF-ës për vendet nën mandatin e Këshillit të Europës. Ai përbëhet nga ekspertë të përzgjedhur, nga fushat ligjore, financiare dhe forcave të zbatimit të ligjit, nga vende anëtare të Këshillit të Europës të cilat nuk janë anëtarë të FATF-së. Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, të cilët janë ish-anëtarë të Komitetit dhe që më pas janë bënë anëtarë të FATF-ës, kanë të drejtë të mbajë anëtarësinë e tyre në Komitetin MONEYVAL. Në komitet ftohen dhe marrin pjesë edhe ekspert të fushës nga FATF, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore (BB), UNCTC, OGBS, OSCE, Grupi Egmond⁸, Grupi Euro-Aziatik për masat kundër Pastrimit të Parave dhe financimit të terrorizmit.

3.3 Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KSKB)

Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ka nxjerrë rezolutat 1267/1999, 1333/2000, 1363/2001, 1373/2001, 1377/2001, 1452/2002, 1455/2003, 1989/2011 dhe 2253/2015, për parandalimin e terrorizmit dhe ngrirjen e aseteve të listuar në listat e financuesve të terrorizmit ndërkombëtar. Vendet anëtare të OKB-së duhet t'i zbatojnë sanksionet në këto rezoluta dhe të garantojnë masat për sigurinë globale ndaj grupeve, organizatave, enteve, individëve të cilët janë klasifikuar si financues të terrorizmit ndërkombëtar.

4. Instrumentet ndërkombëtare, kundër krimit ekonomik e financiar dhe, konfiskimit të produkteve të krimit

Instrumentet ndërkombëtare dhe hapat që duhet të ndërmarrin vendet për të ratifikuar, implementuar dhe zbatuar plotësisht, trajtohen në rekomandimin 36 të FATF-së. Ato janë, Konventa e Vjenës e vitit 1988; Konventa e Palermos e vitit 2000; Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, e vitit 2003; “Konventa e shtypjes së terrorizmit ndërkombëtar”, e vitit 1999 dhe konventat e tjera ndërkombëtare si Konventa e Këshillit të Europës për Krimet Kompjuterike, e vitit 2001; “Konventa interamerikane kundër terrorizmit”, e vitit 2002; dhe Konventa e Këshillit të Europës “Për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe financimit të terrorizmit”, e vitit 2005, e njohur si Konventa e Varshavës⁹.

⁸ “EGMONT Group” - Rrjeti informal i komunikimit të njësisë të inteligjencës financiare, formuar në vitin 1995, emri i të cilit është marrë nga Pallatit “Egmont Arenberg”, në Burksel ku është mbajtur takimi i parë i krerëve të NJIF- FIU. Grupi Egmont deri në vitin 2013, kishte 132 anëtarë. Shqipëria u bë pjesë e Grupit Egmont në takimin vjetor të vitit 2003, në Sydney, Australi. Ky rrjet shkëmben informacion financiar dhe RAD në rrugë të sigurt, në nivel ndërkombëtar, bazuar në marrëveshjen tip të nënshkruar mes NJIF/FIU-s.

⁹ “Konventa e Varshavës” - Konventa e Këshillit të Evropës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”, e datës 16.5.2005, ratifikuar me ligj nr. 9646, datë 27.11.2006.

4.1 Konventa e Varshavës

Konventa e Këshillit të Evropës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”, në nenin 16-të, jep detyrimin për palët anëtare, që të asistojnë sipas kërkesave të njëra-tjetrës për identifikimin dhe ndjekjen e mjeteve, produkteve dhe pasurive të tjera që i nënshtrohen konfiskimit. Asistenca duhet të përfshijë çdo masë që jep dhe garanton prova në lidhje me ekzistencën, vendndodhjen ose lëvizjen, natyrën, statusin ligjor, apo vlerën e pasurisë objekt konfiskimi. Në nenin 25 të saj, trajtohet se pasuritë e konfiskuara disponohen prej palës që i ka konfiksuar, në përputhje me të drejtën e saj të brendshme, dhe procedurat përkatëse administrative. Nëse veprohet me kërkesë të një pale tjetër, në përputhje me kërkesat e kësaj konvente, në masën e lejuar nga ligji i brendshëm dhe, nëse kjo kërkohet, palët i japin prioritet kthimit të pasurisë së konfiskuar palës kërkuese, në mënyrë që kjo të kompensojë viktimat e krimit ose t’ua kthejë këtë pasuri pronarëve të ligjshëm. Palët mund të konsiderojë në veçanti lidhjen e marrëveshjeve ose krijimin e lehtësirave për ndarjen me palët e tjera, të kësaj pasurie, në mënyrë periodike ose rast pas rasti, në përputhje me të drejtën e saj të brendshme, si dhe procedurat përkatëse administrative.

4.2 Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit¹⁰

Qëllimi i kësaj konvente është nxitja dhe forcimi i masave për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit më me efikasitet dhe efektivitet; nxitja, lehtësimi dhe mbështetja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe asistencës teknike në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë rimarrjen e pasurisë; nxitja e integritetit, përgjegjësisë dhe administrimit të rregullt të çështjeve publike dhe pasurisë publike. Objekt i kësaj konvente është parandalimi, hetimi dhe ndjekja penale e korrupsionit, si dhe ngrirja, kapja, konfiskimi dhe kthimi i fitimeve nga veprat penale, në pajtim me kushtet e saja.

Neni 20¹¹ i konventës, kërkon që shtetet palë, në përputhje me kushtetutën dhe principet themelore të shtetit ligjor, të marrin masa për të bërë vepër penale pasurimin e paligjshëm të një nëpunësi publik. Parlamenti ka miratuar ligjin 10192,¹² datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, duke përfshirë detyrimin për hetimin e pasurisë që lidhet me krimin e organizuar, me qëllim konfiskimin civil, krahas dhe, pavarësisht procedimit penal. Agjencia e Menaxhimit të Aseteve të Sekuestruara e Konfiskuara (ASKA), në Shqipëri, është ngritur pranë Ministrisë së Financave, por ajo nuk ka attribute investigative për pasuritë objekt konfiskimi, por ka vetëm attribute administrative, për ruajtjen, menaxhimin e administrimin dhe rritjen e vlerës së tyre. Këto struktura janë të reja, të ngritura rishtazi dhe në proces zhvillimi edhe në vendet anëtare të Bashkimit Europian.

Minxhozi, L.

« Asetet kriminale dhe strategjia kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe korrupsionit »

Policimi dhe Siguria nr.3, 2016

¹⁰ Ligj nr. 9492, datë 13.3.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit”.

¹¹ “Pasurimi i paligjshëm” - Në përputhje me Kushtetutën dhe principet themelore të sistemit të tij ligjor, secili shtet palë shqyrton marrjen e masave legjislative, dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme, për të parashikuar si vepër penale, kur kryhet me qëllim pasurimin e paligjshëm, që është një rritje e madhe e pasurisë së një nëpunësi publik, që ai ose ajo, nuk mund ta justifikojë me të ardhurat e tij, ose të saja, të ligjshme.

¹² Ligj nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

4.3 Letër nr. 766¹³ Parlamentit dhe Këshillit European me titull: “Të ardhurat e krimit të organizuar, sigurim që ‘krimi nuk paguan’”

Në këtë letër, ndër të tjera shprehimisht thuhet: “Grupet e krimit të organizuar, kanë ngritur në një shkallë të lartë ndërlidhjen ndërkombëtare dhe kanë grumbulluar përfitime të konsiderueshme prej gjithçfarlloj aktiviteteve kriminale. Të ardhurat e krimit janë larë dhe rinjektuar në ekonominë legale. Efikasiteti i sistemeve kombëtare kundër pastrimit të parave dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në këtë fushë, janë të një rëndësie të lartë. Megjithatë, madje kur të ardhurat e krimeve kanë qenë pastruar me sukses, pasuritë e kriminelëve të organizuar, akoma mund të indetifikohen, të kapen dhe të rimerren nëpërmjet inteligjencës financiare dhe investigimit. Gjetja dhe konfiskimi i aseteve kriminale është mënyra më efektive për të luftuar krimin e organizuar, i cili është thelbësor për drejtimin e fitimeve. Konfiskimi pengon pasurimin e krimineleve për t’i përdorur në financime të aktiviteteve të tjera kriminale, që rrezikojnë besimin në sistemet financiare dhe legjitimitimin e korrupsionit shoqëror. Konfiskimi ka efekt mbajtës nëpërmjet fuqizimit të nocionit “krimi nuk paguan”. Kjo mund të ndihmojë heqjen e modeleve, formave dhe roleve negative prej komuniteteve lokale. Në disa raste, masat e konfiskimit të produkteve të krimit japin shenja marrjesh vendimi brenda organizatave kriminale, të cilat janë investiguar dhe proceduar realisht.

4.4 Dhjetë prioritet strategjike të BE-së,¹⁴ kundër krimit të organizuar

Në letër përcaktohen edhe dhjetë prioritet strategjike¹⁵ për strukturat e BE-së, të cilat orientojnë autoritetet e vendeve të BE-së të fokusohen tek të ardhurat e produktet e krimit, me qëllim gjetjen, sekuestrimin, konfiskimin dhe rikuperimin e kompesimin e viktimave të krimit, si metoda më efektive dhe e ardhmja e luftës kundër krimit të

¹³ Commission of the European Communities, Brussels, 20.11.2008 com (2008) 766 final Communication from the Commission to the European Parliament and the Council proceeds of organized crime ensuring that “crime does not pay”.

¹⁴ Letra nr. 766, datë 20.11.2008, e Komisionit të Komunitetit European, Bruksel, drejtuar Parlamentit dhe Këshillit European. 10 Prioritet Strategjike të BE-së: 1. Strukturat ligjore të BE-s në të ardhmen do të rimodelohen qartësisht drejt përmirësimit e sigurimit të lidhjeve logjike, duke shtrirë më mirë në të ardhmen koncepte ekzistuese ligjore me ndërhyrjet për përmirësime të reja, çështje të barrës së provës, prezumimit të pafajësisë etj. 2. Shtetet anëtare duhet të ngrenë Zyrat Kombëtare të Gjetjes së Aseteve të Konfiskueshme (ZGJAK), si autoritete kompetente për të shkëmbyer informacion të shpejtë, që kanë përshatshmërinë, forcën dhe punojnë bazuar në praktikën më të mirë. 3. Të hiqen pengesat praktike të procedurave të konfiskimit në shtetet anëtare të BE-së. 4. Zyrat e Gjetjes së Aseteve të Konfiskueshme të BE-së, duhet të takohen rregullisht pa platforma ceremoniale, Europoli është i inkurajuar të luajë rolin e koordinatorit midis tyre. 5. Duhet të zhvillohet dhe të zbatohet një sistemi i vlerësimit të efektivitetit të ZGHAK. 6. Drejtësia Europiane do të përfshihet për të gjetur lehtësi bashkëpunimi në fushën juridike dhe të sigurojë mbështetjen e dyanshme roguatale në çështjet e konfiskimit, lehtësi edhe bashkëveprim sa më të mirë të mundshëm ndërmjet ZGJAK dhe administratave juridike. 7. Për investigatorët financiarë të BE-së, të zhvillohen dhe implementohen me prioritet programet e përbashkëta të trajnimit. Shtetet anëtare do të konsiderojnë forcimin e burimeve të kushtëzuara, drejt analizës kriminale financiare dhe investigimit financiar në nivel kombëtar. 8. Duhet që shtetet anëtare të jenë në gjendje të zhvillojnë dhe përmirësojnë statistikën e krahasueshme të aseteve të ngrira, konfiskuara dhe kthyer, si mënyra më e mirë për të vlerësuar efektivitetin e sistemeve të konfiskimit në vend. 9. Komisioni dhe shtetet anëtare do të mendojnë si të bëjnë të disponueshme ZGJAK në shtetet e tjera anëtare dhe në vendet e treta, duke siguruar domosdoshmërisht identifikimin e informacionit dhe gjurmët e aseteve në territoret e tyre, mundësitë ndërmjet organizimit të regjistrave qendror. 10. Europoli, Drejtësia dhe shtetet anëtare të jenë në gjendje të bashkëpunojnë drejt përmirësimit disponueshmërisë së informacionit, shfaqjen dhe ekzekutimin e urdhrave të ngrirjeve dhe konfiskimit në BE.

¹⁵ Letra nr. 766, datë 20.11.2008, e Komisionit të Komunitetit European, Bruksel, drejtuar Parlamentit dhe Këshillit European. 10 Prioritet Strategjike të BE.

Minxhozi, L.
« Asetet
kriminale dhe
strategjia
kundër krimit
të organizuar,
pastrimit të
parave dhe
korrupsionit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

organizuar e korrupsionit. Për konfiskimin e asetëve të krimit, Shqipëria ka ndërmarrë një sërë hapash ligjorë, duke ratifikuar, nënshkruar dhe vënë në zbatim, konventat e Palermos¹⁶, “Vjenës¹⁷, Varshavës, konventën ndërkombëtare për “Luftën kundër financimit të terrorizmit¹⁸”, konventën e Këshillit të Europës “Për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjyqimeve penale¹⁹ dhe, ligjin “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë²⁰”. Ligji ka për qëllim parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, terrorit, pastrimit të parave dhe korrupsionit, në nivele të larta dhe në sistemin e drejtësisë, nëpërmjet sequestrimit, konfiskimit dhe rikuperimit të pasurive kriminale, krahas dhe, pavarësisht procedimit penal. Ligji shqiptar 10192²¹, i ndryshuar, i jep Gjykatës për Krimet e Rënda autoritetin dhe të drejtën për të vendosur konfiskimin e produkteve direkte ose indirekte, të krimeve serioze (krimit të organizuar, trafikëve, pastrimit të parave dhe korrupsionit në nivele të larta të administratës publike dhe, në sistemin e drejtësisë, target veprash penale që specifikohen në nenin 3 “*Fushën e veprimit të këtij ligji*”²².

Me kërkesë të prokurorisë për Krimet e Rënda, Gjykata për Krimet e Rënda vendos konfiskimin e pasurive kur: ka dyshime të arsyeshme, bazuar në indicie, për pjesëmarrjen e personit në veprimtari kriminale të fushës veprimit të këtij ligji; nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme, apo personi nuk justifikon zotërimin e pasurive ose të së ardhurave, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të së ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre; rezulton se pasuria është drejtpërdrejt ose tërthorazi në zotërim të pjesshëm apo të plotë personit.

Gjykata mund të vendosë konfiskimin edhe në rastet kur: procedimi penal pushohet për shkak të pamjaftueshmërisë së provave, të vdekjes së personit (*jo më vonë se 5 vjet pas vdekjes*); personi nuk mund të merret i pandehur dhe nuk mund të dënohet; personi deklarohet i pafajshëm penalisht për shkak të pamjaftueshmërisë së provave, se vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet; personi është proceduar për një veprë penale, që përfshihet në fushën e zbatimit të këtij ligji, por gjatë procedimit penal ndryshohet cilësimi juridik i veprës dhe vepra e re është jashtë fushës së zbatimit të këtij ligji.

Thelbi i risisë që sjell ky ligj, qëndron në qartësimin dhe procedimin për konfiskimin civil, pavarësisht nga gjendja apo ekzistenca e procedimit penal, pavarësisht dënimit penal edhe për pasuritë e personave, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që pasuritë të jenë vënë gjatë përfshirjes së të dyshuarit, në veprimtarinë kriminale

¹⁶ Konventa e Palermos, “Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe dy protokollet shtesë të saj”, ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002, Fletore Zyrtare, nr. 41, f. 1195, hyrë në fuqi më datë 9.08.2002.

¹⁷ Konventa e Vjenës, “Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope”, e vitit 1988, ratifikuar me ligjin nr. 8722, datë 26.12.2000, Fletore Zyrtare, nr. 50 e vitit 2000, botuar më datë 29.01.2001, f. 2156, hyrë në fuqi më datë 13.02.2001.

¹⁸ Konventa Ndërkombëtare për “Luftën kundër financimit të terrorizmit” e ratifikuar me ligjin nr. 8865, datë 14.03.2002, Fletore Zyrtare nr. 7, data 05.04.2002, f. 170, hyrë në fuqi më datë 21.04.2002.

¹⁹ Konventa e Këshillit të Evropës “Për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjyqimeve penale”, ratifikuar me ligjin 9068, datë 15.05.2003.

²⁰ Fletore Zyrtare nr. 181, datë 24.12.2009, f. 8069, hyrë në fuqi më datë 23.01.2009, ndryshuar me ligjin 24/2014, datë 20.03.2014, Dekreti i Presidentit nr. 8530, datë 03.04.2014, publikuar në Gazetën Zyrtare, nr. 47, datë 09.04.2014.

²¹ Ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, Fletore Zyrtare Nr. 181, datë 24.12.2009, faqe 8069, hyrë në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, më datë 23.01.2009. Ky ligj shfuqizon dhe zhvillon ligjin e mëparshëm nr. 9284, datë 30.9.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, Fletore Zyrtare Nr. 79, datë 8.11.2004, f. 8552, hyrë në fuqi më datë 24.11.2004

të fushës së veprimit të ligjit, sipas përcaktimeve në këtë ligji. Kalimi i barrës së provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i kalon personit, kundër pasurive të së cilit kërkohet konfiskimi. Ligji kërkon që procedimi gjyqësor të jetë autonom, më vete për pasuritë që lidhen me krimin e organizuar dhe trafiket e paligjshme, pavarësisht nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal. Verifikimet, hetimet dhe gjykimet, bëhen duke u mbështetur në rregullat e këtij ligji dhe në procedurat e Kodit të Procedurave Civile. Në rastet kur pasuritë e sekuestruara apo të konfiskuara, sipas këtij ligji, i nënshtrohen, gjithashtu, sekuestrimit apo konfiskimit, sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, gjykata urdhëron pezullimin e pasojave të zbatimit të masave të sekuestrimit dhe konfiskimit, sipas këtij ligji. Pezullimi përfundon me dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin apo shuarjen e këtyre masave.

Pas miratimit të ligjit 10192, dt. 03.12.2009, Komiteti i Helsinkit në Shqipëri (OJF), bëri padi në Gjykatën Kushtetuese dhe kërkoi pezullimin e zbatimit të ligjit dhe shfuqizimin e tij, me argumentet se ligji cenon një sërë elementesh të procesit të rregullt ligjor, si: mohon të drejtën e aksesit efektiv në gjykatë; nuk parashikon asnjë kriter ose kusht ligjor që duhet të plotësojë kërkesa e prokurorit për konfiskimin e pasurisë, që kjo kërkesë të jetë e vlerësueshme dhe e pranueshme prej gjykatës; shkel të drejtën e procesit të rregullt ligjor, pasi ndryshon marrëdhënien procedurale dhe sjelljen e palëve në procesin gjyqësor civil; shkel prezumimin e pafajësisë, sepse, bën kalimin e barrës së provës nga organi i prokurorisë te personi ndaj të cilit do të zbatohet masa e konfiskimit; parashikon rol aktiv të gjykatës në proces, duke shkelur parimin e paanshmërisë së gjykatës; shkel parimin e juridiksionit gjyqësor, sepse cakton një gjykatë penale që të gjykojë një proces civil. Komiteti i Helsinkit, pretendonte gjithashtu se ligji cenon të drejtën e ruajtjes së jetës private, garantuar me kushtetutë dhe Konventën Europiane të së Drejtave të Njeriut (KEDNJ); se nuk jepte garancitë ligjore që verifikimet të kryhen në përputhje me qëllimin e ligjit; se nuk janë përcaktuar kritere objektive për përzgjedhjen e subjekteve, duke lënë shteg për trajtim të pabarabartë të shtetasve, në kundërshtim me nenin 18/1 të Kushtetutës dhe nenin 8 të KEDNJ-së dhe, se në mënyrë eksplicite kërkon përcaktimin e një kufiri në ndërhyrjen e autoritetit shtetëror në cenimin e të drejtës për ruajtjen e jetës private. Gjithashtu, kishin pretendime se ligji shkel hierarkinë e miratimit të akteve normative.

Megjithatë, Gjykata Kushtetuese pasi mori në shqyrtim kërkesën e Komitetit të Helsinkit arriti në përfundimin se ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” nuk bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe nenet 6 dhe 8 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të protokollit shtesë të KEDNJ-së. Për këtë arsye, ajo vlerësoi se kërkesa për shfuqizimin e ligjit është e papajtueshme me Kushtetutën dhe KEDNJ-në dhe se është e pabazuar e për rrjedhojë ajo duhet rrëzuar. Sidoqoftë, Gjykata Kushtetuese në argumentet e saja, interpretoi dhe sqaroi se gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë

²² Në vendimet e Gjykatës Kushtetuese italiane: nr. 27, të vitit 1959 dhe, nr. 23, të vitit 1964, është mbajtur ky qëndrim: "... se në sistemin ligjor italian ka një dallim thelbësor ndërmjet dënimeve penale dhe masave parandaluese, të parat përbëjnë një përgjigje ndaj akteve të paligjshme dhe pasojat që sjell ai veprim, të dytat janë mjet për parandalimin e kryerjes së një veprimi të tillë. Thënë ndryshe, një dënim penal lidhet me një vepër penale të kryer, ndërsa masat parandaluese synojnë të reduktojnë rrezikun e veprave të ardhshme. Meqenëse sanksionet penale dhe masat parandaluese janë në thelb të ndryshme, jo gjithë parimet kushtetuese që qëndrojnë në themel të sistemit penal, zbatohen ndaj tjetrit. Për shembull, prezumimi i pafajësisë nuk lidhet me masat parandaluese, pasi ato nuk bazohen në përgjegjësinë penale ose në fajin e personit" (Shih Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Italiane të vitit 1964).

procesin me bindjet se, i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet; se, barra e provës i takon palës akuzuese; se, çdo dyshim duhet të shkojë në favor të së pandehurit.

Por, gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Barra e provës fillimisht i takon prokurorit, për të argumentuar dyshimin e arsyeshëm bazuar në indicie, se një person është pjesëmarrës në veprat penale të parashikuara në nenin 3 të ligjit. Mbështetur në verifikimet e kryera, prokurori ka detyrimin për të parashtruar kërkime të motivuara dhe të dhëna mbështetëse përpara gjykatës, për identifikimin e pasurive të personit të dyshuar dhe të personave të tjerë. Prokurori duhet të tregojë, nga ana e tij, se ka baza për dyshim të arsyeshëm dhe të dhëna të mjaftueshme për efekt të gjykimit parandalues. Ai duhet të tregojë se pasuritë nuk janë të fituara në rrugë të ligjshme, çka motivon ekzistencën e prezumimit të paligjshmërisë së tyre dhe si rezultat, t'i bëhet kalimi i barrës së provës personit të dyshuar. Gjykata sqaron në vendim, se barra e provës kalon te personi i dyshuar, për të justifikuar origjinën e ligjshme të pasurive të tij, për të argumentuar mungesën e lidhjes së pasurisë me cilësimin si produkte të veprave penale ose investim të tyre. Është detyrë e gjykatës që të sigurojë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, të kryejë një hetim të gjithanshëm dhe të plotë, për dhënien e një vendimi të drejtë dhe të mbështetur në ligj. Në dallim nga procedimi penal, gjykimi parandalues mbështetet në dyshimin e arsyeshëm bazuar në indicie, duke iu ngarkuar barra e provës personit të dyshuar dhe personave të tjerë, për të vërtetuar ligjshmërinë, për justifikimin e origjinës së pasurisë. Në këtë proces barra e provës është e ndarë ndërmjet prokurorit dhe personit të cilit do t'i sekuestrohet ose konfiskohet pasuria. Garancitë e procesit penal për prezumimin e pafajësisë nuk janë të zbatueshme në procesin parandalues. Në argument, Gjykata Kushtetuese përdor si shembull vendimet e Gjykatës Kushtetuese italiane, nr. 27 të vitit 1959 dhe nr. 23 të vitit 1964²³, ku është mbajtur i njëjti qëndrim, duke bërë dallimin ndërmjet masave parandaluese dhe masave penale: të parat përbëjnë një përgjigje ndaj akteve të paligjshme dhe pasojat që sjell ai veprim; të dytat janë mjet për parandalimin e kryerjes së një veprimi të tillë.

5. Strukturat e angazhuara për hetimin e krimeve financiare dhe aseteve kriminale

5.1 "Drejtoria e Hetimit të Krimin Ekonomik e Financiar, në Policinë e Shtetit" (DHKEF)

DHKEF është pjesë e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme për Hetimin e Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, e organizuar në nivel qendror dhe vendor. Në qendër është e organizuar me 4 sektorë: 1. sektori për hetimin e pastrimit të parave; 2. sektori për hetimin e korrupsionit, 3. sektori për hetimin e krimeve të tjera ekonomike

²³ Në vendimet e Gjykatës Kushtetuese italiane: nr. 27, të vitit 1959 dhe, nr. 23, të vitit 1964, është mbajtur ky qëndrim: "... se në sistemin ligjor italian ka një dallim thelbësor ndërmjet dënimeve penale dhe masave parandaluese, të parat përbëjnë një përgjigje ndaj akteve të paligjshme dhe pasojat që sjell ai veprim, të dytat janë mjet për parandalimin e kryerjes së një veprimi të tillë. Thënë ndryshe, një dënim penal lidhet me një veprë penale të kryer, ndërsa masat parandaluese synojnë të reduktojnë rrezikun e veprave të ardhshme. Meqenëse sanksionet penale dhe masat parandaluese janë në thelb të ndryshme, jo gjithë parimet kushtetuese që qëndrojnë në themel të sistemit penal, zbatohen ndaj tjetrit. Për shembull, prezumimi i pafajësisë nuk lidhet me masat parandaluese, pasi ato nuk bazohen në përgjegjësinë penale ose në fajin e personit" (Shih, vendimi i Gjykatës Kushtetuese italiane, viti 1964).

e financiare dhe, 4. sektori për hetimin e aseteve kriminale. Në nivel vendor, ajo është e organizuar në 12 sektorë, brenda së cilëve janë 7 seksione kundër korrupsionit dhe 7 seksione kundër krimeve ekonomike e financiare (në të gjitha qarqet ku funksionojnë njësitë e përbashkëta hetimore kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik e financiar NJPH²⁴), Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Vlorë dhe Shkodër dhe 3 seksione në komisaritet autonome, Sarandë, Kavajë dhe Tropojë. Në DHKEF punojnë 154 oficerë e agjentë, nga të cilët 28 në qendër dhe 126 në qarqe (29 prej tyre në Tiranë), të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre për hetimet financiare, me qëllim zbulimin, parandalimin, dokumentimin dhe goditjen e krimeve ekonomike e financiare, pastrimit të parave, korrupsionit dhe hetimin e aseteve kriminale, veçanërisht kur marrin formën e krimit të organizuar. Ajo orientohet nga programet strategjike të Policisë së Shtetit, nga strategjia kombëtare kundër korrupsionit, kundër krimit të organizuar, në prioritet e qeverisë dhe Programin e Asocim Stabilizimit me Bashkimin Europian, prioritet 3, 4 dhe 7 integruar në programin vjetor të Policisë së Shtetit, bazuar në legjislacionin vendas.

DHKEF merr dijeni për veprat penale të fushës së krimit ekonomik e financiar, nga kallëzimet e qytetarëve, drejtpërdrejt ose nga komisaritet digjitale, nga informacionet e mbledhura në rrugë gjurmuese e policore, nga strukturat e sajë në qendër e bazë, nga strukturat homologe brenda Policisë Shtetit dhe shërbimet e Policisë së Rendit dhe sigurisë publike, nga struktura të zbatimit të ligjit dhe të inteligjencës si, DPPPP, ILKDPKI, KLSH, SHISH, Dogana, Tatime, Interpoli, Europol; nga oficerët e ndërlidhjes policore shqiptare, jashtë vendit dhe ata të huaj, brenda vendit, nga strukturat homologe të rajonit dhe vendeve të tjera, nga rrjeti informal i zyrave për gjetjen e rikuperimin e aseteve kriminale, i njohur si rrjeti CARIN, nga burimet e hapura (media, rrjetet sociale, interneti, etj.). DHKEF heton për sa është e mundur dhe dërgon çështjen në prokurori pasi t'i ketë përdorur mjetet hetimore që ka në dispozicion. DHKEF, sipas nevojës konsultohet gjatë hetimeve dhe ka akses në regjistrin kombëtar të gjendjes civile, regjistrin e pasurive të paluajtshme, regjistrin e patentave dhe markave, Qendrën Kombëtare të Licencimit, regjistrin e shoqërive jofitimprurëse, regjistrin e noterëve, regjistrin e përmbaruesve publik/privat, regjistrat e evidentimit të transaksioneve të dyshimta, transaksioneve në kesh, transaksioneve në kufi, Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve, regjistrin kombëtar të automjeteve, targave, lejeve të drejtimit; regjistrin e mjeteve lundruese, regjistrin e ALUIZNI-t, regjistrin e Institutit Kombëtar të Sigurimeve Shoqërore, regjistrat e zhdoganimit dhe programin ASICUDA të doganave.

DHKEF nuk ka siguruar akoma mundësinë e konsultimit direkt por është në proces negociimi dhe propozimesh amendamentesh ligjore e nënligjore dhe hartim marrëveshjes të përbashkëta për të dhënat tatimore, *(në regjistrin e bizneseve të mëdha, VIP-ave dhe bizneseve të vogla, librave të shitjes dhe blerjes, pagesës së TVSH-së, i pagesës së sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi, qendra e të dhënave për pagesat elektronike me kasë fiskale)*, për të dhënat në regjistrin e personave fizik dhe bizneseve të vogla, në regjistrin e avokateve; në regjistrin e kredive

²⁴ Me Memorandumin e Bashkëpunimit, (të datës 27 maj 2007, rishikuar, përmirësuar dhe zgjeruar më datë 6 maj 2009) ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, ministrit të Brendshëm, ministrit të Financave, drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror, Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI dhe kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, u krijua fillimisht një njësi e përbashkët hetimore në Prokurorinë e Tiranës dhe me pas gjashtë njësi të përbashkëta hetimore në prokuroritë e rretheve gjyqësore, Durrës, Vlorë, Fier, Shkodër, Korçë dhe Gjirokastrë, me synimin: për të rritur cilësinë e hetimit dhe ushtrimit të ndjekjes penale për veprat penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit; për të rritur numrin e rasteve të ngritjes së abuzive dhe dërgimit në gjykatë të autorëve të këtyre veprave penale; për të rritur dhe forcuar dhe institucionalizuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të ngarkuara me ligji për të realizuar detyrat.

të këqija (*Agjencia e Trajtimit të Kredive*), në regjistrin kombëtar të kredive, në regjistrin e personave të dënuar, në regjistrin e përdoruesve të telefonave celular dhe fiks, ALB Telecom-Tring, Vodafon, Eagle, Plus, në regjistrin e farmacistëve me kontratë me Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, në regjistrin e aktiviteteve të lojërave të fatit, regjistrin e anijeve, jahteve, avionëve.

Në “Strategjinë kombëtare kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit” dhe në “Programin e Stabilizim Asocimit me BE-në”, është parashikuar edhe krijimi i “Regjistrin kombëtar të llogarive bankare”. Ky është edhe një detyrim për vendet anëtare të BE-së. Regjistri kombëtar i llogarive bankare do të shërbejë për zhvillimin e projekteve më sfiduese të rëndësishme kombëtare, për rritjen e qëndrueshmërisë, për zhvillimin dhe përbushjen e nevojave të klientëve, për mbajtjen e të drejtës ekskluzive për të proceduar transaksionet e brendshme të pagesave të korporatave e të shërbimit të kontabilitetit sociale dhe, si një burim informacioni për autoritetet hetimore e gjyqësore.

5.2 Njësitë e përbashkëta hetimore kundër krimit ekonomik e financiar dhe korrupsionit (NJPH-JIU)

Më datë 27 maj 2007, Prokurori i Përgjithshëm, ministri i Brendshëm, ministri i Financave dhe drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror, nënshkruan një memorandum bashkëpunimi, me anë të së cilit u krijua “Njësia e përbashkët hetimore kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit” në Prokurorinë e Tiranës. Njësia u kompletua me një staf të zgjedhur, të përbërë nga shtatë prokurorë, tetë oficerë të policisë gjyqësore nga Prokuroria, dhjetë oficerë të policisë gjyqësore nga Policia e Shtetit, dy specialistë nga SHISH-i, tre specialistë nga hetimi tatimor, tre specialistë nga inspektimi tatimor, tre specialistë nga hetimi doganor, dy specialistë nga inspektimi doganor. Ngritja dhe funksionimi i kësaj njësie të përbashkët me staf të përzgjedhur, solli shumë sukses dhe si rezultat, më datë 6 maj 2009, memorandum u rishikua, u përmirësua dhe u zgjerua, duke përfshirë edhe inspektorin e përgjithshëm të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) dhe kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe ngritjen e gjashtë njësive të tjera të përbashkëta hetimore, në prokuroritë e rretheve gjyqësore, Durrës, Vlorë, Fier, Shkodër, Korçë dhe Gjirokastrë, dhe së fundi në Elbasan, me synimin e rritjes së cilësisë së hetimit dhe ushtrimit të ndjekjes penale, për veprat penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit; për rritjen e numrit të rasteve të ngritjes së akuzimeve dhe dërgimit në gjykatë të autorëve të këtyre veprave penale; për rritjen dhe forcimin e institucionalizuar të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të ngarkuara me ligj për të realizuar detyrat.

5.3 “Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave” (DPPPP)²⁵

DPPPP është njësi e inteligjencës financiare shqiptare NJIF/FIU, si autoritet administrativ, buxhetor dhe operacional në varësi të ministrit të Financave, që shërben për të marrë e analizuar: a) raportet e transaksioneve të dyshuara, dhe b) informacione

²⁵ “Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave” (DPPPP) është njësi e inteligjencës financiare e Republikës së Shqipërisë dhe, autoriteti përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, e krijuar në vitin 2001, në zbatim të dispozitave ligjore të ligjit nr. 8610, datë 17.05.2000, “Për parandalimin e pastrimit të parave”, përmirësuar me ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar. Faqe e internetit <https://www.fint.gov.al/onlineapp/>. Parë për herë të fundit, më datë 5. 6. 2016.

të tjera për pastrim parash, lidhur me veprën penale bazë dhe financimin e terrorizmit e prodhimit të armëve të dëmtimit në masë, si dhe për shpërndarjen e rezultateve të analizës të autoritetet e zbatimit të ligjit në vend, dhe të homologët ndërkombëtarë. DPPP merr informacione shtesë prej subjekteve raportuese të ligjit, dhe ka mundësi, në kohën e duhur, që të konsultohet me informacionin financiar, administrativ dhe informacionin e forcave të zbatimit të ligjit. Funksionet e saj parashikohen në ligjin e posaçëm në fuqi, nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

DPPP funksion si Njësia e Inteligjencës Financiare Shqiptare dhe është si një urë lidhëse ndërmjet institucioneve financiare dhe autoriteteve të zbatimit të ligjit, me qëllim parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Ajo u ngrit në verën e vitit 2001 si autoritet administrativ në Ministrinë e Financave me emrin Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave në zbatim të dispozitave ligjore të ligjit nr. 8610, Datë 17.05.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”.

Me një vizion të qartë për ngritjen e sistemit parandalues të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ajo filloi punën dhe arriti të ndërtojë një klimë të frytshme komunikimi, mirëbesimi, bashkëpunimi dhe bashkëveprimi me institucionet financiare, fokusuar kryesisht te bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e sigurimeve, subjektet e tjera raportuese, si edhe te Banka e Shqipërisë, Prokuroria e Përgjithshme, Policia e Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit, në Ministrinë e Drejtësisë, Shërbimi Informativ Shtetëror dhe te autoritete të tjera të zbatimit të ligjit. Ajo ndjek: zhvillimet e standardet ndërkombëtare dhe rekomandimet e FATF, incision rishikimin e legjislacionit,²⁶ - çka ka sjell përmirësimin e regjimit ligjor të konfiskimit në Shqipëri, - zgjerimin e veprës penale të pastrimit të produkteve të krimit, penalizimin e financimit të terrorizmit, mosdeklarimin e të hollave dhe sendeve me vlerë në kufi dhe çeljen e llogarive anonime, zgjerimin e fushës së veprimit të ligjit, rritjen e numrit të enteve raportuese në raportimin e transaksioneve të dyshimta e komplekse, uljen e limitit të raportimit etj., miratimin e masave kundër financimit të terrorizmit. Ajo realizoi anëtarësimin në grupin “Egmond”, në korrik të vitit 2003 dhe rritjen e bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar, me njësitë homologe; realizoi pavarësinë operacione, funksionale dhe buxhetore duke ndërtuar një institucion më vete, në varësi të ministrit të Financave, duke rritur kështu besimin e qeverisë shqiptare dhe të institucioneve financiare raportuese, agjencive të zbatimit të ligjit në Shqipëri dhe të homologëve e partnerëve ndërkombëtarë të Këshillit të Europës, Komisionit Europian, Thesarit Amerikan, Fondit Monetar Ndërkombëtar, Misionit PAMECA, ICITAP e OPDAT, misionit të OSBE-së e atij të BE-së në Shqipëri, të cilat e kanë mbështetur këtë strukturë, me asistencë teknike, që nga ngritja e në vazhdim. Larg metodave tradicionale dhe në diversitetet e koncepteve të ruajtjes së sekretit bankar dhe të dhënave personale, si edhe raportimit të aktiviteteve të dyshimta, u arrit që të kapërcehen këto vështirësi dhe të sigurohen rezultate.

5.4 “Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara” (AAPSK)

AAPSK është një njësi administrative, pjesë dhe në varësi të ministrit të Financave,

²⁶ Paketa ligjore e miratuar më 19 qershor 2003, ligjet nr. 9084, 9085, 9086, si edhe ligji nr 9258, datë 15.07.2004, përmirësuar me ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

Minxhozi, L.
« Asetet
kriminale dhe
strategjia
kundër krimit
të organizuar,
pastrimit të
parave dhe
korrupsionit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

përgjegjëse për menaxhimin, ruajtjen, rritjen e vlerës, informimin e prokurorëve, gjyqtarëve, komitetit këshillimor dhe ministrit të Financave, në lidhje me situatën, gjendjen, ecurinë, e pasurive të sekuestruara e konfiskuara dhe, veprimtarinë e saj. Agjencia APSK, raporton brenda 15 ditëve dhe në mënyrë periodike në gjykatë, çdo 3 muaj në “Komitetin këshillimor ndërinstitucional të ekspertëve” për masat kundër krimit të organizuar²⁷ dhe brenda 90 ditëve nga vendimi përfundimtar, për konfiskimin.

5.5 “Komiteti Këshillimor Ndërinstitucional i Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar” (KNEMKOK)

Komiteti KNEMKOK mblidhet një herë në tre muaj. Ai analizon raportet dhe aktivitetet e AAPSK, kërkon informacion nga institucionet qendrore që kanë asete në menaxhim, rekomandon ministrin e Financave, qeverinë, se si dhe ku duhet t’i çojë dhe përdorë asetet e sekuestruara dhe të konfiskuara. Kryetari i komitetit është zëvendësministri i Financave, ndërsa anëtarët e tij janë: një ekspert nga Ministria e Drejtësisë, një ekspert nga Prokuroria e Përgjithshme, një ekspert nga Ministria e Brendshme, një ekspert nga Ministria e PÇSSH, kreu i AAPSK-së (Ministria e Financave), një ekspert nga buxheti gjyqësor dhe anëtarë nga ZRPP.

6. Hetimet financiare

Krahas hetimit të veprës penale bazë, DHKEF kryen edhe hetime financiare. Hetimi financiar ka për qëllim të zgjidhë se sa të ardhura të paligjshme janë siguruar nga veprat penale, në llogari të autorit si dhe lidhjen direkte e indirekte ndërmjet veprimtarisë financiare dhe sjelljes kriminale.

6.1 Metoda për llogaritjen e pasurive të paligjshme

Njihen disa metoda dhe formula për llogaritjen e pasurive të paligjshme, fitimit ilegal dhe të ardhurave ilegale. Tre më kryesoret janë: a) analiza e vlerës neto (figura 1); b) analiza e shpenzimeve (figura 2); dhe c) analiza depozitave bankare (figura 3).

a. Analiza e vlerës neto (diferenca pasuri/detyrime).

| | |
|-----------|---------------------------------|
| | Asetet |
| - (minus) | Detyrimet |
| <hr/> | |
| = (baras) | Fitimi neto |
| - (minus) | Fitimin neto të vitit mëparshëm |
| <hr/> | |
| = (baras) | Rritja e fitimi neto |
| + (plus) | Shpenzimet |

¹ Neni 35 i ligjit, nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar. “Për mbikëqyrjen e administrimit të pasurive të konfiskuara nga AAPSK, si dhe për marrjen e vendimeve për destinacionin e pasurive të konfiskuara ngrihet dhe funksionon “Komiteti këshillimor ndërinstitucional i ekspertëve për masat kundër krimit të organizuar”. Ky komitet mblidhet pranë Ministrisë së Financave. Komiteti përbëhet nga tetë anëtarë, të propozuar respektivisht nga ministri i Financave, ministri i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm, ministri që mbulon çështjet e Rendit Publik, ministri që mbulon Çështjet Sociale, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, kryetari i Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor dhe kryeregjistruesi i pasurive të paligjshme të Republikës së Shqipërisë. Anëtar i propozuar nga ministri i Financave është kryetar i komitetit”.

| | |
|-----------|--------------------|
| = (baras) | Fitimi total |
| - (minus) | Fitimin e ligjshëm |

= (baras) Fitimi ilegal

(figura 1)

b. Analiza e shpenzimeve (diferenca shpenzime, burime të njohura).
Përdoret në raste kur autorët bëjnë shumë shpenzime krahasuar me të ardhurat.
Totali i shpenzimeve

- (minus) Burime të njohura

= (baras) Fonde të panjohura / të paligjshme

(figura 2)

c. Analiza e depozitave bankare.

Totali i derdhjeve në gjithë llogaritë bankare

- (minus) Transferta & riderdhje në llogari bankare

= (baras) Fonde të panjohura/të paligjshme

Këtu duhet të shtohen

+ (plus) Shpenzimet me para në dorë

(kur ato janë më të mëdha se tërheqjet e mëparshme).

(figura 3)

7. Hetimet e aseteve kriminale

Në procesin e hetimeve financiare dhe hetimin e aseteve kriminale për identifikimin, ndjekjen, dokumentimin, ngrirjen, sekuestrimin, konfiskimin dhe rikuperimin e pasurive tek viktimat e krimit, përfshihen shumë aktorë, investigativë, administrativë, të inteligjencës dhe të gjyqësorit, si: Policia e Shtetit, DPPPP, 7 NJPH kundër krimit ekonomik e korrupsionit në prokuroritë e rretheve gjyqësore, NJPH kundër korrupsionit në Prokurorinë për Krimet e Rënda, gjykatat e rretheve gjyqësore dhe Gjykata për Krimet e Rënda, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, “Komiteti këshillimor ndërinstitucional për luftën kundër krimit të organizuar e korrupsionit, nëpërmjet masave kundër pasurisë”, Shërbimi Informativ Kombëtar, Kontrolli i Lartë i Shtetit, auditët e brendshëm të institucioneve, drejtoria e Hetimit Tatimor, drejtoria e Hetimi Doganor.

8. Statistika, tregues dhe analiza transaksionesh financiare nga DHKEF


Më poshtë paraqitet grafiku i përgjithshëm, i veprave penale të pastrimit të produkteve të krimit dhe të veprimitarisë kriminale, parashikuar nga neni 287 i Kodit

Minxhozi, L.
« Asetet kriminale dhe strategjia kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe korrupsionit »

Policimi dhe Siguria nr.3, 2016


Penal (figura 4), të ndara sipas burimeve të inicimit, me iniciativë nga burime policore dhe nga DPPPP.

Figura 4



Trendi i referimeve për pastrim produktesh të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale, duket qartë se ka një rritje të ndjeshme, nga vitit në vit, si rezultat i intensifikimit të punës së strukturave të hetimit të pastrimit të parave, në Policinë e Shtetit dhe DPPPP, përjashtuar vitin 2013, ku konstatohet një rënie e referimeve, e cila duket se vjen si pasojë e efekteve të vitit elektorral, gjë e cila nuk duhet të ndodhë dhe, duhet ulur ndjeshmëria e policisë nga politika, si dhe angazhimi i strukturave të hetimit të krimeve financiare me shërbime të tjera. Në 7 vitet e fundit, nga viti 2009 deri në vitin 2015, kemi 1843 raporte të aktiviteteve të dyshimta që kanë ardhur nga DPPPP (FIU) në DFHKEF, 534 prej të cilave ose 29% e tyre, janë referuar në NJPH kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik e financiar. Në vijim, jepet grafiku i statistikave të RAD (figura 5), të ardhura nga DPPPP dhe e referimeve prej tyre në prokurori, për periudhën 2009-2015.

Figura 5




Minxhozi, L.
« Asetet kriminale dhe strategjia kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe korrupsionit »

Policimi dhe Siguria
nr.3, 2016


Janë referuar nga DHKEF në NJPH, 819 vepra penale të korrupsionit për periudhën e 7 viteve të fundit 2009-2015 (figura 6), ku janë implikuar 1390 autorë, prej të cilëve janë arrestuar 504 ose 36,2% e tyre. Në vijim jepet paraqitja grafike e rasteve, autorëve dhe të arrestuarve. Tendenca e rritjes nga vitit në vit, tregon rritjen e fuqisë zbuluese, jo të rritjes së korrupsionit, sepse këto janë vepra pa kallëzim, ku përgjithësisht të dy palët janë përfituese, si i korruptuari ashtu edhe korruptuesi.

Figura 6



2729 vepra penale të zyrtarëve në detyrë, janë referuar në NJPH nga DHKEF, për periudhën e 7 viteve të fundit 2009-2015, ku janë implikuar 4053 autorë, prej të cilëve janë arrestuar 514 ose 12,6% e tyre. Në vijim në “figurën 7”, jepet paraqitja grafike e rasteve, autorëve dhe të arrestuarve.

Figura 7




Minxhozi, L.
 « Asetet kriminale dhe strategjia kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe korrupsionit »

Policimi dhe Siguria nr.3, 2016

14949 vepra penale të tjera në fushën e kërkimeve ekonomike e financiare janë dokumentuar gjatë 7 viteve të fundit, 2009-2015, nga DHKEF, ku janë implikuar dhe proceduar 17043 autorë, prej të cilëve janë arrestuar 2155 ose 12,6 % e tyre.

Në vijim, jepet grafiku i veprave penale (figura 8) në fushën e krimeve të tjera ekonomike e financiare, për 7 vitet e fundit 2009-2015.

Figura 8



9. Përfundime

Për sigurimin e efikasë së hetimeve financiare dhe aseteve kriminale dhe, luftën efikase kundër krimit të organizuar, krimit financiar dhe korrupsionit, është i nevojshëm përmirësimi i strukturave ekzistuese dhe i legjislacionit; lehtësimi i procedurave të bashkëpunimit ndërmjet agjencive të zbatimit të nëpërmjet hartimit e zbatimit të marrëveshjeve të përbashkëta të bashkëpunimit; krijimi dhe zhvillimi i sistemit të integruar të bazës së të dhënave mbi pasuritë, në kushtet e zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe futja te ato nga strukturat e hetimit. lehtësimi i investigimit duke siguruar akses në regjistrat e pasurive e llogarive bankare, për autoritet e hetimit të krimit ekonomik e financiar. Krijimi i mjeteve e metodave të reja për të mbështetur procedurat e konfiskimit të suksesshëm janë çështje esenciale, që duhen zgjidhur, për të mbrojtur shtetin e së drejtës dhe lirinë e individit; për të garantuar progresin shoqëror dhe zhvillimin e shëndetshëm ekonomik; për forcimin dhe zhvillimin e sistemit efikas për korporatat ndërkombëtare kundër krimit të organizuar, krimit financiar dhe korrupsionit.

Zbatimi i plotë i këtyre, nga agjencitë e zbatimit të ligjit dhe të standardeve ndërkombëtare është një sfidë për të ardhmen. Bërja veprë penale e “zotërimit të pasurisë së pajustificuar” dhe konsiderimi i saj si një krim serioz bazë për hetimin pasuror dhe konfiskimi civil i aseteve të pajustificuara duhet të ndodhë, pavarësisht ekzistencës së procedimit penal, pavarësisht dënimit për veprën penale bazë. Barrës së provës dhe prezumimit të pafajësisë, i nevojitet përmbyjsja në procedimet pasurore civile; sigurimi i njohjes së dyanshme dhe urdhrave ndërkombëtare të ngrirjeve, sekuestrimeve, konfiskimeve dhe rikuperimi i aseteve kriminale me qëllim kompensimin, rrënimin e kriminelëve, kompensimin e viktimave të krimit, forcimin e sistemit të drejtësisë dhe konsolidimin e autoriteteve të zbatimit të ligjit. Gjurmimi, gjetja dhe konfiskimi i aseteve kriminale është një nga mënyrat më efektive për të luftuar krimin e organizuar, pastrimin e parave, korrupsionin dhe është një çështje thelbësore për drejtimin e fitimeve.

Minxhozi, L.
« Asetet
kriminale dhe
strategjia
kundër krimit të
organizuar,
pastrimit
të parave dhe
korrupsionit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.3, 2016

Referenca

1. Konventa Penale Kundër Korrupsionit, "Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit", ratifikuar me ligjin 9492 datë 13.03.2006.
2. Konventa Varshavës, Konventa e Këshillit të Europës, e datës 16.05.2005, "Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit", ratifikuar me ligj nr. 9646, datë 27.11.2006.
3. Konventa e Palermos, "Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar" dhe dy protokollët shtesë të saj: "Protokolli kundër trafikut të emigrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare" dhe "Protokolli për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve", ratifikuar me ligj nr. 8920, datë 11.7.2002.
4. Konventa e Vjenës, "Konventa e vetme mbi drogat narkotike, e ndryshuar nga protokoli i vitit 1972 për ndryshimin e konventës së vetme mbi drogat narkotike, 1961, ratifikuar me ligjin 8723, datë 26.12.2000.
5. Konventa Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara, "Për shtypjen e terrorizmit ndërkombëtar e vitit 1999" dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, numër: 1267/1999, 1333/2000, 1363/2001, 1373/2001, 1377/2001, 1452/2002, 1455/2003, 1989/2011 dhe 2253/2015, për parandalimin e terrorizmit dhe ngrirjen e aseteve të listuar në listat e financuesve të terrorizmit ndërkombëtar.
6. "Konventa ndërkombëtare për shtypjen e falsifikimit të monedhave", e Gjenevës, 20 prill 1929.
7. "Standardet ndërkombëtare për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit & dhe përhapjes së armëve nukleare dhe të dëmtimit në masë", botuar nga FATF, shkurt 2012, www.fatf-gafi.org.
8. "Metodologjia për vlerësimin e plotësimin e rekomandimeve të FATF dhe efektivitetit të sistemit kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", botuar nga FATF, shkurt 2014.
9. Direktiva e Parlamentit dhe Këshillit Europian, nr. 42, datë 3 prill 2014, "Për ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve të krimit në Bashkimin Europian", botuar më datë 29. 4. 2014 në Gazetën Zyrtare të BE-së, nr. L127/39.
10. Vendimi nr. 845, dt. 6 dhjetor 2007, lidhur me bashkëpunimin ndërmjet zyrave për gjetjen dhe rikuperimin e aseteve kriminale për shtetet anëtare.
11. Komunikimi final i Komisionit të Komunitetit Europian, Bruksel, nr. 766, dt. 20.11.2008 në drejtim të Parlamentit dhe Këshillit Europian, mbi të ardhurat e krimit të organizuar, sigurim që "krimi nuk paguan".
12. Ligj nr. 10 192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar.
13. Ligj nr. 9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar.
14. Ligji nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit, me qëllim parandalimin dhe luftën kundër financimit të terrorizmit nëpërmjet, vendosjes, bllokimit, ngrirjes dhe sekuestrimit të fondeve dhe pasurive të personave të dyshuar si financues të terrorizmit".
15. Udhëzues për hetimin e korrupsionit dhe krimit financiar, "Projekti kundër korrupsionit në Shqipëri" dhe (PACA).
16. Analiza vjetore të Drejtorisë, për hetimin e krimit ekonomik e financiar për vitet 2005- 2015.
17. Memorandumi i bashkëpunimit ndërinstucional ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, ministrit të Brendshëm, ministrit të Financave, drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror, Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së dhe kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, datë 27 maj 2007, rishikuar, përmirësuar dhe zgjeruar më datë 6 maj 2009, për krijimin e njësisë të përbashkëta hetimore në Prokurori për hetimin e krimit ekonomik e financiar dhe korrupsionit.
18. Vendimi nr. 4, dt. 23.02.2011, i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, për shqyrtimin e kërkesës së Komitetit të Helsinkit (OJF) në Shqipëri me objekt: "Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe Konventën Europiane të së Drejtave të Njeriut (KEDNJ)", të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" dhe pezullimi i zbatimit të ligjit deri në përfundim të shqyrtimit të kërkesës.
19. Directive 2005/60/EC of the European Parliament and of the Council of 26 October 2005 "On the prevention of the use of the financial system for the purpose of money laundering and terrorist financing", published on 25 November 2005 in Official Journal of the European Union, L309/15.
20. Council Framework Decision 2003/577/JHA of 22 July 2003 on the execution in the European Union of orders freezing property or evidence.
21. Council Framework Decision 2005/212/JHA of 24 February 2005 on Confiscation of Crime-Related Proceeds, Instrumentalities and Property of the Council of the European Union.
22. CARIN Manual 2014, published from Secretariat, Camden Asset Recovery Inter-Agency Network (CARIN), on Europol. 03 Criminal Finances and Technology Unit, P.O. Box 90850, 2517 KK The Hague The Netherlands, www.europol.europa.eu © European Police Office, 2014.

Minxhozi, L.

« Asetet kriminale dhe strategjia kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe korrupsionit »

Policimi dhe Siguria nr.3, 2016

ENGLISH

A B S T R A C T S

"POLICIMI DHE SIGURIA", NR. 3, AUGUST, 2016

Physical preparation and performance as a duty of the State Police officers

- Prof. Asc. Dr. Rauf DIMRAJ, Msc. Ervin PEPI

ABSTRACT

It is always necessary to seek professionals in law enforcement, police officers who are physically fit, so that they, during working hours, may realize efficiently and successfully their tasks. As a matter of fact, police during working hours, are engaged in different physical challenges, as for instance, in catching running suspects; to jump over the roof and fences; to put down individuals who resist to arrest, keep on purpose heavy duty materials, such as guns, batons, handcuffs, etc. Such equipments are part of the standard of the necessary professional equipments of police, therefore the law enforcement officers must achieve an adaptable level of force and stability, which is achieved through development of exercising muscular power and empowerment of the cardio-respiratory system. Stability skills, force, speed, liveliness of moves for the police officers are very important factors of the physical-athletic preparation and often are decisive for the denomination of conflict situations against the criminal subjects, as well as for the assistance of the citizens in need. It is clear that the kinesthetic-physical outcomes of the police officers has to do with the management and the domination of the unforeseen too dangerous situations, therefore it is necessary that they are well-prepared with the necessary and moving-physical individualized programs, to fulfill the specific respective standards in compliance with the age and gender of each subject.

Security and Anti-terrorism

- Dr. Bilbil MEMAJ, Msc. Adriatik DUQI

ABSTRACT

Security today is at the center of the political debate at a global level. It is a concept that moves all the mechanisms for preserving the democratic system values from risks, damage and disasters. Like all the system values, even security is a continues improvement process and integral part of the political and economical developments, and is also conditioned from different factors of the social and natural environment. Its quality is defined especially from the level of the realization of the essential freedoms of humans. Insecurity roots from fear and risk. Fear is a psycho-social and emotional state of humans, which has direct influence on the individual freedom. Fear limits and isolates humans from the reality of the essential freedoms. It is as old as the human life itself and lives with it. In today's world, the objective character and the fear scale is mainly defined from the social-economical environment, which comes to humans through the dense web of information, from the black chronics and crime, from poverty and illness, from unemployment and hunger, from pollution and natural disasters, from human mistakes and arbitrary actions, from political repression, social conflict and injustice, which they all co-live "well" with the unpunished environment, corruption and day-to-day vulnerability. But the phenomenon which unavoidably brings about the biggest insecurity in today's societies is without doubt, terrorism. Terrorism comes to our homes is through television screens. He attacks and offends in newspapers and journals, and sometimes touches our lives or our people's lives in direct ways. People are not as much interested or concerned over the terrorism definitions as compared to what real risk terrorism brings. We simply feel

terror when we see violence and its consequences with people's lives and material damage on screens. To know how to define, to understand the causes and take preventive measures aiming at giving an answer back to it, are the main challenges of the countries in the fight against terrorism. Such elements are treated step by step in this material, trying to get an understanding of what are the right steps to grow the safest possible environment possible.

Management of human resources in the State Police - Msc Nikoll RICA

ABSTRACT

Through this piece of writing, I aim at giving the reader the extended information on the regulation of the State Police personnel relationships, according to the new police legislation and that of the civil employee one. Such working relationships are constructed over the base of the unbiased rules and procedures that must be respected through all the phases, starting from police enrollment, formation, qualification, development of police career, economical-financial treatment as well as other judicial relationships, among the employees and institutions of the police administration at a central and local level. The creation of a clear concept over effective management of the human resources makes an essential task of every police leader and serves as a pre-condition to construct an efficient structure that guarantees a positive environment, where citizens feel free and secure in their economical, social and societal activity. In the compilation of the development strategies and programs, the Police organization must be defined as a priority the objectives of the development of the human resources. Achievement of a stable and professional police service, based on merits, moral integrity and political neutrality, is only achieved through effective management of human resources. The classification that the new State Police law does to the human resources, dividing them into: "police employees", "civil employees" and "administrative employees" makes a professional diversity of these personnel that joins the institutional responsibilities for the functioning of guaranteeing public order and security. Basic principles that are respected in exercising such responsibilities are: lawfulness, non-discrimination, respecting the basic human rights and freedoms, proportionality, operational independence, political neutrality, integration, merit and professionalism, transparency, preservation of classified information, control and accountability. Management and administration of human resources in the State Police must be always led out of these principles, as a guarantee for the stability and effectiveness in the work of the police employee.

Migration challenges and penal offences that develop in this phenomenon

- Prof. Asc. Dr. Pandeli TAÇI, Msc. Jashar VREKA

ABSTRACT

A new and unforeseen era of emigration toward the West was noticed during the years 2012-2015. Such emigration, had its start from the much long and with much consequences fight in Syria, but also had its precedent since the conflicts of Afghanistan and Iraq – or shortly, in the Middle East. This unforeseen flux of illegal emigrants chose its path mainly from Balkan toward Western Europe. To this flux of emigrants it was joined even the illegal emigration from the Balkan countries, which

was much reduced recently, coming up unforeseeably. Some of the causes for the growth of the emigration in the Balkan countries, during the years 2013-2015, “Balkan way” chosen from the Middle East emigrants, criminal phenomenon that come along emigration, as well as some recommendations for the improvements in the field of social and penal field, will be the main object of this writing. The material, based on arguments, suggests that trying to stop the illegal activity of emigration, would have been more successful if the Penal Law articles were reviewed, with which we could fight illegal emigration, because they are not enough to fight human beings smuggling; whereas the articles of the Penal Code regarding human beings trafficking, may not be used to fight the human beings smuggling.

Cyber attacks and the National Security **- Msc. Arjan Muca**

ABSTRACT

The use of information technology is gaining a tremendous increase worldwide with each passing day. The daily routine is associated with computer systems. Military and national security systems are correlated with the operation of computer systems. The growing use of the information technology has increased the possibility of the attacks against these systems which would cause serious damages and impair the national security. Countries in the forefront of the use of information technology have realized that international cooperation is the best weapon to reduce the risks from attacks bearing grave consequences. These countries have undertaken national and international legal initiatives and increased the cooperation between them. Users of information technology in Albania are constantly growing. According to official statistics, cyber crime is increasing with each passing year. Important systems are installed in many vital areas of the country. Albania is not immune from possibility attacks which would bring serious consequences and would impair the national security. Several important legislative and organizational measures have been undertaken to reduce and minimize the danger of cyber attacks. A safer future demands that legislative and organizational measures be taken, and the staff of the institutions directly responsible for preventing cyber attacks, prosecuting the perpetrators, and minimizing the consequences of these attacks be properly trained.

Organizational Culture and Leadership **- Prof. Asc. Dr. Edmond BRANESHI**

ABSTRACT

The nature of strategic leadership is such that the influence of leaders, does not impact only the individuals but also the systems and the processes used by organizations to achieve the desired results. One of such indirect methods of leadership is the one through organizational culture. Culture is commonly defined simply as “ways and forms how we conduct things”. Culture is a powerful concept, thus many individuals involved in cultural processes perceive the methods or the actual ways as possibilities of doing things “right” and “accurate”. Leaders who understand culture are able to comprehend the individuals positioned and involved in “activities, events’ or in management issues. Culture defines the rules and standards of functioning of the organization. From this approach, culture is considered an indispensable element for the successful transformation of the organization and the maximization of the

value and utility of the human capital. Atmosphere is a short-term phenomenon created by the current leadership. It is directly related to the individuality of the leader, his way of management and communication. In the process of leadership we must be careful not to confuse culture with atmosphere, though both complement each other interchangeably. It is the task of leadership to make the most of these two distinct factors that have a bearing on how to act in order to fulfill the respective mission. A significant challenge for leaders today is to define the most efficient culture for their organization and, whenever necessary, change the culture of the organization to be a step closer to success.

Judicial police must become part of the judicial reform **Msc. Adriatik AGO**

ABSTRACT

It's been almost a decade since the adoption of the law "On the Judicial Police" and several other normative acts of the Attorney General, the Minister of Interior, or joint normative acts of these institutions are in effect. Despite the great changes that combined objective and subjective factors have brought about, we can still claim that the profile of the Albanian Judicial Police is still far from its targeted position. Differences and changes that are defined in the law or other sub – legal acts, regarding the Judicial Police services across institutions with sections of the Judicial Police at Attorney General office, have generated diverse profiles in fields of recruiting, education, as well as financial and administrative treatments.

On the other hand, the efficiency of this indispensable structure when engaged in the investigation of crime or any breach of law, has not been up to the expected level of compliance with all the requirements regulated by law regarding human resources policies in these services on disciplinary issues, the removal, transference, the assignment, and training of staff, etc. The reorganization of the Judicial Police within the State Police, as the only specialized body responsible for the fight against crime of all shapes and forms, is of crucial importance. The new aspects of the actual law on the State Police, the territorial and administrative reform, and many other challenges that this body faces, request its imperative reforming and, given the present situation, demand that it to become part of the judicial reform, as one of the most vital reforms of the institutions of the Albanian state.

Criminal assets and the strategy against organized crime, money laundering and corruption **Msc. Lutfi MINXHOZI**

ABSTRACT

Tracing, locating, freezing, seizing, and confiscating the criminal assets, is the most effective way to fight organized crime, money laundering, financing of terrorism, corruption, crime prevention and development. The above are also essential for running the profits, the rehabilitation of the victims of crime, the recovery of its consequences, the insurance of the free economic development, fair competition, the strengthening of the rule of law, security, and freedom of the individual, and the protection of democracy. To protect the rule of law, the legitimate property, the freedom of the individual, to ensure social progress and economic development, the following measures should be taken: the existing legal structures need improvement;

possession of unjustified assets should be considered a separate offense and a serious crime under asset investigation procedures; the confiscation of unjustified civil assets should occur despite the existence of criminal proceedings, regardless of the sentence for the criminal conviction; the concept of the onus of proof and the presumption of innocence in civil property proceedings should be reversed; mutual recognition of international orders on the freezing, requisition, confiscation, and recovery of the criminal assets must be ensured in order to compensate the victims of crime, strengthen the justice system, and consolidate law enforcement authorities; facilitate the investigation by providing access to records of assets and bank accounts to authorities investigating economic and financial crime, and create new tools and methods to support the procedures for a successful confiscation; draft programs, methodologies and practices for the compensation of the victims of crime and the reduction or elimination of the consequences occurred, etc. All above mentioned elements will be dealt with step by step in the following material and the final conclusions will be drawn at the end.

"Policimi dhe siguria",
rev. shkenc.
nr. 3, gusht 2016,
ISSN 2413-1334.
Botues: Akademia e Sigurisë,
Policia e Shtetit, RSH
Përmasa: 160X240 mm

ISSN 2413-1334
AKADEMIA E SIGURISË



POLICIMI DHE SIGURIA

GUSHT 2016



AKADEMIA E SIGURISË
Qendra Kërkimore Shkencore
Rruga e Elbasanit, Sauk, Tiranë



NR

3